

**Lazareviq**  
Rruga e humbur e Ballkanit



Fq.3

**"NATA E IDEVE"**  
Shteti do të mbështetë inovacionet



Fq.4

**Al-Mutlaq:**  
Gratë s'kanë pse mbulohe



Fq.17

# Koha

www.koha.mk



Synoj  
"Gongun e artë"

Fq.12

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3290 · e hënë 12 shkurt, 2018

1°C | +8°C

15 DEN

## AKTUALE

**Dobët me luftën kundër korrupsionit**



Maqedonia nuk reflekton me rezultate të dukshme sa i përket luftës kundër korrupsionit, vlerësojnë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që mbulojnë sektorin për anti-korrupsion. Slagjana Taseva nga Transparency International për Radion Evropa e Lirë thotë se Qeveria aktuale nuk po arrin të shënojë përparim të dukshëm sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe çlirimit të institucioneve nga ndikimet politike...

Fq.6

## RAJON

**Vdesin derisa janë në listën e pritjes**

Fq.15

## REPORTAZH

**Fshatrat "Islam" pa asnjë musliman**

Fq.20

## PROFILE

**Imami i Hitlerit**

Fq.21



## PREMTIMET QË S'PO REALIZOHEN

# EKONOMIA, PENG I AGJENDËS POLITIKE



Edhe përkundër premtimeve se sektori privat do të mbështetet fuqishëm nga Qeveria, duke u lehtësuar atyre tatimet si dhe përkrahjen financiare, Qeveria edhe pas 6 muajsh qeverisje nuk ka bërë një lëvizje të drejtë. Bizneset private vazhdojnë me të njëjtat probleme si vitet e mëparshme, ndërkohë që shteti vazhdon të përballet me një shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë

Fq.7

## Pesë komuna pa gjinekolog

Shkup, 11 shkurt - Kërkojmë parter, spital universitar nga BE-ja, me qëllim që ekspertët, sidomos për punë, të cilat nuk kryhen tek ne, të dërgojnë mjekë, të cilët në Maqedoni do t'i trajnojnë mjekët tanë, thotë ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe në intervistën e së dielës për Radion Evropa e Lirë. Në këtë drejtim tashmë është biseduar me Ministrinë e Shëndetësisë së Bullgarisë, ndërsa siç thekson ai, në

vijim janë bisedime edhe me një spital nga Gjermania. Për reagimet në opinion pas deklaratës së tij se problemi me shkallën e lartë të vdekshmërisë së foshnjave dhe nënave është edhe për shkak se nënat nuk mbajnë kujdes për gjendjen e tyre shëndetësore, ministri thotë se qëllimi nuk ka qenë fare që dikush të ofendohet, por siç thekson, ka një numër të caktuar të grave, të cilat paraqitjen e...

Fq.5



## EDITORIAL

MUSKULATURË POLITIKANËSH  
DHE AKRABALLËK INJORANTËSH

Emin AZEMI

Gjatë një komunikimi të rastësishëm me një mikun timin, më ra të kuptoj se dy, tri kompani nga vendi evropian ku ai jeton aktualisht, po bëhen gati të investojnë në Maqedoni. Miku im ndërmjetësues që është me origjinë nga Kosova në pika të shkurtra më foli për natyrën dhe profilin e këtyre investimeve dhe u shpreh i entuziasmuar nga pritja që i kishin bërë autoritetet zyrtare në Shkup delegacionit shumëantarësh të investitorëve evropian. Një lajm i mirë gjithsesi që rikthen pakëz shpresë për gjithë ata që po jetojnë minutat e fundit të depresionit social në këtë shtet që nuk e ka filluar aq mirë vitin, sidomos në planin ekonomik.

Por, kureshtja e gazetarit më nxiti ta pyes mikun se, pasi që ishte nga Kosova, cila ishte arsyeja që investimet në fjalë nuk po bëheshin në atdheun e tij, por në Maqedoni. Lista jo e gjatë e motiveve që kishin shtyrë këta investitorë të zgjedhin pikërisht Maqedoninë e jo Kosovën, më shtyri pak të mendoj, ndonëse nuk ishin gjëra që nuk i kisha ditur. Përderisa po bluaja në kokë pasojat e kësaj shmangieje që po i bëjnë investitorët e huaj Kosovës, mu kujtua një komunikatë e para do kohësh e Odës Ekonomike në Prishtinë e cila kritikonte burokracinë vendore dhe gjithë mekanizmat shtetërorë për mungesë përgjegjësie institucionale në thithjen e investimeve të huaja. Me sa më kujtohet, ajo komunikatë thoshte që Kosova duhet të mësojë edhe nga Maqedonia se si të motivojë investitorët e huaj e në veçanti ata evropianë dhe të rritë eksportet. Deri sa në Kosovë humbet kohë në kërkim të arsyeve për dështim, thuhej afërsisht në atë komunikatë, të tjerët gjejnë rrugë për të arritur synimet e zhvillimit ekonomik, duke përmendur me këtë rast qasjen e Maqedonisë e cila duhej analizohet mirë nga të gjithë.

Kosova e pasluftës, e stërngarkuar me muskuj komandantësh që harruan t'ua lëshojnë rëndin atyre që dinë të qeverisin më mirë se ata, është rikthyer në një shkollë të keqe menaxhimi me asetet kombëtare, të cilat, në mungesë të sensit për nikoqirllëk shiten pa fije ngurrimi, duke i orientuar mbrapsht politikën makroekonomike në dëm të investimeve direkte vendore e të huaja dhe në shpërpjesëtim me nevojat dhe faktorët e brendshëm ekonomikë e social. Përderisa po vazhdon ky "fitnes" kombëtar i politikës muskuloze kosovare, shtetet fqinje, përfshi edhe Maqedoninë, po përfitojnë pikërisht nga neglizhenca dhe jonikoqirllëku institucional i drejtuesve të shtetit të Kosovës. Mjafton të analizohen, bie fjala, shifrat e qarkullimit tregtar, për të kuptuar se në ç'parametra joprofitabilë lëvizin politikën ekonomike zhvillimore kosovare. Përderisa Maqedonia vitin që lamë pas ka eksportuar mallra në vlerë afro dy miliard euro, Kosova mezi e ka arritur vlerën 200 milionë euro. Se Kosova vërtetë duhet të mësojë nga Maqedonia flet edhe e dhëna se vetëm nga zonat industriale në lindje të Shkupit, eksporti i kalon mbi 550 milionë euro brenda gjashtë muajve. Një fakt tjetër që lidhet gjithsesi me gjithë ata politikanë e këshilltarë politikanësh që bëjnë "bajram me veten" në Kosovë, ndërliqet pikërisht me metodat mafioze të akrobave e kushërinjve të ministrave e kryeministrave në dëbimin e investitorëve seriozë nga vendi i tyre dhe për pasojë riorientimi i tyre pikërisht në Maqedoni. Në zonat e lira industriale të Maqedonisë që funksionojnë në lindje të Shkupit, që nga viti 2009 është duke funksionuar me sukses prodhuesi gjerman i pajisjeve elektronike për vetura, Draexlmaier Automotive Electronics, i cili në verën e vitit 2008 pati tentuar të instalohet në zonën Prishtinë-Fushë Kosovë, ku parashihej të punësohen, fillimisht 100 e mëpastaj edhe 500 punëtorë. Pas përpjekjeve të sikletshme tremuajshe të mbushura me "aktivitete lobuese" të turlit matrapazi e spirihuci, të ardhur rishtas nga katundi, që ratësisht mund të kenë qëlluar miq e familjarë të zyrtarëve të lartë kosovarë, prodhuesi gjerman pat hequr dorë nga Kosova dhe qe orientuar në Maqedonia. Madje nuk shkoj shumë kohë dhe pronarët e Draexlmaier Automotive Electronics patën shpallë njoftimin për hapjen e linjës së dytë të prodhimit, e për të rritur numrin e të punësuarve nga 4,300 në 4,900 veta, me paga mesatare të vendit. E njëjta ndërmarrje gjermane tashmë ka edhe dy linja prodhimi në Serbi, sepse edhe atje, sikur edhe në Maqedoni, kishte gjetur gjuhë të përbashkët dhe interes për të prodhuar.

Për gjithë ata që ende kanë dilema se pse nuk ka dinamikë zhvillimi jeta në Kosovë, patjetër që duhet të nxitet nga shembujt e mësipërm për të mësuar se muskulatura e politikanëve dhe akroballëku i injorantëve janë tumoret kancerogen të ardhmërisë së Kosovës.

VIZATIMI I KUFIJVE NË  
BALLKAN

"Presidenti Thaçi, Kryeministri Rama dhe Kryetari i BDI-së Ali Ahmeti, kanë biseduar në Tiranë për ndarjen e Kosovës, për vizatimin e kufijve në Ballkan, e për idiotësi të tilla të ngjashme. Një gjë e tillë, një skenar i tillë, nuk do të ndryshojë kufijtë a asnjë shteti, përveç kufijve të Kosovës.

Me u koordinu me Edi Ramen për kufijtë e Ballkanit, është sikur me u koordinu me mu për kufijtë e Arkipelagut. Kurse, dihet botërisht, Hasha është në kërkim të fatkeqësive kolektive, vetëm dhe vetëm me e zhvendosë vëmendjen nga një e tija që po i qëndron mbi kokë. Për Ali Ahmetin a ia vlen me diskutu seriozisht?

Si rrjedhojë do të kemi reagime të këtilla, sikur ky i zëvendëskryeministrit të Austrisë", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari nga Prishtina, Berat Buzhala, duke komentuar deklaratën e Heinz-Christian Strache, zëvendëskancelar i Austrisë, i cili ditë më parë tha se "presioni ndaj Serbisë, vend që është garantues i paqes dhe stabilitetit në rajon, për të njohur Kosovën, është rrugë e gabuar" dhe se "Veriu i Kosovës ka të drejtë për vetëvendosje".

UNISONI DHE TEMAT  
E MËDHA

"Pse s'po ndodhë UNISONI për temat e mëdha, po më pyet sot një gazetar...? I thash ad hoc, që;

1. UNISONI s'po ndodhë, ngase elitat aktuale... NUK janë kapur pas kauzave shtetërore e kombëtare, por pas atyre partiake, e për të mos thënë edhe atyre meskine klanore.
2. Derisa nuk ndodhë kjo, në Kosovë nuk do të ketë as progres e as zhvillim, e aq me pak emancipim politik e ekonomik.
3. Por, Ju mund të keni mendim krejtësisht tjetër.

Është e drejtë e Juaja", shkruan në profilin e tij në Facebook, sociologu kosovar Fadil Maloku.

## MEDIACitate

Disa duan ta  
ndajnë  
Sirinë dhe ta  
dobësojnë  
Turqinë

Ish-kryeministri i Turqisë, Ahmet Davutoglu tha se ngjarjet aktuale në Siri tregojnë qartë se disa qarqe duan ta ndajnë këtë shtet dhe të pamundësojnë zbatimin e politikave turke të integritimit në Lindjen e Mesme. Përfaqësuesi aktual i Parlamentit turk nga Partia në pushtet për Drejtësi dhe Zhvillim (AK Parti) Davutoglu mori pjesë në tubimin e organizuar nga Shoqata për nxitjen e miqësisë, arsimit dhe kulturës (DOSTDER) në Samsun, dhe me këtë rast komentoi mbi situatën aktuale në Siri.



Duke theksuar se Turqia kurrë nuk ka patur problem me kurdët e Sirisë, ish kryeministri turk Davutoglu tha se as edhe operacioni aktual ushtarak "Dega e Ullirit" në Afrin nuk është drejtuar kundër kurdëve, por kundër terroristëve. Ai kujtoi se anëtarët e fiseve kurde nga Siria 100 vjet më parë ishin një pjesë integrale e ushtrisë osmane.

"Kurdët sirianë janë vëllezërit tanë, por është i qartë qëllimi i atyre që duan ta forcojnë organizatë terroriste YPG dhe si të tillë ta përdorin për grindje mes popullit turk dhe sirian. Qëllimi i tyre është ta dobësojnë Turqinë dhe të thyejnë krahët e saj", tha Davutoglu. Davutoglu gjithashtu shtoi se Turqia ka shkruar një ngjarje të madhe historike me hapjen e dyerve dhe kujdesin për miliona refugjatë sirianë. "Të jeni të bindur, se atë që ka bërë Turqia për refugjatët sirianë nuk do të harrohet për një mijë vjet", përfundoi Davutoglu.

(Anadolu Agency, 11 shkurt)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## SI U BË LATINISHTJA GJUHË E VDEKUR?

Edhe pse ka shumë gjurmë nga gjuha latine në gjuhët moderne, ajo si gjuhë e veçantë nuk përdoret më në të folurit. Çfarë ka ndodhur? Kur kisha katolike ka fituar fuqi në Romën antike, latinishtja është bërë gjuha zyrtare në Perandorinë Romake. Kjo ka qenë gjuha për komunikim ndërkombëtar dhe për shkencë. Latinishtja tani konsiderohet si gjuhë e vdekur, ajo përdoret në kontekste specifike, por askush nuk e flet. Nga pikëpamja historike, latinishtja nuk është edhe aq e

vdekur, sa është e ndryshuar - në gjuhën frënge, spanjolle, portugeze, italiane dhe rumune. Këto janë gjuhët romanike të cilat përfshijnë gramatikë, kohë të foljeve dhe ndërlidhshmëri specifike nga latinishtja. Jo rastësisht, të gjitha këto gjuhë janë zhvilluar në territoret e mëparshme të Perandorisë Perëndimore Romake. Kur Perandoria është shkatërruar, latinishtja "ka vdekur" dhe janë shfaqur gjuhë të reja. Pjesërisht, latinishtja është larguar nga përdorimi i përditshëm për

shkak të ndërlikueshmërisë së madhe - pothuajse çdo fjalë ndryshon sipas kohës, aspektit, numrit, gjinisë. Nuk ka pasur as fuqi qendrore që do ta promovojë dhe standardizojë gjuhën. Latinishtja vulgare e cila ka qenë një version më i thjeshtë, ka përdorur për një kohë, por ka filluar të zhduket nëpër gjuhët lokale. Deri në fund të shekullit të 6të, njerëzit nga pjesë të ndryshme të perandorisë së mëparshme nuk kanë mundur më të kuptohen ndërmjet veti. Sot, latinishtja ende përdoret në shumë fusha të teknologjisë, mjekësisë dhe taksonomisë.

LAZAREVIQ PËR PERSPEKTIVËN EVROPIANE TË RAJONIT



# RRUGA E HUMBUR E BALLKANIT

Shkup, 11 shkurt - Në qershor të vitit 2003 në Selanik, Bashkimi Evropian bëri një premtim që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të bëhen një ditë anëtare të bllokut. Kjo gjë shtoi besimin e një Evrope të bashkuar, që në fillimvitet e shekullit të XXI-të ishte aq i madh, por 10 vite më vonë u duk se gjithçka u shua. Kështu thotë për për Dojçe Velen publicisti i njohur, njëherësh njohës i çështjeve politike në Ballkan, Kërsto Lazareviq, ndërsa shton se "pas pranimit të Kroacisë në BE në vitin 2013, zgjerimit të mëtejshëm të unionit iu vu viza".

"Krizë që filloi me falimentin e 'Lehmann Brothers' çoi në humnerë shtete të tëra të Evropës, aq sa BE-ja rrezikoi të shpërbëhej dhe për zgjerimin e mëtejshëm as që mund të mendohej. Kjo situatë bëri që qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor të vononin reformat e rëndësishme, e kësaj më pas bëheshin më pak demokratike. Miqtë e BE-së në Ballkanin Perëndimor e ndjenë veten të mashtruar dhe aty u përhap cinizmi", thotë Lazareviq. Megjithatë, shton ai, ka ende shpresë që ky cinizëm të kapërcehet, e kjo bazuar

"Ajo e Maqedonisë është gati të ndërrojë emrin e vendit për t'i dhënë fund një mosmarrëveshjeje absurde me Greqinë, ndërsa ajo e Serbisë do të ishte gati të njëhte Pavarësinë e Kosovës vetëm për t'u bërë pjesë e Evropës, pavarësisht se para popullit të vet nuk e pranon ende këtë realitet", shprehet analisti për Dojçe Velen

në dokumentin strategjik që u publikua të martën e kaluar nga Komisioni Evropian, prej të cilit bëhet e qartë se Mali i Zi dhe Serbia do të mund të bëhen anëtare të BE-së rreth vitit 2025.

"Në hartën e Evropës vihet re një boshllëk i shëmtuar me vendet që nuk janë pranuar ende. Boshllëku në juglindje të kontinentit të

vjetër duket si një gropë e një rruge të asfaltuar që duhet mbushur shpejt, e nëse BE-ja nuk e bën këtë, atëherë forca të tjera do të tentojnë ta bëjnë. Këto forca të tjera janë Kina, përmes projekteve në infrastrukturë; Rusia dhe Turqia, përmes investimeve në sektorin e energjisë; ndërsa Arabia Saudite dhe Katari me përpjekjet e tyre për të eksportuar një lloj islamizmi që ky rajon nuk e ka traditë. Në themel të dëshirës së Ballkanit Perëndimor për anëtarësim në BE është 'malli për Evropën', thekson Lazareviq. E kjo, shton analisti, shihet qartë nga veprimet e disa qeverive.

"Ajo e Maqedonisë është gati të ndërrojë emrin e vendit për t'i dhënë fund një mosmarrëveshjeje absurde me Greqinë, ndërsa ajo e Serbisë do të ishte gati të njëhte Pavarësinë e Kosovës vetëm për t'u bërë pjesë e Evropës, pavarësisht se para popullit të vet nuk e pranon ende këtë realitet", shprehet analisti për Dojçe Velen. Megjithatë, disa kritikë do të pyesnin nëse gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor i plotësojnë standardet e larta për anëtarësim në BE. "Përgjigjja e sigurtë është Jo", thotë Lazareviq,

duke shtuar se as Serbia me Malin e Zi ndoshta nuk do të jenë në gjendje t'i plotësojnë të gjitha kushtet deri në vitin 2025. "Por ky nuk është argument që mund të përdoret kundër zgjerimit, sepse askush nuk është perfekt". Lazareviq shtron për diskutim sesa vende do të mund të nxirreshin jashtë BE-së, nëse do të duhej të përdroshin standardet e larta gjithandej. Italia, ndoshta për korrupsion masiv; Malta, si një vend ku gazetarët kanë frikë të bëjnë punën e tyre; Austria, tashmë me një qeveri pjesë e së cilës janë edhe radikalët e djathtë.

"Nëse BE-ja do të përbëhej vetëm nga vende që plotësojnë të gjitha kushtet e paketës së stabilitetit dhe zhvillimit, pa korrupsion dhe me standarde të larta për shtetin e së drejtës, lirinë e shtypit dhe mbrojtjen e pakicave, atëherë BE-ja do të kishte vetëm 4 anëtarë: Luksemburgun, Danimarkën, Suedinë dhe Holandën. Gjermania dhe Finlanda do të mund të pranoheshin në BE së afërmi, nëse do të kursenin më shumë dhe do të ulnin borxhet shtetërore nën 60 për qind të PBB-së", thotë analisti për medien gjermane.

GRUBI DREK PUNE ME NIMICIN

## Zgjidhja për emrin e pranueshme nga dy palët



Shkup, 11 shkurt - Deputeti i BDI-së, Artan Grubi, në Nju-Jork kishin drekë pune me ndërmjetëuesin e Kombeve të Bashkuara në kontestin për emrin, ish-diplomatit amerikan, Methju Nimic. Grubi ia ka shprehur Nimicit të gjitha përshtypjet nga takimet intensive në Uashington, duke përfshirë dhe sugjerimet edhe nga bashkëbiseduesit e tjerë në periudhën midis takimeve të përbashkëta. Dy bashkëbiseduesit, qëndron në kumtesën e BDI-së diskutuan në përgjithësi për kontestin për emrin dhe ndërmjetësimin e Nimicit dhe shkëmbyen mendime për ngjarjet aktuale. "Qëndrimet e dy kryeministrave nxisin optimizëm se tani zgjidhja është më afër se kurrë. Sipas Grubit dhe BDI-së, zgjidhja përfundimtare e cila do të arrihet duhet të jetë me dinjitet dhe e pranueshme për të dy palët. Kompromisi duhet të mundësojë integritet urgjent dhe pa asnjë vonesë të Maqedonisë në NATO dhe BE. Kjo do të kontribuon në paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në vendin tonë dhe rajon, por së bashku edhe me reformat sistemo-re paraqet parakusht për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie shoqërore", shtohet në kumtesë. BDI, shtohet plotësisht i mbështetur përpjekjet e Nimic dhe negociatorëve në kontestin me fqinj tonë jugor.

SHILEGOV PËR "DOKUMENTO"

## Ekziston disponim për zgjidhjen e problemit

Athinë, 11 shkurt - Më mirë është t'i zgjidhësh problemet sesa t'i injorosh, thotë kryetari i Qytetit të Shkupit për gazetën greke "Dokumento". Petre Shilegov, thotë se ai, por edhe kryeministri Zoran Zaev dëshirojnë t'i zgjidhin e jo të krijojnë probleme. Siç njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, në intervistën me titull "Aleksandri i Madh nuk ka qenë asnjëherë pjesë e historisë sonë të rregullt", Petre Shilegov flet për problemin që Greqia e ka me emrin tonë kushtetues, për ndryshimet e bëra në Kushtetutë,

për Aleksandrin e Madh, por edhe për bashkëpunimin mes dy qyteteve. Në pyetjen për ndryshimet eventuale kushtetuese që Greqia i kërkon nga ne, kryetari i Shkupit sqaron se ekziston nen në Kushtetutë, sipas të cilës Maqedonia nuk ka pretendime territoriale nga vendet fqinje.

"Për çështjen konkrete e kemi ndryshuar kushtetutën tonë në vitin 1992. Në Kushtetutën tonë nuk ekziston nen që mbështet një gjë të tillë për asnjë vend. Megjithatë, ekziston nen në kushtetutën që

thotë se nuk kemi pretendime territoriale ndaj vendeve fqinje. Për këtë kjo nuk duhet të jetë kërcënim për askënd në Greqi", thotë Shilegov. Ai refuzon t'i komentojë pozicionet e Maqedonisë në bisedimet për emrin, sepse thotë se çfarëdo qoftë deklaratat politike mund t'i shkaktojë dëm procesit. I pyetur për atë nëse dakordohet me deklaratën e ish-presidentit Kiro Gligorov se jemi sllovenë që kanë ardhur pas Aleksandrit të Madh, Shilegov thotë se preferon që Aleksandrin e Madh ta shohë si lider

që e ka civilizuar botën. "Aleksandri i Madh nuk ka qenë kurrë pjesë e historisë sonë të rregullt. Ka qenë i kyçur në historinë tonë në dhjetë vitet e fundit. Në thelb, kur flet për lloj të këtyllë të përkatësisë etnike, shteteve dhe popujve, kjo i përket 300 viteve të fundit, ndërsa Aleksandri i Madh ka jetuar para 2.300 viteve. Unë preferoj që Aleksandrin e Madh ta shohë si lider që e ka civilizuar gjithë botën", sqaron kryetari i Qytetit të Shkupit në intervistën për "Dokumento". Shilegov thotë se komunikimi është ura



më e mirë e miqësisë mes popujve, sepse shumë stereotipe zhduken kur njerëzit njihen edhe "kështu kuqtojmë se i kemi problemet e njëjta dhe i ndajmë vlerat e njëjta".

ZËVENDËSMINISTRI ADEMI NË MBËSHTETJE TË IDEVE TË REJA DHE KREATIVE NË ARSIM

Zëvendësministri i Arsimit, Arbër Ademi, nuk është kursyer të ofrojë mbështetje për të rinjtë si dhe angazhim institucional për shtimin e mundësive dhe mjeteve financiare për realizimin e ideve inovative në arsim. "Për këtë punë është shteti këtu", është shprehur ai, ndërsa ka sqaruar se edhe Programi i punës së qeverisë aktuale është mbështetur në strategji dhe ligje të miratuara nga qeveritë e përparshme

# SHTETI DO TË MBËSHTETË INOVACIONET E TË RINJVE



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 11 shkurt - Në mbështetje të ideve të reja, kreative dhe dobiprurëse që burojnë nga universitetet, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) premtan angazhimin e saj për ti dalë në ndihmë kujtdo që kontribuon në nxitjen e inovacioneve - e veçanërisht të rinjve. Fundja, "për këtë punë është shteti", shprehet zëvendësministri Arbër Ademi, i cili nuk është kursyer aspak të ofrojë mbështetje për të rinjtë dhe angazhim maksimal për shtimin e mundësive dhe volumit të mjeteve financiare për realizimin e ideve inovative në arsim. Sipas tij, në Maqedoni ka rritje të vazhdueshme të shkallës së vetëdijesimit për rëndësinë e inovacioneve, por edhe interesim për sigurimin e mjeteve për realizimin e ideve përkatëse.

"Për këtë punë është shteti këtu. E, në këtë kontekst dua të nënvizoj se do të angazhohemi që të zgjerohen vazhdimisht mundësitë për inovacione dhe sasia e mjeteve financiare me qëllim rritjen e mjeteve për financimin e inovacioneve. Sepse, kjo është ardhmëria e vendit", është shprehur Ademi në manifestimin "Nata e ideve" organizuar nga Instituti francez dhe Fakulteti i Makinerisë pranë Universitetit "Kirili dhe Metodi" në Shkup. Në debatin me temë "Të rinjtë dhe inovacionet" morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme arsimore, komunitetit të biznesit dhe studentë, të cilët vunë theksin te rëndësia që ka mbështetja e inovacioneve në zhvillimin e

shoqërisë, por edhe nevojën për mbështetjen më të madhe institucionale me qëllim të inkurajimit dhe realizimit të ideve kreative. Në këtë pikë, zëvendësministri Ademi konsideron se "sa më shumë hulumtues, krijues dhe sipërmarrës ka një vend, aq më shumë përparojnë shoqëria dhe ekonomia e atij vendi". Për këtë arsye, pavarësisht rotacionit politik në vend, Qeveria e re, sikurse shpjegoi ai, nuk do të distancohet nga obligimet për zbatimin e Strategjisë për zhvillimin e inovacioneve (2012-2020). Përkundrazi, te kjo Strategji dhe te një sërë ligjesh që kanë të bëjnë me inovacionin si veprimtari, Ademi thotë se është i mbështetur edhe programi për punë të kësaj Qeverie. "Në

këtë pjesë ekziston një qasje e koordinuar institucionale, e cila do të jep efekte afatshkurte ose afatmesme. Të gjitha aktivitetet e përcaktuara dhe të ndërmarra në kuadër të Programit qeveritar për punë, janë në përputhje me Strategjinë për zhvillimin e inovacioneve 2012-2020, Ligjin për veprimtari inovative, Strategjinë rajonale për hulumtim dhe zhvillim të inovacioneve për Ballkanin perëndimor dhe shumë dokumente tjera strategjike që janë pjesë e planit të gjerë për ndërtimin e Maqedonisë si vend i dijes, inovacionit dhe teknologjia informatike", është shprehur zëvendësministri i Arsimit.

Në përfitimin e mundësive të këtilla, në të kaluarën kujdesej Fon-

di për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, përmes së cilit ndaheshin mjetet për kategori të reja shfrytëzuesish mesin e të cilëve edhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, të cilëve iu financoheshin projektet hulumtuese nga lëndët e shkencave natyrore dhe teknike. Kushti kryesor ishte që ato hulumtime të jenë në përputhje me programet mësimore të lëndëve përkatëse si dhe thirrjes për financimin e teknologjive për uljen e ndotjes së ajrit në mjediset urbane. Para dy viteve, nga ky program u zgjodhën 5 kompani shkollore të cilët u bënë shfrytëzues të mjeteve të alokuara për këtë qëllim. Paraprakisht, MASH-i kishte aprovuar edhe rekomandimet e këshillit Evropian për përpilimin e një Strategjie Nacionale për Mësim të Sipërmarrësish dhe Inovacionit (2012-2020) ku mes tjerash parashihej edhe vendosja e një lënde të posaçme arsimore. Kështu që lënda e Sipërmarrësi dhe Inovacion filloi të mësohej në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale nga viti shkollor 2012/2013. Kjo lëndë, sipas të gjitha gjasave do të vazhdojë të jetë pjesë e programeve shkollore të paktën deri në vitin 2002, jo vetëm sepse është pjesë e strategjikeve të miratuara nga qeveritë e përparshme por edhe sepse mbi këto dokumente, sipas deklaramenteve të zëvendësministrit të Arsimit, Ademit, është ndërtuar edhe Programi i punës së qeverisë së tashme.

ANKETË E IPIS-IT

## Shumica për në NATO dhe BE

Shkup, 11 shkurt - Nëse nesër do të mbahej referendum për hyrjen e Maqedonisë në BE, 64.2 për qind e qytetarëve të Maqedonisë janë përgjigjur "për", ndërsa të njëjtën pyetje për hyrje në NATO, 66 për qind janë prononcuar gjithashtu me pohim. Këtë e tregojnë rezultatet nga sondazhi i Institutit për studime politike (IPIS), i bërë në periudhë mes 16 dhe 21 dhjetorit të vitit 2017, në ekzemplarë prej 1113 të anketuarve të rritur nga Maqedonia. Gjithsej 45.4 për qind e qytetarëve të Maqedonisë mendojnë se marrëdhëniet me Greqinë në të ardhmen do të përmirësohen, ndërsa 15.5 për qind mendojnë se do të përkeqësohen. Në pyetjen për

pranimin e Maqedonisë në BE, kundër janë prononcuar 18 për qind, ndërsa me "nuk e di", janë përgjigjur 17.8 për qind e të anketuarve. Për krahasim, në pyetjen e njëjtë në vitin 2016, 66.9 për qind kanë qenë për hyrje në BE, ndërsa 24.8 për qind kundër. Nëse nesër do të kishte referendum për hyrjen e vendit në NATO, kundër janë prononcuar 15.3 për qind, ndërsa me "nuk e di", janë përgjigjur 18.7 për qind e të anketuarve. Në pyetjen e njëjtë në vitin 2016, 70.7 kanë qenë për t'u bashkuar me Aleancën dhe 21.4 për qind kundër. Në pyetjen se si do t'i vlerësonin marrëdhëniet aktuale politike midis Maqedonisë dhe Greqisë, 20.9 për qind

janë përgjigjur se janë të mira, ndërsa 31.7 vlerësohet të jetë disi mirë. Në të njëjtën pyetje 14.9 për qind e të anketuarve thanë se janë të këqija, ndërsa 26.3 për qind disi keq.

Në anketë, qytetarëve u është shtruar edhe pyetja edhe se si i vlerësojnë marrëdhëniet aktuale ndërnjerëzore midis Maqedonisë dhe Greqisë, 23.3 vlerësojnë se janë të mirë, 37.6 disi të mira, 22.6 deri diku të këqija, 10.2 të këqija, ndërsa 6.3 për qind janë përgjigjur me "nuk e di". Qytetarët në anketë i shprehin qëndrimet e tyre për vendet fqinje, marrëdhëniet me Greqinë, çështjen e emrit dhe integritet euro-atlantike të Maqedonisë.

## BESA me dy Kongrese, njëri më 18 e tjetri më 24 shkurt!

Shkup, 11 shkurt - Lëvizja BESA definitivisht do të mbajë dy Kongrese - njëri më 18 në Tetovë nga krahu i ashtuquajtur i Shkupit dhe tjetri më 24 shkurt, nga krahu i Bilall Kasamit, ndërsa do të mbahet në Shkup! Edhe pse fillimisht dy grupe kishin paralajmëruar Kongresin për më 24 shkurt, tani pas thellimit të ndarjeve, krahu i Shkupit ka vendosur që Kongresin ta mbajë më 18 shkurt. Në profilin e tij në Facebook, njëri nga themeluesit e Lëvizjes BESA, Zeqirija Ibrahim, shkroi "Ideja vazhdon" të ngjitur me një

fotografi në të cilën shkruhet se më 18 shkurt në Pallatin e Tetovës do të mbahet kongresi i parë i partisë. Pas kësaj, përmes një kumtese reagoi grupi tjetër i Bilall Kasamit, në të cilën thuhet se dikush po ua keqpërdor logon e partisë. "Për hir të informimit të drejtë të opinionit publik e ritheksojmë që konform statutit dhe rregullores për Organizimin e Kongresit, Lëvizja BESA ka shpallur Kongresin e saj më 24 shkurt 2018 dhe ky është Kongresi i vetëm i partisë", thuhet në reagimin e lëshuar nga BESA e Bilall Kasamit.

## FILIPÇE ZOTOHET PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE NË KLINIKËN GJINEKOLOGJIKE



"E dinë se më parë nga dy foshnje ka pasur një inkubator, tani ka 16 inkubatorë të rinj. Dhe, dua të mohoj lajmet se në 40 komuna nuk ka gjinekolog amë. E vërteta është se në pesë komuna nuk kemi gjinekolog", thekson ministri Filipçe, ndërsa informon se Ministria e Shëndetësisë ka në plan ngritjen e nivelit të diturisë së mjekëve që punojnë në këtë profesion

## PESË KOMUNA PA GJINEKOLOG

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 11 shkurt - Kërkojmë parter, spital universitar nga BE-ja, me qëllim që ekspertët, sidomos për punë, të cilat nuk kryhen tek ne, të dërgojnë mjekë, të cilët në Maqedoni do t'i trajnojnë mjekët tanë, thotë ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe në intervistën e së dielës për Radion Evropa e Lirë. Në këtë drejtim tashmë është biseduar me Ministrinë e Shëndetësisë së Bullgarisë, ndërsa siç thekson ai, në vijim janë bisedime edhe me një spital nga Gjermania.

Për reagimet në opinion pas deklaratsë së tij se problemi me shkallën e lartë të vdekshmërisë së foshnjave dhe nënave është edhe për shkak se nënat nuk mbajnë kujdes për gjendjen e tyre shëndetësore, ministri thotë se qëllimi nuk ka qenë fare që dikush të ofendohet, por siç thekson, ka një numër të caktuar të grave, të cilat paraqitjen e parë tek gjinekologu e kanë vetëm kur lindin.

"Duke dashur të bëjmë plan aksional për strategjinë që seriozisht të përfshihe-

mi në zgjidhjen e këtij problemi, kemi dashur që të ndikojmë mbi të gjithë faktorët për të cilët konsiderojmë se kanë ndikim në problematikën me të cilën jemi përfshirë. Përqendrohemi dhe kemi plan për atë se si do të ndikojmë në nivelin në Klinikën Gjinekologjike në kuptim që të blejmë pajisje adekuate, tashmë ka filluar me procesin e furnizimit të inkubatorëve. E dinë se më parë nga dy foshnje ka pasur një inkubator, tani ka 16 inkubatorë të rinj. Dhe, dua të mohoj lajmet se në 40 komuna nuk ka gjinekolog amë. E vërteta është se në pesë komuna nuk kemi gjinekolog", thekson Filipçe. Më tej ai shton se Ministria e Shëndetësisë ka në plan ngritjen e nivelit të diturisë së mjekëve që punojnë në këtë profesion. "Fillojmë proces të edukimit. Vijnë ekspertë nga jashtë, nga OBSH-ja, të cilët sipas standardeve botërore do t'i trajnojnë mjekët tanë që punojnë në këtë problematikë dhe do t'i trajnojnë", sqaroi ministri dikasterial.

Përveç strategjisë për zvogëlim të vdekshmërisë së foshnjave, siç informoi Filipçe, punojnë edhe në planin për

edukim në përgjithësi të mjekëve në vend edhe atë si përmes trajnimeve adekuate në vendet e huaja, por mjaftueshëm gjatë që të mund ta fitojnë nivelin e ekspertizës, ashtu edhe në sjelljen e ekspertëve lokalisht në kushte tona. Strategjia e ardhshme që do ta bëjnë publike është për zvogëlimin e infeksioneve në spitale, e në atë drejtim është reviduar komisioni për infeksione antimikrobe dhe intrahospitale dhe do të bëhet edhe plan aksional.

Sa i përket rritjes së rrogave, ministri paralajmëroi do të fillojë në gjysmën e dytë të vitit, ndërsa rritja e rrogave për kujdestaritë në gjysmën e parë të vitit. Lidhur me rastin e vdekjes së nënës në spitalin privat gjatë operacionit, Filipçe informoi se Komisioni që e heton rastin vetëm pjesërisht ka përfunduar me punë dhe se dokumentacionin i plotë do të kompletohet kur do të arrijë raporti nga Instituti për mjekësi ligjore, kur edhe do të dalin me qëndrim zyrtar. Ai siguron se në të gjitha institucionet shëndetësore publike vendore për anesteziën shfrytëzohen ilaçe evropiane dhe cilësore.

## KRONIKË

## Nxirren trupat e alpinistëve në Kajmakçallan



Janë nxjerrë trupat e dy alpinistëve nga Maqedonia nga maja Kajmakçallan dhe janë duke zbritur drejt qendrës së skijimit ku mjekët e urgjencës do të duhet të konstatojnë se djali dhe vajza nga Maqedonia janë të vdekur, mëson MIA nga shërbimi zjarrfikës grek. Dy persona, alpinistë nga Maqedonia, kanë humbur jetën në majën Kajmakçallan në malin Nixhe në Greqi, me siguri pas rrëzimit në humnerë. Sipas informacioneve të MIA-s nga Athina, me siguri bëhet fjalë për vajzën 25-vjeçare dhe djalin 35-vjeçar, alpinistë, të cilët kanë qenë në grupin prej rreth 50 personave në zonën Agios Atanasios, Pella, ndërsa janë ndarë nga grupi dhe kanë humbur. Shërbimi zjarrfikës, dje ka marrë thirrje për ndihmë dhe nga ora 14:30, ka filluar aksion shpëtimi me tre automjete dhe 13 shpëtues. Natën vonë alpinistët janë locuar në një pjesë të pakalueshme, por për fat të keq nuk kanë dhënë shenja jete. Pas locimit të vendit ku kanë rënë dy alpinistët, që nga herët në mëngjes ka zgjatur aksioni i zjarrfikësve grekë për nxjerrjen e trupave të alpinistëve.

## Vidhen 6000 euro nga një automjet para Klinikës për Onkologji

Në qarkun e kompleksit të klinikave "Nëna Terezë" në Shkup, para Klinikës për onkologji, dje rreth orës 02:30 një kryerës i panjohur ka kryer vjedhjen e një automjeti udhëtarësh me targa gjermane. Kryerësit e ka hapur automjetin dhe ka marrë dy valixhe, 6.000 euro dhe dokumentet e udhëtimit me emrin A.B. Ndërmerren masa për gjetjen e personit dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

## Aksidentohet deputetja e LSDM-së

Deputetja e LSDM-së, Meri Lllazarova, e cila lënduar rëndë në një aksident dje është hospitalizuar në Klinikat e Shkupit, ndërsa kryetari i Vallandovës, Pero Kostadinov është lënduar lehtë, informojnë nga policia. Aksidenti ka ndodhur dje rreth orës 17:50 në rrugën Demir Kapi-Udovë, në vendin e quajtur "Çezmja e Markos". Lllazarova në automjet ka qenë me kryetarin e Vallandovës, Pero Kostadinov, ndërsa pas aksidentit ata me Ndihamen e shpejtë janë dërguar në Spitalin e përgjithshëm Kavadar. Ekspertizë në vendin e ngjarjes kanë kryer Prokurori publik dhe ekipi ekspert nga Stacioni i policisë Negotinë. (O.Xh)

## Pas 25 vjetëve, zjarrfikësit e Shkupit me automjete të reja

Shkup, 11 shkurt - Brigada për mbrojtje zjarrfikëse e Qytetit të Shkupit këtë vit për herë të parë pas 25 vjetëve do të bëhet me automjet të ri me shkallë zjarrfikëse. Krahas kësaj është planifikuar që të furnizohen edhe katër automjete zjarrfikëse të reja që paraqet lëvizje drastike kur bëhet fjalë për parkun vozitës të ripërtërirë. Automjetet do të sigurohen me mjete të siguruara në buxhetin e Qytetit të Shkupit. Automjeti i ri me shkallë zjarrfikëse është planifikuar që të ketë shkallë me lartësi prej rreth 50 deri 60 metra.



## Fetain s'e ka kërcënuar askush

Shkup, 11 shkurt - Prokuroria Speciale në mënyrë kategorike ka demantuar shkrimet e fundit në disa media të cilat ndër lidhin një incident të mundshëm në fshatin Bogovinë të Tetovës i ndodhur me 7 shkurt lidhur me një atentat të mundshëm ndaj prokurores speciale Fatime Fetai. Sipas lajmit të publikuar ditë më parë, thuhet se persona tashmë të panjohur që në grup kanë qenë disa janë

munduar që të shkaktojnë incident dhe më pas edhe një atentat ndaj prokurores speciale Fatime Fetai në fshatin Bogovinë nga ku është dhe ajo, mirëpo policia ka reaguar në kohë të duhur duke parandaluar një gjë të tillë. Prokuroria Speciale në demantin thonë se atë ditë prokurorja speciale Fatime Fetai as nuk ka qenë në Bogovinë e as rasti nuk ndër lidhet aspak me atë.

KTHIMI I KREDIVE TË KËQIJA

# QYTETARËT MË TË DISIPLINUAR SE KOMPANITË

Raporti i fundit për vitin 2017 i Bankës Popullore të Maqedonisë (BPM) tregon se qytetarët janë më të disiplinuar se subjektet afariste në kthimin e kredive. Kjo si duket ka të bëjë me faktin se çfarë pasoja mund të kenë qytetarët nëse nuk i kryejnë në kohë pagesat e kësteve të kredive



i përket kthimit të kredive.

Analiza vë në dukje se gjatë vitit 2017 pagesat për kreditë e këqija po rritet falë trendit të rritjes së pagesave të kësteve nga ana e qytetarëve.

“Saldoja e kredive të këqija deri në fund të muajit tetor të vitit 2017 është përmirësuar dukshëm dhe përqindja e kredive të këqija të qytetarëve është në nivelin 6.5 për qind nga vlera e përgjithshme e kredive të qytetarëve, kundrejt 10.2 për qind sa është përqindja e kredive të këqija të personave juridik. Sipas kësaj rezultojnë që qytetarët janë më të disiplinuar sa i përket kthimit të kredive në krahasim me sektorin afarist. Ndërkaq

vlera e përgjithshme e kredive të qytetarëve për dhjetë muajt e parë të vitit 2017 ishte 2.27 miliard euro, ndërsa kreditë nga sektori i kompanive kishin vlerën prej 2.37 miliard euro”, thuhet në raportin e BPM-së.

Në anën tjetër edhe disa nga bankat më të mëdha vendore potencojnë se edhe përkundër problemeve financiare që kanë pasur viteve të fundit, qytetarët e Maqedonisë për shkak të pamundësive financiare për të kthyer këstet e kredive vitin e kaluar, megjithatë hetohet një trend pozitiv sa i përket pagesave të kësteve të kredive të këqija dhe se në këtë drejtim qytetarët janë më të përpiktë

në kthimin e kredive të mbetura se sa personat juridik.

“Në përgjithësi qytetarët po bëhen më pak problematik sa i përket pagesave të kësteve të kredive nëse do të bënim krahasim me kompanitë. Kjo si duket ka të bëjë me faktin se çfarë pasoja mund të kenë qytetarët nëse nuk i kryejnë në kohë pagesat e kësteve të kredive si dhe në aspektin e detyrimeve me dhunë nga ana e përmbauesve për të paguar kreditë”, thonë nga Banka Komerciale.

Edhe nga NLB “Tutunska Banka” informojnë se pavarësisht të gjitha ngjarjeve negative që kanë ndodhur viteve të fundit në

ekonominë e vendit, para se gjithash si pasojë e konfrontimeve politike, pagesa e kredive të këqija po shënon rritje sidomos nga ana e qytetarëve të cilët po paguajnë këstet e kredive në mënyrë të rregullt kundrejt sektorit afarist të cilët vazhdojnë të mos i paguajnë në rregull këstet e kredive.

“Ndodhitë makroekonomike që ishin prezente viteve të fundit kishin ndikim te bankat që të marrin masa dhe aktivitete për zbulimin e hershëm të problemeve me pagesën e kredive të këqija. Gjithsesi këto masa kanë ndikuar në zvogëlimin e përqindjes së kredive jo funksionale dhe se vitin e kaluar ta mbyllim në korniza të kufirit të lejuar të kredive të këqija. Mandej vitin që lamë pas vërehet qartë trendi i pagesave të kësteve për kreditë e këqija nga ana e qytetarëve ndërsa aktivitete më të ulët të kthimit të kredive të këqija ende ka nga personat juridik dhe se këto kredi edhe këtë vit do të kenë rrezikshmëri më të lartë”, thonë nga MLB “Tutunska Banka”.

Ndryshe të dhënat e fundit të Bankës Popullore tregojnë se përqindja me e lartë e kredive të këqija apo 13 për qind, janë kredi nga sektori i ndërtimeve, 9.5 për qind janë kredi të këqija nga tregu i automobilave, 4.9 janë kredi të këqija bujqësore dhe 1.9 - kredi të këqija banesore.

VËREJTJET E PARA NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE

## DOBËT ME LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Organizatave joqeveritare thonë se Qeveria duhet të formojë sa më shpejt një Komisionin për mbrojtjen nga korrupsioni, komision ky i cili, sipas tyre, duhet të përbëhet nga profesionistë dhe persona me kredibilitet



Shkup, 11 shkurt - Maqedonia nuk reflekton me rezultate të dukshme sa i përket luftës kundër korrupsionit, vlerësojnë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që mbulojnë sektorin për anti-korrupsion. Sllagjana Taseva nga Transparency International për Radion Evropa e Lirë thotë se Qeveria aktuale nuk po arrin të shënojë përparim të dukshëm sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe çlirimit të institucioneve nga ndikimet politike. “Është lënë shumë hapësirë që gjërat, për fat të keq, të rrjedhin sikurse në të kaluarën, megjithëse tani kanë ndryshuar vetëm aktorët. Shqetësues është ajo që ndodh në sistemin gjyqësor, situatën aktuale në Prokurorinë Publike, si dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me inte-

gritetin e trupave më të lartë në kuadër të këtyre institucioneve, që në asnjë mënyrë nuk paraqet garanci për sundimin e drejtësisë dhe luftën efikase kundër korrupsionit”, thotë Taseva.

Në këtë drejtim, zëvendëskryeministri për çështje të integritetit, Bujar Osmani gjatë prezantimit para mediave të Strategjisë për zgjerim të Komisionit Evropian, tha

se instalimi i sundimit të drejtësisë paraqet një kërkesë kyçe sa i përket anëtarësimit të Maqedonisë në familjen evropiane. Në kuadër të Strategjisë për zgjerim parashihet formimi i komisioneve dhe trupave mbikëqyrës, që do të ndjekin punën e gjykatave si dhe institucioneve përkatëse për luftën kundër korrupsionit. Madje, ai tha se çdo reformë në sistemin e gjyqësorit do të ndiqet

drejtpërdrejtë nga faktori ndërkombëtar. Nga ana tjetër, Ana Janevska Della va drejtuese e organizatës “Transparencë për Maqedoninë”, thotë se Qeveria aktuale ka bërë përpjekje për të instaluar mekanizma, sa i përket luftës korrupsionit të paktën, siç thotë ajo, janë realizuar më shumë konsultime mes organizatave joqeveritare dhe Qeverisë për vënien në funksion të

mekanismave për t'i detyruar institucionet të jenë më transparente rresh shpenzimit të parave të takspaguesve. Megjithatë, sipas saj, këto përpjekje nuk mundësojnë që korrupsioni të jetë në nivel minimal. Della va thotë se për të funksionuar ligji me të cilin mbrohen denoncuesit e veprimeve korruptive, nevojitet një fushatë gjithëpërfshirëse për ngritjen e vetëdijes. “Qytetarët nuk janë të njohur rreth kësaj mundësie, se ata mund të denoncojnë korrupsionin dhe institucionet janë të obliguara të mbrojnë identitetin e tyre. Madje nevojitet dhe një fushatë për të vetëdijësuar se sa dëm sjell korrupsioni për funksionimin e institucioneve sepse qytetarët me gjenerata janë edukuar se për tu zgjidh një problem, ata duhet të paguajnë të themi ‘ndërdar’, thekson Della va. Organizatat joqeveritare thonë se Qeveria duhet të formojë sa më shpejt një Komisionin për mbrojtjen nga korrupsioni, komision ky i cili, sipas tyre, duhet të përbëhet nga profesionistë dhe persona me kredibilitet. (REL)

PREMTIMET QË S'PO REALIZOHEN

# EKONOMIA, PENG I AGJENDËS POLITIKE

Edhe përkundër premtimeve se sektori privat do të mbështetet fuqishëm nga Qeveria, duke u lehtësuar atyre tatimet si dhe përkrahjen financiare, Qeveria edhe pas 6 muajsh qeverisje nuk ka bërë një lëvizje të drejtë. Bizneset private vazhdojnë me të njëjtat probleme si vitet e mëparshme, ndërkohë që shteti vazhdon të përballet me një shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë



NASIR SELIMI

**Rezultatet akoma mungojnë, kurse sektori privat ende është në një ngërc sepse nuk ka diçka konkrete nga realizimi i atyre projekteve te premtuara nga qeveria e re. Çështjet politike sërish janë në fokus të Qeverisë dhe po ndikojnë negativisht në mos tejkalimin e problemeve që kishin gjatë viteve të mëparshme edhe ende i kanë firmat private**



ARBEN HALILI

**Përshtypja ime e përgjithshme është se për momentin, Qeveria më tepër është e orientuar në drejtim të zgjidhjes së problemit të emrit se sa në zbatimin e masave konkrete ekonomike, gjë të cilën e vlerësoj si të gabuar nëse implementimi i reformave ekonomike do vazhdojë të ketë rëndësi të dorës së dytë përballë problemit që potenciam më lartë**

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 11 shkurt - Edhe përkundër premtimeve të shumta të qeverisë aktuale se do të krijojë kushte më të mira për sektorin privat dhe investitorët e huaj, megjithatë, viti 2018 sa i përket zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të ambientit e të bërtitit biznes, do të mbetet në një shkallë jo të kënaqshme.

Ky vlerësim vjen prej ekspertëve ekonomikë të cilët janë kritikë ndaj Qeverisë e cila edhe përkundër premtimeve për mbështetje të fuqishme të sektorit privat, që nënkuptonte lehtësime në tatimet si dhe përkrahje të ndryshme financiare, një gjë e tillë nuk ndodhi. Për pasojë bizneset private po vazhdojnë me të njëjtat probleme si vitet e mëparshme, ndërkohë që shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë, po merr

përmasa shqetësuese. "Viti 2018 me tepër mund të konsiderohet si vit i rehabilitimit ekonomik të vendit, si pasojë e stabilizimit të gjendjes politike, ndonëse nuk duhet të kemi pritshmëri të mëdha. Për më tepër që masat e propozuara nga ana e Qeverisë, si vlerë financiare në proporcion me numrin e përgjithshëm të kompanive të cilave ju adresohet, janë shumë minore dhe të paefektshme. Megjithatë besoj që propozim projektet e përfshira në buxhetin e vitit 2018, gjithnjë nëse do implementohen si të tilla, mund të kontribuojnë në formë zinxhimore në drejtim të angazhimit të kompanive vendore, me theks të veçantë në implementimin e projekteve kapitale", thotë njohësi i rrjedhave ekonomike, Arben Halili, i cili shprehet se veprimet e qeverisë aktuale të përkujtojnë ato të qeverisë para-

rendësi, e cila si prioritet kishte zhvillimin ekonomik e më pas orientohet në drejtim të zgjidhjes së problemit të emrit që Maqedonia të anëtarësohet në BE dhe NATO, angazhime këto që linin në haresë premtimet e dhëna për prosperitet ekonomik.

"Megjithatë përshtypja ime e përgjithshme është se për momentin, Qeveria më tepër është e orientuar në drejtim të zgjidhjes së problemit të emrit se sa në zbatimin e masave konkrete ekonomike, gjë të cilën e vlerësoj si të gabuar nëse implementimi i reformave ekonomike do vazhdojë të ketë rëndësi të dorës së dytë përballë problemit që potenciam më lartë", nënvizon Halili. Sa i përket pritshmërive në aspektin zhvillimit ekonomik, profesori universitar Marjan Peterseki është i mendimit se nëse Maqedonia plotë 25 vite pavarësi nuk ka ar-

ritur të krijojë ekonomi të zhvilluar, të krijojë kushte më të mira për sektorin privat dhe investimet e huaja, shumë pak ka gjasa që kjo të ndodhë që gjatë këtij viti, ndërkohë që vendi vazhdon të përballet me një shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Por ai është optimist se në vitin 2018 janë gjasat e mira të kemi rritje ekonomike.

"Për momentin ata që duhet të bëjë Qeveria, është të jetë më ambicioze në identifikimin e qartë të prioritetëve që kanë impakt në rritjen ekonomike, duke i vendosur synim kryesor dhe të punojë më me intensitet në realizimin e projekteve të paralajmëruara që do të nxisnin rritje ekonomike", thotë Peterseki. Për mundësinë e ndonjë përmirësimi në sferën e zhvillimit ekonomik, shprehet skeptik edhe

profesori i ekonomisë Nasir Selimi, sipas të cilit në vitin 2018 mbështetja qeveritare për bizneset do të mungojë për shkak të prioritetëve të agjendës politike. "Rezultatet akoma mungojnë, kurse sektori privat ende është në një ngërc sepse nuk ka diçka konkrete nga realizimi i atyre projekteve te premtuara nga qeveria e re. Çështjet politike sërish janë në fokus të Qeverisë dhe po ndikojnë negativisht në mos tejkalimin e problemeve që kishin gjatë viteve të mëparshme edhe ende i kanë firmat private. Edhe pse flitet se po ndodhin ndryshime, bizneset dhe njerëzit e rëndomtë aspak nuk po i prekin apo i shijojnë këto ndryshime. Zhvillimi ekonomik i vendit ishte shumë premtuese nga qeveria e re por jo edhe zbatuese", vlerëson Selimi.

Publicitet

Në bazë të nenit 39 të Ligjit për standardet e studentëve dhe nenit 41 të Statutit të Konviktit shtetëror për studentët "Shkup" - Shkup, Këshilli drejtues i:

**KONVIKTIT SHTETËROR PËR STUDENTË  
"SHKUP" - SHKUP**  
Publikon  
**SHPALLJE PUBLIKE**  
për zgjedhje të drejtorit

Në pajtim me nenin 39 të Ligjit për standardin e studentëve, Këshilli drejtues i Konviktit ka sjellë vendim për publikim të shpalljes për zgjedhje të drejtorit, në bazë të së cilit publikohet shpallje për zgjedhje të drejtorit të Konviktit shtetëror për studentët "Shkup" - Shkup.

- Krahas kushteve të përgjithshme me Ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:
- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
  - Në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
  - Të kenë të arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë VII/1 të arsimit;
  - Të kenë përvojë pune prej minimum 5 vjet;
  - Të posedojnë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS - së paku 6 pikë,
  - ILEC (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2,
  - FCE (Cambridge English: First) - të dhënë,
  - BULATS - së paku 60 pikë
  - Të ketë të dhënë testin psikologjik ose testin për integritet.

- Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkurs duhet të paraqesin dokumentet në vijim:
- fletëparaqitje për konkurs;
  - certifikatë të shtetësisë;
  - vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
  - diplomë origjinale - certifikatë për arsim sipëror të mbaruar ose kopje të vërtetuar në noter;
  - vërtetim për përvojën e punës;
  - certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze;
  - dëshmi për test të dhënë psikologjik ose test për integritet;

Fletëparaqitjet për shpalljen me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në arkivin e Konviktit ose në adresën në vijim: Konvikt i shtetëror për studentët "Shkup" - Shkup, rr. "Metropolit Teodosija Golloganov" nr. 26-b, Shkup. Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Shpallja zgjatë pesë (5) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afatet në pajtim me Ligjin për standard të studentëve.

**KËSHILLI DREJTUES  
I KONVIKTIT SHTETËROR PËR STUDENTË "SHKUP" - SHKUP**  
Igor Goshevski

## Shqipja e përdhosur e zëvendëskryetarit shqiptar të Butelit

Shkup, 11 shkurt - Se vet shqiptarët, në të shumtën e rasteve, përdhosin gjuhën shqipe, këtë e dëshmon edhe njoftimi i fundit i zëvendëskryetarit shqiptar të Komunës së Butelit, njëherësh këshilltar komunal i BDI-së në këtë komunë, Naim Salii. Në një postim në Facebook, Salii, duke informuar se edhe zyrtarisht ka marrë vendimin për "zëvendëskryetar të Butelit", në dy fjali në profilin e tij në Facebook, ka shkruar plotë nëntë gabime.

"Te nderuar shok dhe dashamir sot murem mbi supet tona edhe një obligim un mora postin e ZAVENS. KRYETARIT. te KOMUNES.BUTEL", shkruan zëvendëskryetari i Butelit, Naim Salii.

Gabime të tmerrshme gjuhësore zëvendëskryetari shqiptar i Butelit përdorë edhe në secilën përgjigje në urimet që ai ka marrë nga miqtë e tij në FB. "Shendet dhe seksese

Naim Salii shtoi 3 fotografi të reja  
Shkurt 8 në 5:38MD · ©  
Te nderuar shok dhe dashamir sot murem mbi supet tona edhe një obligim un mora postin e ZAVENS. KRYETARIT. te KOMUNES.BUTEL.



patshi gjithmon.flm.", përgjigjet Salii në një urim nga një mik i tij.

Në bazë të nenit 9 paragrafi (1) të Rregullores për procedurën dhe kriteret për shpërndarje të mjeteve për realizim të interesit publik në sport nr. 08-35/1 të datës 4 janar 2018 në pajtim me Programin për zhvillim të sportit dhe të rinjve për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018), Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese për vitin 2018 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018), si dhe Vendimit për publikim të Konkursit për vitin 2018 nr. 08-409/1 të datës 09.02.2018, drejtori i Agjencisë për të rinj dhe sport e Republikës së Maqedonisë, publikon

## KONKURS

## Për ndarje të mjeteve për vitin 2018

Publikohet konkurs për ndarje të mjeteve për vitin 2018, nga:

- Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese për vitin 2018 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018).
- Programit për zhvillim të sportit dhe të rinjve për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018) dhe

- Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese për vitin 2018 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë

Numri rendor	Përcaktimi	Përshkrimi
1.	Participim për financim të federatave nacionale të sportit për shkak të sigurimit të funksionalitetit të tyre, punës së organeve dhe trupave të federatave dhe funksionit të sistemit nacional të sportit	Është planifikuar participim për shkak të sigurimit të funksionalitetit të federatave nacionale të sportit për: punë profesionale të sekretarëve të përgjithshëm dhe administruesve; funksion të organeve dhe trupave; funksionit i sistemit nacional të garave
2.	Participim për financim të klubeve të të rinjve të radhitur pjesëmarrës në sisteme të sportit të organizuara nga federatat nacionale të sportit	Është planifikuar participim për mbështetje të klubeve të të rinjve të radhitur pjesëmarrës në sisteme të sportit të organizuara nga federatat nacionale të sportit.
3.	Participim për financim të punës profesionale në klubet e të rinjve të radhitura, pjesëmarrës në sisteme të sportit, të organizuara nga federatat nacionale të sportit	Është planifikuar participim për federatat nacionale të sportit në financim të punës profesionale me sportistë individë dhe ekupe nacionale në federatat nacionale të sportit.
4.	Participim për aktivitete programore për edukim dhe licencim të trajnerëve dhe personave tjerë profesional në sport (referë, mjekë sportiv, psikologë, nutricionistë, fizioterapeutë etj.)	Është planifikuar participim për aktivitete programore për edukim dhe licencim të trajnerëve dhe personave tjerë profesional në sport.
5.	Participim për financim të projekteve të federatave nacionale të sportit dhe Agjencisë për të rinj dhe sport për masivitet të sportit dhe mbështetje të sportistëve të rinj me të talentuar	Është planifikuar participim për realizim të federatave nacionale të sportit dhe Agjencisë për të rinj dhe sport për avancim dhe zhvillim të sportit në Republikën e Maqedonisë.
6.	Participim në aktivitete programore të federatave nacionale të sportit për veprimtari botuese, për literaturë profesionale dhe shkencore nga sfera e sportit, të së drejtës evropiane dhe nacionale të sportit, si dhe rregullave ndërkombëtare të asociacioneve ndërkombëtare të sportit	Është planifikuar participim në aktivitete programore të federatave nacionale të sportit për veprimtari botuese, për literaturë profesionale dhe shkencore nga sfera e sportit, të së drejtës evropiane dhe nacionale të sportit, si dhe rregullave ndërkombëtare të asociacioneve ndërkombëtare të sportit.
7.	Participim për financim të programeve të federatave nacionale të sportit për luftën kundër dopingut në sport	Është planifikuar participim për realizim të doping kontrollit dhe menaxhim me rezultatet e kontroleve të realizuara për doping.
8.	Participim për financim të aktiviteteve programore për shpresat olimpike të Maqedonisë, selektimi, specializimi i hershëm i sportit dhe karriera e dyfishitë e sportistëve të rinj	Është planifikuar participim për financim të aktiviteteve programore për shpresat olimpike, selektimi i tyre, si dhe specializimi i hershëm i sportit dhe karriera e dyfishitë e sportistëve të rinj
9.	Participim për financim të projekteve për mbështetje të femrës në sport	Është planifikuar participim për financim të projekteve për mbështetje të femrës në sport.
10.	Participim për financim të projekteve për mbështetje të sportit të personave me pengesa në zhvillim dhe nevoja të posaçme	Është planifikuar participim për financim të projekteve për mbështetje të sportit të personave me pengesa në zhvillim dhe nevoja të posaçme
11.	Participim në aktivitete programore të federatave nacionale të sportit për mbështetje dhe zhvillim të sportit për të gjithë dhe kushteve për sport për veteranët e sportit dhe qytetarët e rritur	Është planifikuar participim për financim të projekteve për mbështetje të sportit dhe kushteve për sport për veteranët e sportit dhe qytetarët e rritur.
12.	Participim për mbështetje të federatave nacionale të sportit për furnizim të pajisjeve për ekipet, reprezentacionet dhe individëve për pjesëmarrje në kampionatet evropiane dhe rajonale	Është planifikuar participim për financim të furnizimit të pajisjeve për reprezentacionet dhe individëve për pjesëmarrje në kampionatet evropiane dhe rajonale.

I.	b	
1.	Participim për financim të programeve për mbështetje të sportistëve të rinj të talentuar dhe mbështetje të aktiviteteve programore për specializim të hershëm sportiv	Është planifikuar participim për mbështetje dhe promovim të projekteve të federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancim të sportit të cilat do të promovojnë dhe realizojnë aktivitete për zbulim, specializim të hershëm sportiv dhe përkujdesje për sportistët e rinj të talentuar në më shumë sporte. Në vitin 2018, përparësi ka zhvillimi i sportit shkollor për realizim të kampeve sportive të organizuara për sportistët e rinj të talentuar nga ana e federatave nacionale të sportit.

## 2. Programi për zhvillim të sportit dhe të rinjve për vitin 2018

Numri rendor	Përcaktimi	Përshkrimi
1.	Participim për financim të programeve ndërkombëtare të federatave nacionale të sportit	Është planifikuar participim në realizimin e programeve të federatave nacionale të sportit për pjesëmarrje në sistemin ndërkombëtar të garave. Në vitin 2018, sportistët tanë, ekipet kombëtare dhe klubet sportive do të marrin pjesë në kuadër të kampionateve rajonale, kampionateve evropiane dhe botërore, kupe, kampionateve të hapura dhe llojeve të ndryshme të garave ndërkombëtare.
2.	Participim për financim të garave dhe manifestimeve tradicionale ndërkombëtare sportive	Është planifikuar participim për realizimin e programeve të federatave nacionale të sportit për organizim të garave dhe manifestimeve tradicionale ndërkombëtare sportive. Në Republikën e Maqedonisë mbahen një numër i madh i garave dhe manifestimeve tradicionale sportive në më shumë sporte. Disa prej tyre janë pjesë e Kalendarit për garat e asociacioneve ndërkombëtare sportive, me çka valorizohet edhe vlera dhe rëndësia e tyre.
3.	Participim për mbështetje shkencore të sportit për realizim të hulumtimeve fundamentale në të gjitha segmentet e veprimtarisë sport – Instituti për sport	Janë planifikuar projekte zhvillimore dhe aplikative me interes publik dhe lokal për sportin nacional dhe cilësor, klubet sportive, klubet shkollore sportive, federatat nacionale të sportit dhe asociacionet ndërkombëtare të sportit – Instituti për sport.
4.	Participim për programet e federatave nacionale të sportit për edukim permanent të trajnerëve të sporteve olimpike dhe jo olimpike	Është planifikuar participim për financim të federatave nacionale të sportit për edukim permanent të trajnerëve të sporteve olimpike dhe jo olimpike
5.	Participim për përgatitje të sportistëve nga Republika e Maqedonisë për pjesëmarrje në Lojërat olimpike vepore – Tokio 2020	Është planifikuar participim për realizim të programeve të federatave nacionale të sportit për përgatitje të kandidatëve evident për pjesëmarrje në Lojërat olimpike vepore – Tokio 2020
6.	Participim për organizim të kampionateve evropiane dhe botërore në Republikën e Maqedonisë	Është planifikuar participim për realizim të programeve të federatave nacionale të sportit për organizim të kampionateve evropiane dhe botërore në Republikën e Maqedonisë

Aplikacionet 1 dhe 2 për pjesëmarrje në "Konkurs 2018" merren nga internet faqja e Agjencisë për të rinj dhe sport [www.ams.gov.mk](http://www.ams.gov.mk) ku është dhënë përshkrim i paragrafëve sipas të cilave do të udhëhiqen.

Aplikacionet 1 dhe 2 për pjesëmarrje në "Konkurs 2018" duhet të dorëzohen në Agjencinë për të rinj dhe sport në dorë dhe në mënyrë elektronike më së voni **deri më 22 shkurt 2018 deri në ora 16.30** në adresën:

Agjencia për të rinj dhe sport  
rr. "Makedonija" nr. 38 (Pallati "Panko Brashnarov")  
1000 Shkup  
Me shenjë: PËR KONKURS 2018

Dhe në mënyrë elektronike në e-mail:

Ognen Stojanovski – [ognenstojanovski@hotmail.com](mailto:ognenstojanovski@hotmail.com)  
Natasha Smilevska – [nsmilevska@hotmail.com](mailto:nsmilevska@hotmail.com)

DREJTOR  
Darko Kaevski

KOMUNA E GOSTIVARIT  
ОПШТИНА ГОСТИВАР  
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk  
info@gostivari.gov.mk  
tel. +389 (0) 42 213 511  
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-108/44  
09.02.2018 vit  
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 и 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

## L A J M Ě R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridik të përfshirë në hapësirën e Propozim PDU-së për Bllok 13, KK Gostivar 2 - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e:

PREZANTIMIT PUBLIK  
DHE ANKETËS PUBLIKE

Rreth Propozim PDU-së për Bllok 13, KK Gostivar 2- Komuna e Gostivarit për periudhën e planit 2017-2022, sipërfaqja e përfshirjes ( 22.522 Ha), që kufizohet në mes rrugeve:

- Nga ana veriore për rr. "Zhviko Brajkovski",
- Nga ana jugore për rrugës së re të projektuar "11" sipas PGJU-së të qytetit të Gostivarit,
- Nga ana lindore me rr. "Branko Stanoeviq" dhe
- Nga ana perëndimore për rrugës së re të projektuar "12" sipas PGJU-së të qytetit të Gostivarit.

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit dt. **14.02.2018 (e mërkurë) në ora 12:00.**

Propozim PDU për Bllok 13, KK Gostivar 2 - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 5 ditë pune edhe ate nga **15.02.2018 vit deri 21.02.2018** vit. çdo ditë pune prej orës **08:00-16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizim, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë nga zona konkrete të përfshirë në Planin e shpallur në prezantimin publik mund të parashtrajnë vërejtje me shkrim në fletat anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizim.

Kryetari i Komunës  
Arben Taravari

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 54/2013) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008 dhe 33/2010) SHF "Elpida Karamandi" – Manastir publikon

## SHPALLJE

Për pranimin e punëtorëve për kohë të caktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018  
më së voni deri më 31.08.2018

- Mësimdhënës klasor për mësimin në gjuhën shqipe (pensionim) – 1 realizues me 20 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 20.644,00 denarë.
- Mësimdhënës klasor për mësimin në gjuhën maqedonase (pushim të lindjes) – 1 realizues me 20 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 20.644,00 denarë.
- Mësimdhënës klasor për mësimin në gjuhën maqedonase (pushim mjekësor) – 1 realizues me 20 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 20.644,00 denarë.
- Mësimdhënës të matematikës (zëvendësim për drejtorin) – 1 realizues me 20 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 20.644,00 denarë.
- Mësimdhënës të matematikës (pensionim) – 1 realizues me 20 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 20.644,00 denarë.
- Mësimdhënës të matematikës – 1 realizues me 4 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 4.128,00 denarë.
- Mësimdhënës të gjuhës vllehe – 1 realizues me 4 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 4.128,00 denarë.
- Mësimdhënës të gjuhës frënge – 1 realizues me 8 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 8.256,00 denarë.
- Mësimdhënës të edukatës muzikore – 1 realizues me 20 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 20.644,00 denarë.
- Mësimdhënës të etikës së religjioneve – 1 realizues me 8 orë mësimore dhe pagesë bazë prej 8.256,00 denarë.

Dokumentet e nevojshme:

- Lutje;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Diplomë

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve nga dita e kalimit të afatit për parashtrim të lutjeve. Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri në SHF "Elpida Karamandi" – Manastir, rr. "Vasko Karangelevski" pn Manastir. Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Kontrollimi i njohjes së gjuhës maqedonase do të realizohet më datë 20.02.2018 në ora 12 në lokalet e shkollës.  
Tel. për kontakt: 047 253 798

SHF "Elpida Karamandi" – Manastir  
UD Drejtor: M-r Tatjana Damçevska

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/2015 dhe 27/2016), nenit 79-d të Ligjit për arsim fillor dhe nenit 59-a të Ligjit për arsim të mesëm, ndërsa në lidhje me Pëlqimet e miratuara për punësim për kohë të pacaktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-610/6 të datës 07.02.2018, SHSHFRD Dimitar Vllahov – Shkup publikon

## SHPALLJE PUBLIKE

SHSHFRD Dimitar Vllahov – Shkup ka nevojë për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar me punëtorët për vendet e punës në vijim:

- Nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 Mirëmbajtës i higjienës - Dy (2) realizues

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë të mbaruar arsimin fillor/të mesëm

Orari kohës së punës

- Ditët e punës e hënë – e shtunë/e diel
- Orët e punës në javë 40
- Orari i punës prej ora 06:00 deri në ora 13:00/14:00

Shuma në të holla e pagesës: 12.000,00 denarë

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrajnë:

- Lutje;
- Kopje të letërnjoftimit;
- Dëshmi për arsim të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter);

Afatit për parashtrimin e dokumenteve është pesë (5) ditë nga dita e publikimit të shpalljes. Vendimi për zgjedhje do të realizohet në afat prej 45 ditëve nga kalimi i afatit për paraqitje. Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Dokumentet të parashtrihen në adresën SHSHFRD Dimitar Vllahov – Shkup rr. Narodni heroji nr. 8, Shkup



“Në Spitalin Klinik të Tetovës, konkretisht në Repartin e Gjinekologjisë, për tre vitet e fundit vdekshmëria e foshnjave sillet jo në përqindje, por në promila. Në vitin 2015 ka patur vetëm katër foshnja të vdekura, ndërsa në vitin 2016 kanë vdekur 6 foshnja”, deklaroi kryeshefi Rufati

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 11 shkurt - Rritja e numrit të vdekshmërisë së foshnjave në Klinikat e Shkupit ka bërë që Ministria e Shëndetësisë tashmë të mendojë për përmirësimin e kushteve nëpër klinikat në qytetet më të mëdha, që ajo e Shkupit të mos jetë e stërngarkuar me pacientë. Edhe pse vdekshmëria e foshnjave në Shkup është në nivel të lartë, megjithatë në Spitalin Klinik të Tetovës - në repartin e Gjinekologjisë thonë se numri i vdekshmërisë është shumë i ulët. Kryeshefi i këtij reparti, Nagip Rufati, thotë se që pacientët të mos shkojnë në Shkup, duhet që të bëhen ende shumë investime në aparaturë, por edhe të investohet në kuadrin profesional sepse shumë mjek janë para pensionit. Sipas tij, për tre vite ka patur 14 vdekje të foshnjave që është një përqindje e ulët në krahasim me Shkupin.

“Spitali Klinik i Tetovës ka një numër të konsiderueshëm të lindjeve dhe numër të vogël të vdekshmërisë së foshnjave. Ne kemi rezultate të mira, mirëpo duke filluar në të gjitha rastet që janë nën javën e katërt (gestagjene), dërgohen në Spitalin Klinik të

NIVEL I ULËT I VDEKSHMËRISË SË FOSHNJAVE NË TETOVË

# KËRKOHET PËRMIRËSIM I KUSHTEVE DHE KUADRIT



Shkupit për arsye të protokolleve dhe në interes të foshnjave të posalindura. Në Spitalin Klinik të Tetovës, konkretisht në Repartin e Gjinekologjisë dhe Akusherisë për tre vitet e fundit vdekshmëria e foshnjave sillet jo në përqindje, por në promila. Në vitin 2015 ka patur vetëm katër foshnja të vdekura, ndërsa në vitin 2016 kanë vdekur 6 foshnja”, deklaroi kryeshefi Rufati. Ai ka folur edhe për pacientët që kërkojnë shërbime mjekësore në Shkup. Sipas tij, kjo është për shkak se sistemi shëndetësor e lejon një gjë të tillë.

“Nuk është e vërtetë se ne i

dërgojmë pacientët në Shkup, sistemi shëndetësor është reformuar disa herë dhe nga reformimet që kanë dalë, shihet se ka shumë mangësi, sepse të gjithë pacientët i udhëheq gjinekologu amë dhe ne në komunën tonë kemi numër të vogël të mjekëve amë, të cilët udhëheqin gra josh-tatzëna dhe ato shtatzëna. Ky numër i vogël i mjekëve amë gjinekolog nuk mund të menaxhojnë me një numër të madh të pacientëve prej 6 mijë deri në 10 mijë. Pacientët me këtë rast, vetvetiu sistemi shëndetësor, u ka lejuar pacientëve të drejtohen në Kli-

nikat e Shkupit, apo me udhëzim të mjekëve amë, edhe pse kapacitetet tona për pacientët e qytetit tonë janë që të gjitha gratë të mund të lindin, të kryhen operacione apo të marrin të gjitha shërbimet mjekësore në repartin tonë”, thotë ai. Sipas tij, vend për përmirësim çdoherë ka sa i përket kushteve në këtë repart dhe duhet që Ministria e Shëndetësisë të përgjigjet në kërkesat e tyre si me aparaturë, por edhe me kuadër.

“Ne kemi nevojë shumë për përmirësim të kushteve, kemi bërë disa kërkesa në drejtorinë e Spitalit, e cila më pas i ka adresuar në



NAGIP RUFATI

Deri më tash janë bërë pak përmirësime, por kemi nevojë për disa aparatura të sofistikuar, të shumëpërfolura disa herë nga Ministria e Shëndetësisë e të cilët ende nuk janë realizuar. Po ashtu kemi nevojë për numër të madh të mjekëve specialist gjinekolog akusher dhe pediatër për këtë repart. Kemi bërë kërkesa për rritjen e numrit të kuadrit, por nuk kemi përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë, sepse kemi një numër të madh të kolegëve që janë para pensionit dhe këto kuadro duhet që të zëvendësohen

Ministrinë e Shëndetësisë. Deri më tash janë bërë pak përmirësime, por kemi nevojë për disa aparatura të sofistikuar, të shumëpërfolura disa herë nga Ministria e Shëndetësisë e të cilët ende nuk janë realizuar. Po ashtu kemi nevojë për numër të madh të mjekëve specialist gjinekolog akusher dhe pediatër për këtë repart. Kemi bërë kërkesa për rritjen e numrit të kuadrit, por nuk kemi përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë, sepse kemi një numër të madh të kolegëve që janë para pensionit dhe këto kuadro duhet që të zëvendësohen”, deklaroi Rufati.

Përndryshe, arsyetimi i Ministrisë së Shëndetësisë për vdekshmërinë e foshnjave në Shkup ishte se atje ka stërngarkim të pacientëve dhe numri i lindjeve në vit është rreth 6000, ndërsa kapacitetet janë për maksimum 4 mijë lindje.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, pëlqimit numër: 12-11469/3 të datës 05.12.2017; nr. 12-213/2 të datës 18.01.2018 dhe 12-11469/8 të datës 31.01.2018 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Vendimit nr. 02-65/1 të datës 09.2018 SHF “Goce Dellçev” n- Viniçë publikon

## SHPALLJE Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2017/2018

SHF “Goce Dellçev” – Viniçë ka nevojë për plotësimin e vendeve të zbrazëta të punës për vitin shkollor 2017/2018, edhe atë:

1. Një mësimdhënës të matematikës me orar të plotë të punës 20 (njëzet) orë mësimore, për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 20.644,00 denarë.
2. Një mësimdhënës të matematikës me orar jo të plotë të punës 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë mësimore, për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 16.515,00 denarë.
3. Një mësimdhënës të fizikës me orar jo të plotë të punës 4 (katër) orë mësimore, për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 4.129,00 denarë.
4. Një mësimdhënës të gjuhës gjermane me orar jo të plotë të punës 4 (katër) orë mësimore, për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 4.129,00 denarë.
5. Një mësimdhënës të etikës jme orar jo të plotë të punës 4 (katër) orë mësimore, për kohë të caktuar, zëvendësim për punëtorin në pushim të lindjes, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 4.124,00 denarë.
6. Një mësimdhënës të etikës së religjioneve me orar jo të plotë të punës 6 (gjashtë) orë mësimore, për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 6.193,00 denarë.
7. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me orar jo të plotë të punës 4 (katër) orë mësimore, për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 4.129,00 denarë.
8. Një mësimdhënës të gjuhës angleze me orar jo të plotë të punës 13 (trembëdhjetë) orë mësimore, për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 13.419,00 denarë.
9. Dy mësimdhënës të mësimit klasor me orar të plotë të punës për kohë të caktuar 20 (njëzet) orë mësimore, ndërsa më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 20.644,00 denarë.
10. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me orar të plotë të punës 20 (njëzet) orë mësimore, për kohë të caktuar, si zëvendësim për drejtorin, më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 20.644,00 denarë.
11. Një defektolog me orar të plotë të punës 40 orë pune në javë, për kohë të caktuar të punës, ndërsa më së voni deri më 31.08.2018, neto pagesa bazë 20.644,00 denarë, orari i punës prej ora 07:00 deri në ora 15:00 prej ditës së hënë deri ditën e premte.
12. Një mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës 40 orë pune në javë, për kohë të caktuar të punës, neto pagesa bazë 12.000,00 denarë, orari i punës është me ndërrime, ndërrimi i parë prej ora 05:00 deri në ora 13:00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13:00 deri në ora 20:00 prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Orari i punës për vendet e punës prej 1 deri 10 është prej ora 07:00 deri në ora 13:00 ose prej ora 13:00 deri në ora 19:00 në ditë e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte sipas orarit të caktuar sipas orëve të mësimit.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme në pajtim me nenin 77 dhe 80 të Ligjit për arsim fillor dhe rregulloren për sistematizim të vendeve të punës.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme dorëzohen deri në SHF “Goce Dellçev” – Viniçë rr. “Lupço Santov” nr. 36 – Viniçë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet sipas afatit të paraparë ligjor.

SHF “Goce Dellçev” – Viniçë

Telefoni për kontakt: 033-361-775, e-mail: gocedellcevVin@yahoo.com

Në bazë të nenit 131 të Ligjit për arsim të lartë,

## Fakulteti teknik – Manastir Publikon KONKURS për zgjedhje të mësimdhënësit

Shpallet konkurs për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor edhe atë:

- 1) një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat: Përgatitje për shtyp dhe DTP (Desktop Publishing); Teknologjitë e shtypit (format, procedurat, përpunimi); Organizimi dhe metodologjia e projektimit të sistemeve përlogaritime (sisteme harduerike, softuerë).
- 2) një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat: Makinaria energjetike dhe procesuese (Shkëmbimi i ngrohjes; Sisteme me më shumë faza); Termodinamika teknike; Teknologjia e përpunimit të metaleve dhe makinave të veglave.
- 3) një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat: Makinaria energjetike dhe procesuese (Shkëmbimi i ngrohjes; Sisteme me më shumë faza); Ngrohja dhe klimatizimi i sistemeve të ngrohjes; Termoteknika dhe aparatet dhe stacionet termoteknike.
- 4) një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat: Menaxhim dhe kontroll të komunikacionit (komunikacionet dhe nyjat, teknikat dhe teknologjitë e rregullimit të komunikacionit, sistemet e informacionit, sistemet e komunikacionit).
- 5) një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat: Materialet e reparteve (derivatet dhe teknologjitë për konversion të energjisë); Ngrohje dhe klimatizim të sistemeve të ngrohjes; Teknikat dhe sistemet e ftohjes; etj.
- 6) një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat: Makinaria e përgjithshme, projektimi dhe konstrukcionet makinerike; Elementet makinerike dhe sistemet teknike; Teknologjia e përpunimit të metaleve dhe makinat e veglave; Mekanika teknike dhe mekanika e trupit të fortë.

Kushtet për zgjedhje janë të përcaktuara me Ligjin për arsim të lartë.

Fillimi, mbarimi dhe orari i punës dhe shuma e të hollave të pagesës (në bruto shumë: 43.184,00 den., 46.534,00 den., 51.310,00 den.) për mësimdhënës janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin është zgjedhur mësimdhënësi (docent, profesor i pavarur, profesor i rregullt).

Kandidatët për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë edhe: certifikatë të lindjes, biografi, dokument për arsim të arritur, listë të punimeve shkencore dhe profesionale dhe një kopje prej të njëjtave.

Fletëparaqitjet do të dorëzohen përmes postës në adresën: Fakulteti teknik – Manastir, rr. “Makedonska fallanga” 33, ose në arkivin e Fakultetit teknik – Manastir në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

FAKULTETI TEKNIK – MANASTIR

# Integrimi në BE kundër interesave të klasave politike në Ballkan



Nga Augustin PALOKA

Përderisa i tërë opinioni i rajonit të Ballkanit Perëndimor, por edhe më gjerë, është i preokupuar në atë se sa e qartë do të jetë e ardhmja e vendeve të rajonit në rrugën e integrimi në BE, e formuluar në Strategjinë e Komisionit Evropian, disa politikanë në pushtet, në vendet e Ballkanit, kanë një hall tjetër. Ata janë të fokusuar shumë në një fjalë në draftin e fundit të dokumentit të Strategjisë ku përmendet se në rajon "shtetet tregojnë shenja të qarta të kapjes së shtetit, përfshirë edhe lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës". Termi "kapja e shtetit" është përmendur nga analistë të pavarur shpesh, është përmendur edhe në bisedat e politikanëve perëndimorë (sepse atyre lindorë një gjë e tillë duket se nuk u pengon!), por rrallë herë është shkruar edhe në dokumente që bëhen publike. Edhe BE-ja ka hezituuar t'i shkruajë fjalitë e tilla në dokumente, sepse një konstatim i tillë gjithmonë bie në kundërshtim me përmendjen e progresit të këtyre vendeve. Dhe, qartë, si mund të përmendet se ka pasur progres në një rajon ku ka elemente të kapjes së shtetit. Dhe cila qeveri e rajonit mund të pranojë se në vendin e tij ka kapje të shtetit. Ata mund të thonë në vete, por jo edhe të pranojnë para të tjerëve se "po ka kapje të shtetit, ne e kemi kapur!". Diplomatat dhe zyrtarët e BE-së në Bruksel kanë treguar se zemërimi i disa njerëzve në pushtet, në disa vende të Ballkanit, ka qenë aq i madh për shkak të këtij formulimi sa që kanë kërcënuar se nuk do ta mbështesin publikisht këtë strategji. Por, në anën tjetër, nëse Komisioni Evropian bën lëshime ndaj politikanëve të rajonit, atëherë mund të shkaktojnë konflikte me qeveritë e disa vendeve anëtare të BE-së, të cilat e dinë se ka elemente të tilla në shtetet e Ballkanit. Sepse, nga raportet e Komisionit Evropian dhe zyrave e delegacioneve të BE-ë në rajon ato qeveri kanë raporte edhe nga ambasadat dhe shërbimet e tyre. Dhe kanë sa të duash shembuj të "kapjes së shtetit". Ndërsa në vetë vendet e rajonit për "kapjen e shtetit" flasin politikanët e opozitës derisa ata të mos vinë në pushtet dhe vetë e "kapin shtetin". Pastaj ndërrohen rolet dhe për "kapje shteti"

flasin ata që janë larguar nga pushteti dhe janë bërë opozitë.

Pa marrë parasysh se a do të mbetet apo jo referenca në "kapjen e shtetit" në dokumentin e Komisionit Evropian, është e qartë se Komisioni Evropian beson se ka kapje shteti në rajon. Përndryshe nuk do ta shkruanin në draft. Vendosija e këtij formulimi tregon realitetin që qytetarët e rajonit e shohin me sytë e tyre, ndërsa heqja e kësaj reference do të ishte vetëm kompromis politik çfarë BE-ja ka bërë me vite duke e ndihmuar edhe vetë kapjen e shtetit dhe duke iu dalë në ndihmë atyre që janë përgjegjës për këtë. Komisioni Evropian, e sidomos shtetet serioze anëtare të BE-së, mendojnë vërtet se në vendet e Ballkanit Perëndimor ka shenja të "kapjes së shtetit, përfshirë edhe lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës". Për këtë situatë përgjegjëse janë forcat politike që dominojnë qash e dhjetëra vjet në këto shtete, edhe pse në disa raste i kanë ndërruar rolet duke qenë në pushtet ose opozitë. S'ka nevojë të përmendim as emrat e shteteve e as të politikanëve, sepse ky është fe-

no- men në të gjitha shtetet e rajonit.

Të presësh tash që për hir të "perspektivës evropiane" të njëjtit të çrrenjosin korrupsionin është jo-reale. Prandaj ose integrimi në BE është kundër interesave të tyre, ose për integrim në BE kusht është edhe largimi i tyre nga skena politike. Prandaj edhe duhet të mbetemi skeptikë për të ardhmen e integrimi evropiane të rajonit. Nëse i shohim kërkesat dhe ofertat e Komisionit Evropian për një të ardhme konkrete evropiane të vendeve të rajonit të Ballkanit, atëherë bëhet e qartë se sa e vështirë është të realizohet ky qëllim. Sepse nëse vërtet arrihen standardet e larta evropiane, nuk do të mund të ketë më dhënie të tenderëve duke shkëlur parimet e tenderimit publik. Nuk mund të ketë më ndikime në gjykata me qëllime politike, çfarë dyshohet se kanë bërë edhe vetë përfaqësuesit e BE-së në Kosovë, nuk mund të ketë financim jotransparent të partive politike, nuk mund të ketë më ndikim në mediën e pavarur. Duhet të heqin dorë nga punësimi i të afërmeve apo simpatizantëve partiakë në administratë. E nuk është e lehtë të heqësh dorë nga privilegjet e tilla, se-

Komisioni Evropian e sidomos shtetet serioze anëtare të BE-së mendojnë se në vendet e Ballkanit Perëndimor ka shenja të "kapjes së shtetit, përfshirë edhe lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës". Për këtë situatë përgjegjëse janë forcat politike që dominojnë tash e dhjetëra vjet në këto shtete, edhe pse në disa raste i kanë ndërruar rolet duke qenë në pushtet ose opozitë



pse lidhja me krimin e organizuar dhe korrupsionin, nepotizmi, ndërhyrja në gjykata, polici dhe media janë privilegj në vendet e Ballkanit e jo ndonjë e keqe.

Ky privilegj të sjell respekt më shumë sesa kritikë. Sepse "forca e bën fuqinë!", siç do të thotë një politikan në Kosovë, e forcën e kanë ata që janë në pushtet, në vendet e rajonit e kundër tyre janë ata që duan të jetë në vendin e tyre që të gëzojnë të njëjtat privilegje. Nëse në të njëjtën kohë, për shkaqe politike, keni mirëkuptimin edhe nga BE-ja, atëherë mbështetja dhe respekti bëhen komplet. Strategjinë e Komisionit Evropian, e cila bën të qartë se përderisa vendet si Mali i Zi dhe Serbia, në rastin më të mirë, do të mund të hynin në BE pas tetë vjetësh, ndërsa vendet si Kosova e Bosnja ndoshta pas 15 vjetësh, duhet kuptuar edhe si porosi se deri atëherë duhet seriozisht ndryshuar shoqëritë dhe shtetet në rajon. Sepse, nëse asgjë tjetër, atëherë një porosi Komisionit Evropian e jep qartë: Vendet e rajonit do të hyjnë në BE, por jo në gjendjen në të cilën janë sot. Do të shtonin edhe "jo me politikanët të cilët i kanë sot". (koha.net)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet pdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 11 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

## FC Shkupi huazon Demirin te Vëllazërimi

Shkup, 10 shkurt - Skuadra e Shkupit ka vazhduar me ritëm të shtuar përgatitjet për sezonin pranveror, pasi me 14 shkurt luan dhe ndeshjen e parë ndaj ekipit Akademija Pandev. Ndërkohë nga klubi njoftuan se sulmuesi 22 vjeçar Husein Demiri, i cili është pjesë e Shkupit nga sezoni 2015/16, gjashtë muajt e ardhshëm do të luajnë si huazim për ekipin e KF Vëllazërimi të Kërçovës, skuadër kjo që kërkon rikthimin në elitën e futbollit vendor. "Urojmë që Demiri të ketë paraqitje sa më të mira dhe të ndihmojë skuadrën e Vëllazërimin në arritjen e synimeve për kthim në Ligën e Parë", pohojnë për faqen e tyre zyrtare nga FC Shkupi.



## FUTBOLLISTËT SHQIPTARË NË EVROPË

Javën që e lam pas ishte e suksesshme për futbollistët shqiptar nga Maqedonia që luajnë kampionatet e ndryshme. Jo vetëm që ishin të rregullt, por ata edhe u regjistruan në listën e golashënuesve duke filluar nga Arijan Ademi (Dinamo Zagreb), Leonard Zhuta (Rijeka), derisa, Naser Aliji arriti fitoren e parë në fanellën e Entella

*Shkup, 11 shkurt* - Arijan Ademi pas rikthimit nga suspendimi, po luan gjithnjë më mirë e më mirë. Së fundmi futbollisti shqiptar i Dinamo Zagrebit shënoi dy gola në fitoren e skuadrës së tij 2-4 përballë Osijekut, e Muzafer Ejupit dhe Eros Grezdës. Ademi, dy golat e tij i shënoi në minutën e 38-të dhe 68-të, ndërsa një nga gjithsejtë dy golat që i shënoi Osijeku, e shënoi gjakovari Grezda, kurse Muzafer Ejupi luajti 66-të minuta, që më pas të zëvendësohet nga shoku i tij Pusic. Pas kësaj fitore Dinamo bindshëm kryeson në tabelën e klasifikimit me 53 pikë, 15 më shumë se Rijeka dhe Hajduku, por që kjo e fundit ka një ndeshje më pak.

### EUROGOLI ZHUTËS

Leonard Zhuta ka shënuar një eurogol për Rijekën në fitoren 4:0 ndaj Istras në kuadër të kampionatit kroat. Në minutën e 90-të Zhuta ekzekutoi për mrekulli gjuajtjen

# ADEMI SHËNON DY GOLA NDAJ OSIJEKUT TË EJUPIT



e lirë, gjuajtje të cilën nuk kishte aspak mundësi ta ndal portieri mysafir. Ndryshe, për futbollistin nga Struga ky ishte goli i parë sezonal në kampionatin kroat, derisa pas kësaj fitore Rijeka renditet në pozitën e dytë me 38-të pikë.

### ALIJI ZHVILLON 90-TË MINUTAT E PARA

Skuadra e Virtus Entella për të cilën luan mbrojtësi i kombëtares shqiptare Naser Aliji, ka shënuar fitore minimale prej 1-0 si mysafir i Ternanës, në takimin e vlefshëm të javës së 25-të, të zhvilluar. Mbrojtësi kumanovar luajti 90-të minuta dhe sipas mediave italiane ai në tërësi ka arsyetuar besimin e marë

nga trajneri i tij pasi ishte shtylla kryesore në krah tek skuadra e Virtus Entella. Me këtë fitore, Virtus Entella ka marrë tre pikë të mëdha me të cilat ngritë shpresat për mbijetesë në Serie B të Italisë.

Skuadra e Alijit për të cilin ishte kjo ndeshja e parë në të cilën 90 minuta kaloi në fushë, ka grumbulluar 27 pikë, pas 25 javëve të luajtura, pesë më shumë se Ternana e vendit të fundit.

## CIKALSHI ARRIN NË KUOTËN E KATËR GOLAVE

Sokol Cikalleshi ka shënuar një dygolësh në kampionat për skuadrën e Osmanlisporit, duke e ndihmuar këtë të fundit të marrë një barazim mjaft të vlefshëm në transfertën ndaj Goztepesë. Sulmuesi kavajas u fut në fushë në pjesën e dytë, kur rezultati ishte 2-1 për vendasit dhe riktheu baraspeshën në minutën e 59'. Vendasit kaluan sërish në minutën e 84-t, por ishte sërish Cikalleshi, që në minutën e 6 shtesë ekzekutoi një penallti, duke shënuar golin e dytë personal dhe atë me vlerën e barazimit për skuadrën e tij. Cikalleshi ka shënuar 4 gola në kampionat, për skuadrën e Osmanlisporit, që kur u transferua në fund të verës së 2017-ës.

## Marku triumfon ndaj kimboksierit boshnjakut Mutfiç

Kimboksieri shqiptar, Florian Marku ka triumfuar ndaj boshnjakut Xhevad Mutfiç. Në ndeshjen e zhvilluar në Linz të Austrisë, Marku ka marr një fitore të madhe dhe të shpejt ndaj kimboksierit boshnjak. Florian ka arritur ta fitoj duelin mas vetëm dy minutave lojë, pasi pas dominimit të thellë e ka dominuar kundërshtarin të tërhiqet dhe ta dorëzoj duelin. Kjo pasi, nga goditjet e forta nga Marku, boshnjaku Mutfiç theu hundën dhe nuk mundi ta vazhdojë duelin. Pas ndeshjes, kimboksieri shqiptar i ka falënderuar të gjithë, teksa ka thënë se i përfaqëson gjithë shqiptarët. "Kundërshtari më tha mua se do të boksojë, por ai nuk e bën dot as me një raund ndaj meje", ka thënë fillimisht Marku. "Unë përfaqësoj vetëm flamurin shqiptar, i falënderoj të gjithë", përfundoi kimboksieri shqiptar.



## "Liria" e bën për vete edhe Nurovin

*Shkup, 11 shkurt* - Përkundër asaj se në futboll janë transferimet më të mëdha, kësajori edhe sporti i mundjes nuk ka ndenjur duar kryq dhe ka punuar që në vendin tonë të ketë transferime të bujshme. Befasia e ditës së fundit, është transferimi më i madh në këtë afat kalimtar, ku mundësi

Magomedgaxhi Nurov është bashkuar me KM "Liria". Pas Halil Zubairovićit edhe Magomedgaxhi Nurov do të jetë pjesë e klubit më të suksesshëm në vendin tonë, me çka KM "Liria" me gjithë përforcimet e reja dhe kuadrin e vjetër, tani më mund të synoj suksese ekipore edhe në arenën ndërkombë-

tare dhe jo vetëm në mundjen e vendit tonë. Nga klubi njoftojnë se prezantimi i Nurovit do të bëhet ditëve në vijim, kur ai do të arrij në Shkup nga Rusia, i cili pritet të jetë pjesë e KM "Liria" në kampionatin zgjedhor për senior, që do të zhvillohet të shtunën e ardhshme në Shtip.


## AKIL GJAKOVA FITON MEDALJEN E ARTË NË PARIS

# Ëndrra mu bë realitet

Xhudisti kosovar, Akil Gjakova, ka arritur të stoliset me medaljen e artë në "Grand Slam" të Parisit. Në finalen e kategorisë -73 kilogramë, Gjakova triumfoi ndaj xhudistit Lasha Shavdatuashvili nga Gjeorgjia. "Mbreti i Parisit që flet Shqip sonte! Dhurata për 10 vjet shtet. Akili i artë në 'Grand Slam Paris'. Kampioni Olimpik i gjunjëzuar në finale!", ka shkruar trajneri Driton Kuka menjëherë pas triumfit të Akilit


në finale. Derisa, super xhudisti kosovar, Akil Gjakova, e ka bërë realitet ëndrrën për të triumfuar në grand slam në të madh të xhudos. "Ëndrrat bëhen realitet", ka shkruar Gjakova në llogarinë e tij personale në "Facebook". "Futues i turneut më të madh të xhudos, grand slamit në Paris", ka shtuar ai. Xhudisti kosovar ka fituar dy medalje në këtë fillim vit, pas të argjendts që e rrëmbeu në turneun grand prix në Tu-

nizi muajin e kaluar. Ndërkohë, Distria Krasniqi e ka fituar medaljen e bronzit në grand slam në të rëndësishëm në xhudo në Paris duke e mposhtur xhudisten japoneze Natsumi Tsunoda. Distria doli e bronzit në kategorinë deri 52 kilogramë. Derisa, Kjo është medalja e parë e bronzit dhe e dyta në total në këtë fillim vit për Krasniqin, pasi ajo e fitoi të argjendts në muajin e kaluar në turneun grand prix në Tunizi.



## LULZIM ISMAILI, BOKSIER

“Synimi im është që këtë vit të fitoj ‘Gongun e artë’ dhe ti jap fund karrierës në boks amateur dhe të filloj në boks profesional. Aty kuptohet do të ndeshem me boksier më të fortë nëpërmjet të cilëve do të synoj edhe titullin e kampionit të botës”, pohon Ismaili



# SYNOJ “GONGUN E ARTË” DHE TI JAP FUND KARRIERËS NË BOKSIN AMATOR

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 11 shkurt - Shqiptarët njihen për talentin e madh që kanë në sportet luftarake në përgjithësi edhe sportin e boksit në veçanti. Luan Krasniqi, Elvir Muriqi, vëllezërit Seferi, Haxhi Krasniqi, Erzen Rrustemi, Agron Xhila, Fatlum Zhuta e shumë të tjerë, janë sinonim i sukseseve të shënuara të shqiptarëve në sportin e boksit, duke u bërë në të njëjtën kohë motiv dhe stimul për shumë të rinj që të vazhdojnë rrugën e atyre drejt arritjes në majat e boksit. Ka shumë klube që kultivojnë këtë sport marcial, por kësaj radhe do të ndalemi te klubi i boksit “Çair” nga Shkupi. Ky klub i cili aktualisht është kampion i Maqedonisë, është bërë çerdhe e shumë talenteve të këtij sporti. Ndryshe së fundmi këtij klubi i është bashkuar një boksier me perspektivë të madhe Lulzim Ismaili, i cili në të kaluarën ka qenë pjesë e KB “Shkëndija Boks”. Për gazetën KOHA, Ismaili rrëfen hapet e parë me boks, luftërat që i ka zhvilluar, sukseset e deritanishme dhe synimet e tija në të ardhmen. “Me boks merrem prej moshës tetë vjeçare te KB ‘Shkëndija Boks’ nën udhëheqjen e trajnerit



Halim Abazi, i cili është edhe themelues i klubit të boksit”, fillon rrëfimin e tij Ismaili.

## PËRKRAHJE VETËM NGA BABAI

Kur filloi të merret me boks, Ismaili tregon se kjo nuk i ka pëlqyer të gjithëve te familja e tij, derisa përkrahje ka pasur vetëm nga babai i tij. “Për mua boks ishte sporti më i dashur me çka edhe fillova të merrem. Kam ushtruar edhe sporte tjera, por boks ishte njëri ndër sportet më të preferuara, dhe zgjedha këtë profesion. Sa i përket familjes, ata nuk ishin me mua në këtë qëllim. I vetmi që dëshironte që unë të merrem me këtë sport ishte babai. Pastaj, dëshira ishte mbi të gjitha sepse unë doja dhe vendosa që të merrem me

boks dhe nuk jam penduar aspak”, shtoi më tej boksieri Ismaili.

## NË MAQEDONI NUK KA KONKURRENCË

Në vazhdim Ismaili flet për luftën e parë që e ka pasur, ndërsa thotë se në Maqedoni nuk ka konkurrencë, ndërsa sukcesi më i madh i tij deri më tani ka qenë turniri “Adem Jashari” në Kosovë. “Lufta ime e par ka qenë në kuadër të Ligës së parë të Maqedonisë. Boksiva kundër boksierit nga Shtipi dhe fatkeqësisht humba me rezultatin e ngushtë 2-1. Por, kjo fitore më dha shtytje edhe më të madhe që unë të vazhdoj të punoj maksimalisht për sfidat tjera. Në fakt kjo edhe ndodhi, pasi në Maqedoni nuk kam konkurrencë duke u sh-



pallur pesë herë kampion i shtetit. Pastaj kam marr pjesë në shumë turnirë të fortë të cilët janë në kalendarin e “AIBES” “EUBC” sikurse është ‘Gongu i Arta’, ‘Adem Jashari’, ‘Zllatna Rukavica’ e të tjerë. Derisa, suksesin më të mirë deri më tani e kam arritur në Kosovë, në turnirin ‘Adem Jashari’ ku nga dy lufta arrita po aq fitore në gjysmëfinale dhe finale arrita fitore dhe në fund u shpalla nga juria si boksieri më teknik i turnirit”, tregon Ismaili.

## XHOSHUA, BOKSIERI I PREFERUAR,

### SYNON MEDALJE NGA KE

Si çdo boksier, edhe Lulzimi ka boksierin e tij të preferuar, ndërsa

në fund tregoi edhe synimet e tij. “Boksieri im i preferuar është Entoni Xhoshua, ndërsa na boksierët shqiptar pa dyshim se është Haxhi Robin Krasniqi, për të cilin besoj se së shpejti do të fitoj titullin e kampionit të botës. Ndërkohë, synimi im është që këtë vit të fitoj ‘Gongun e artë’ dhe ti jap fund karrierës në boks amateur dhe të filloj në boks profesional. Aty kuptohet do të ndeshem me boksier më të fortë nëpërmjet të cilëve do të synoj edhe titullin e kampionit të botës. Duke marr parasysh se me 24 mars në Rumani është Kampionati Evropian për U 22, synoj të fitoj medalje”, përfundoi Lulzim Ismaili, boksier i KB “Çair”.

MAURIZIO SARRI AKUZON FEDERATËS PËR KALENDARIN

# JUVENTUSI LUAN GJITHNJË PARA NESH

Sipas Sarrit, fakti që Juventus luan shpesh një ditë apo disa orë para Napolit vë nën një presion të madh skuadrën e tij. Natyrisht që kjo bëhet për shkak të kalendarit më të ngjeshur që kanë bardhezinjtë, që luajnë edhe në "Champions League" të martën ose të mërkurën



## E kam gati formacionin për PSZH-në

Të mërkurën, skuadra e Real Madridit do të presë në fushën e saj rivalët e PSZH-së, takim i vlefshëm për "Champions League", një përballje mes dy prej skuadrave pretendente për fitimin e këtij trofeu. "Merengues" kanë fituar dy edicionet e fundit të "Champions", por këtë sezon po zhgënjëjnë në La Liga dhe kjo ka vënë në dyshim edhe rrugëtimin e tyre në Europë. Por për trajnerin Zinedin Zidane asgjë nuk është e pamundur, madje ai është optimist për kalimin e turit, duke deklaruar se ka një ekip të fortë. Motivim e besim lindur nga fitorja 5-2 që "los blancos" arritën të shtrunën ndaj Real Sociedadit, ndeshje ku disa nga titullarët qëndruan pushim apo luajtën pak, për të qenë gati për sfidën ndaj PSZH-së. "E kam gati formacionin me të cilin do të luajë të mërkurën ndaj PSZH-së. Nuk kam asnjë dyshim", tha Zidane, krejt ndryshe nga kolegu i tij Unai Emery, që tha se ka shumë dyshime për këtë sfidë. "Të gjithë janë gati për të luajtur të mërkurën në 'Champions', por unë nuk do të zbuloj asgjë deri para fillimit të takimit. Të gjithë janë gati për luftë dhe kjo është e rëndësishme, pasi duam të tregojmë se kush jemi, pavarësisht rezultateve jo fort të mira këtë sezon", tha trajneri francez, që ka mbetur i kënaqur nga paraqitja e skuadrës dje në La Liga. "E kontrolloam ndeshjen dhe bëmë disa ndryshime në funksion të PSZH-së. Të mërkurën kemi një ndeshje tjetër të vështirë, por jemi gati për të treguar se sa vlejme", deklaroi Zidane.

Trajneri i Napolit, Maurizio Sarri, ka ngritur zërin pas fitores 4-1 të skuadrës së tij ndaj Lazio dje në sfidën e radhës në Serinë A, duke kritikuar Federatën Italiane për kalendarin e ndeshjeve. Sipas tij, fakti që Juventus luan shpesh një ditë apo disa orë para Napolit vë nën një presion të madh skuadrën e tij. Natyrisht që kjo bëhet për shkak të

kalendarit më të ngjeshur që kanë bardhezinjtë, që luajnë edhe në "Champions League" të martën ose të mërkurën. "Unë mendoj se kjo situatë duhet të ishte parashikuar që më parë, kur doli kalendarin. Unë bëra një kritikë, që Juventus luan shpesh para Napolit, duke qenë se janë në 'Champions', por mund të gjendet një mënyrë që të jemi

të barabartë. Kjo vë nën tryzni skuadrat, lojtarët, trajnerët, ndaj nuk më duket e drejtë", tha Sarri, që vazhdon të jetë me Napolin e tij në krye të Serisë A, me 1 pikë më shumë se Juventus. "Pjesa e parë ishte e dobët, ramë në kurth dhe na u deshën 45 minuta që të kuptonim se ku duhet të ndërhyjmë. Gjithsesi, fitorja ndaj Lazio

ishte e rëndësishme në shumë aspekte, pasi mposhtëm një ekip të fortë dhe u rikthyem të parët dhe kjo është gjëja që ka më shumë rëndësi. Duke administruar qarkullimin e topit e patëm më të lehtë të fitonim dhe kjo tregoi se jemi një skuadër që dimë të vuajmë dhe fitojmë", deklaroi trajneri Sarri.

## Kin, e ardhmja e Totenhemit

Sërish një fitore nën shenjën e "uraganit" Harri Kin. Totenhami fitoi derbin e Londrës Veriore përballë Arsenalit falë një supergoli me kokë të sulmuesit të kombëtares angleze i cili kryeson listën e golshënuesve në Angli dhe aktualisht po përjeton një moment të shkëlqyer forme. E ardhmja e bomberit 24-vjeçar kohët e fundit po lidhet shpesh me një kalim të mundshëm tek Reali i Madridit në verë, por Maurizio Pochettino trajneri i Sparsave nuk mendon aspak kështu. Në një intervistë tekniku argjentinas ka blinduar xhevahirin e tij duke deklaruar. "Kin është e tashmja dhe e ardhmja e Totenhemit, është jashtëzakonshme ajo që ai po bën. Jam shumë i kënaqur dhe shumë i lumtur që kam në skuadër një futbollist të tillë", deklaroi Pochettino.



## Fred, blerja e re e Sitit

Manchester Siti nuk di të ndalet në merkato. Edhe pse dritarja për afrimin e lojtarëve është e mbyllur, klubi anglez ka kompletuar pothuajse afrimin e mesfushorit brazilian Fred nga Shakhtar, për verën e ardhshme. 24-vjeçari ishte pranë firmës me Sitin që në merkaton e dimrit, por blerja e Laporte frenoi një goditje të dytë milionere, pasi Fred do t'i kushtojë Manchesterit plot 50 milion euro. Për zyrtarizimin e kësaj goditjeje pritët vetëm afrimi i fundit të sezonit aktual. Braziliiani pikati në dy përballjet e "Championsit" mes Manchester Sinit dhe Shakhtarit, duke bindur Guardiolen të paguajë shifrën marramendëse për kartonin e tij.

## Milani shënjestron Ligën e Kampionëve



13 pikë në 5 ndeshjet e fundit, një renditje që bëhet gjithnjë e më shumë interesante për Milanin, që tani duket se ka dalë nga kriza dhe synon të arrijë objektivat që kishte në fillim të këtij sezoni. Që do të thotë

një vend në "Champions League". Kuqezinjtë fituan dje 4-0 ndaj Spal, një rezultat që tregon se Milani tani shënon më shumë dhe vuan më pak. "E dinim që Spal do të na krijonte probleme dhe deri sa shënuam golin e dytë loja ishte e hapur. Por me kalimin e minutave krijuam besim dhe e merituum fitoren. Gjithsesi, rezultati 4-0 nuk ishte i lehtë për t'u arritur", u shpreh trajneri Xhennaro Gattuso. Trajneri kuqezil deklaroi se skuadra duhet të shohë përpara, për të mos ulur ritmin. "Që tani të mendojmë për sfidën e radhës, pasi ky rezultat nuk i ka zgjidhur problemet tona, por natyrisht që na motivon. Unë u kërkoi vazhdimisht djemve që të mos ndalin se besuari në aftësitë e tyre, pasi janë të aftë, të rinj dhe mund të përmirësohen më shumë", deklaroi trajneri Gennaro Gattuso, që tani sheh se ka mundësi të shkojë më lart në renditje. "Gjithçka është e mundur edhe pse jo gjithçka varet nga ne. Nuk duhet të falim pikë dhe përfitojmë nga gabimet që mund të bëjnë rivalët tanë, por nëse luajmë mirë, mund t'ia dalim", tha Gattuso.



## Mejveder me tavolinë të pingpongut prej 30 mijë dollarë

Floyd Mejveder e vuri emrin e tij dhe "thesarin" në saj të një koordinimi perfekt të gushteve dhe reflekesive kur ishte në ring. Pesë herë ish-kampioni i botës, i cili i fitoi të 50 ndeshjet në karrierën e tij si profesionist do të mbahet mend si një nga bok-

sierët më të mirë të brezit të tij. Që pasi u tërhoq nga aktiviteti, pas fitores kundër Konor MekGregor, vitin e kaluar, 40-vjeçari ka menduar të investojë te vetja duke u marrë me sporte të tjerë, i fundit në radhë ka qenë pingpongu. Të shtunën, Mejveder

postoi një video në "Instagram" duke shijuar një ndeshje pingpongu me kushëririn e tij Roy. Ku është e veçanta? Te fakti që kjo ishte një tavolinë e pa parë ndonjëherë prej kristali me vlerë 30 mijë dollarë. Video tregon se amerikani nuk është edhe aq i

aftë me raketën në dorë sa ishte në ring. Gjithsesi, kohët e fundit qarkullojnë thashethemet se ai do të kthehet në ring, këtë herë në MMA për t'u ndeshur sërish e MekGregor. Atij i janë ofruar 500 milionë dollarë për këtë përballje.

# JAM TRAJNERI MË I SJELLSHËM NË PREMIER LIGË



"Unë jam i bindur se këtë sezon do të fitoj trofeun e trajnerit më të sjellshëm në fushën e lojës. Jam serioz kur e them këtë gjë", pohon Murinjo

katërt. Unë jam i sigurt se do ta fitoja këtë çmim, pasi nuk kam krijuar asnjë problem ndaj gjyqtarit", tha Murinjo. "E kam përgatitur veten për të qenë i qetë dhe jam i lumtur për këtë gjë. Kam marrë vetëm një karton të kuq ndaj Sautepton, pasi shkela me njëren këmbë në fushë dhe gjyqtari më largoi. Në një ndeshje edhe mund të ndodhë që të humbas kontrollin, pasi nuk jam i përkryer. Nuk do të shkoj nga "i keqi" tek "i përkryer", por po përpiqem dhe jam i lumtur që kam bërë progres në këtë drejtim. Po kuptoj gjithnjë e më shumë që kjo është një kulturë e futbollit në Angli dhe kjo më pëlqen", përfundoi Murinjo.

Skuadra e Mançester Junajted dhe u takua me Njukasëllin, ndërsa pak orë para sfidës, deklarata e trajnerit portugez Hoze Murinjo ka befasuar të gjithë, duke e konsideruar veten si trajnerin më të sjellshëm në Premier Ligë. Edhe pse ai debaton shpesh me kolegët


e tij, duke kujtuar polemikat e fundit me Antonio Konten, ai shprehet se është i sjellshëm, por pranon se nuk është ende i "përkryer". "Unë jam i bindur se këtë sezon do të fitoj trofeun e trajnerit më të sjellshëm në fushën e lojës. Jam serioz kur e them

këtë gjë", u shpreh Murinjo. "Jepen kaq shumë çmime gjatë një jave dhe një muaji në Premier për lojtarë e trajnerë, ndaj mendoj se ata duhet të japin edhe një çmim në fund të sezonit për trajnerin më korrekt në fushën e lojës. Dhe për këtë duhet të votojnë gjyqtarët e

## Vardi me rekord të r në Premier Ligë

Sulmuesi i Leicester, Xhemi Vardi, me golin realizuar ndaj skuadrës së Mançester Siti, vendosi një rekord të ri në historinë e Premier Ligë. Ai u bë futbollisti i parë që arrin të realizojë brenda një kompeticioni gol ndaj 6 skuadrave më të mira në renditjen e Premier Ligës. Në minutën e 24-t, ai barazoi përkohësisht shifrat në 1-1 në këtë përballje, që më pas u fitua 5-1 nga "qytetarët". Për sulmuesin e Leicester, ky ishte goli i 13-të sezonal në Premier Ligë, por i dha mundësi atij të shkruajë emrin si golashënues ndaj skuadrave më të mira të kampionatit. Fillimisht Vardi ka realizuar gol

ndaj Arsenalit, në ndeshjen e parë sezonale, më pas ka realizuar në të dyja sfidat përballë Liverpulit, në një nga ndeshjet kundër Tottenhamit, në një nga dy përballjet që ka zhvilluar ndaj çellsit dhe në një nga dy takimet e zhvilluara ndaj Mançester Junajted. Mrekullia u kompletua të shtunën, kur i realizoi edhe ndaj Sitit, pra ka çuar topin në rrjetë ndaj 6 skuadrave më të mira këtë sezon në Premier Ligë, duke u bërë lojtari i parë në histori që e bën këtë gjë brenda një sezon. 8 nga 13 golat e tij në kampionat i ka realizuar ndaj skuadrave më të mira.



## Turp të marrësh Ikardin kur Higuain është 10 herë më mirë

Diego Maradona është kthyer të kritikojë kombëtaren e Argjentinës dhe ka thënë se skuadra nuk respektohet më, me përjashtim të Messit. Ecuria e Jorge Sampaolit në drejtim të skuadrës ka qenë me ulje-ngritje dhe ka qenë vetëm falë madhështisë së Messit që bardhekaltrit kanë siguruar kualifikimin në Kupën e Botës. "Me përjashtim të Messit, bota ka humbur respektin për Argjentinën dhe askush nuk na ka më frikë", ka thënë ai në një intervistë të dhënë për "Diario Popular". "Ajo që më bezdis më shumë se Argjentinën nuk e respekton njeri. Në ndeshjen e fundit kundër Nigerisë mund të kishim pësuar tetë gola", shtoi më tej Maradona. Më pas ai ka vazhduar duke sulmuar trajnerin Sampaoli dhe zgjedhjet e tij. "Është një turp të marrësh Ikardin në Kupën e Botës kur Higuain është dhjetë herë më i mirë. Është e qartë se Sampaoli nuk di asgjë. Po kërkojmë një numër 9 kur kemi Karlos Tevez", përfundoi Maradona.



## LOJËRAT OLIMPIKE NË PJONGÇANG

### Dy Koretë me ekip të përbashkët në hokej

Në Lojërat Olimpikë "Pyeongchang 2018", event që nisi të premten në Korenë e Jugut, për herë të parë kemi një ekip të përbashkët, atë të hokejit për femra ku në përbërje janë sportiste si nga vendi organizator ashtu dhe ai i Koresë së Veriut. Kjo zgjedhje është

bërë për të simbolizuar paqen në botë mes dy shtetesh të ndara jo vetëm gjeografikisht, por për dekada në luftë të ftohtë mes tyre. Por, këtë herë dy shtetet u bashkuan në një ekip, atë të hokejit për femra, që në ndeshjen e parë në këtë Olimpiadë u mundën 8-0 nga Zvi-

ra. Pavarësisht humbjes, për fansat koreanë kjo ndeshje ishte e rëndësishme, madje një fitore, pasi simbolizoi bashkimin e dy vendeve. Në tribunë ishin presidenti korean, motra e liderit të Koresë së Veriut si dhe presidenti i olimpizmit ndërkombëtar Tomas Bah.

# VDESIN DERISA JANË NË LISTËN E PRITJES

“Njerëzit që kanë vdekur e që kanë qenë në lista të pritjes, janë tetë pacientë. Bëhet fjalë për listën e cila ka qenë që nga vitit 2016. Vdekjet janë të tipit të ndryshëm dhe nuk kemi hyrë andej se çka e ka shkaktuar vdekjen, dhe nuk do doja të komentoj”, tha kardiologu Tefik Bekteshi



të nevojshëm për punë, marrë parasysh faktin që para një kohe, kjo listë kishte 1.502 pacientë në pritje, thekson ai. “Njerëzit që kanë vdekur e që kanë qenë në lista të pritjes, janë tetë pacientë. Bëhet fjalë për listën e cila ka qenë që nga vitit 2016. Vdekjet janë të tipit të ndryshëm dhe nuk kemi hyrë andej se çka e ka shkaktuar vdekjen, dhe nuk do doja të komentoj”, tha Bekteshi. Ndryshe, në Klinikën Kardiologjike në QKUK, është vetëm një sallë për të gjithë këta pacientë që kërkojnë ndihmë. Një aparat i angiografisë, i cili ka dy vjet që nuk është sjellë nga Austria, ndonëse i blerë për QKUK-në, nuk ka arritur në vendin ku i takon. Bekteshi potencon faktin se me këtë aparat, do të zvogëlohej edhe më tej lista e pritjes së pacientëve.

Ai thotë se me një aparaturë të tillë, pacientët kosovarë më nuk do të prisnin për të kryer stentime, apo për të shkuar jashtë vendit për shërim nga sëmundjet e zemrës. “Është blerë në bazë të kredisë së butë austriake dhe ky aparat po pret vendin ku të vendoset. Komisionet e kanë përcaktuar tashmë vendin, por problemi qëndron se kompania ‘Philips’, ka kërkuar disa gjëra që janë të domosdoshme për të funksionuar si duhet. Andaj, nuk e di pse nuk po realizohet ardhja, ndonëse mendoj se është me interes nacional”, tha Bekteshi. Ndërkaq, ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, Uran Ismaili thotë se ka shumë klinika në të cilat presin pacientët. Por, sipas tij, aktualisht po punohet që shërbimet të jenë më efikase. Ai për-

mend edhe aparatën e angiografit, për të cilin zotohet se brenda dy deri tre muajve do të silltet në Kosovë. “Ne tashmë kemi filluar një shërbim 24 orësh në Kardiologjinë Invazive, në mënyrë që rastet emergjente, si infarkti akut dhe stentimet të kryhen menjëherë. Kjo reflekton që rastet emergjente të kryhen menjëherë gjatë 24 orëve. Kjo shpëton jetë”, thekson Ismaili. “Angiografi nuk ka ardhur që dy vjet, por ne kemi iniciuar fillimin e punimeve dhe besoj që brenda dy muajsh do ta sjellim këtë aparat në Kosovë dhe kjo do të përfundojë edhe lista e pritjes”, tha Ismaili. Kardiokirurgu Fatos Kojçiqi në anën tjetër tha për Radion Evropa e Lirë se lista e pritjes me sëmundje të zemrës është marrëzia më e madhe që

mund të ndodh në Kosovë. Kjo gjendje, sipas tij, sjell si pasojë që nga kjo listë të vdesin pacientët, pa arritur të marrin shërbimet shëndetësore. “Në Kosovë aktualisht janë dy qendra të mirëfillta për kardiokirurgji, ku njëra nga to është QKUK-ja. Është mirë që pacientët nuk kanë nevojë të marrin shërbime jashtë vendit. Por, unë jam i pakënaqur me listat e pritjes, pasi që askush nuk jep llogari nëse pacienti vdes pa marrë shërbim”, tha ai. “Pacientë me sëmundje të zemrës vdesin, është normale. Por, jo nëse vdesin pa arritur të marrin shërbime.

Të jetë në listën e pritjes e të vdes, kjo mendoj është e papranueshme”, thekson Kojçiqi. Ndërkaq pacientët me sëmundje të zemrës kërkojnë të vendosen kritere se për cilat sëmundje duhet të pritët. M.K. 56-vjeçar, nga lista e pritjes, thotë se duhet të ketë një vlerësim, pasi që nuk mund të presin të gjithë pacientët njësoj, pasi që kjo varet nga sëmundja nga e cila vuajnë. “Nuk duhet që pacientët me sëmundje të zemrës më shumë se dy muaj të presin, për shkak të natyrës së sëmundjes. Mendoj se kjo duhet të jetë kriter”, tha M.K. Sidoqoftë, shërbimi 24 orësh për sëmundjet e zemrës ishte funksionalizuar në Klinikën e Kardiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në vitin 2014, por që një shërbim i tillë ishte ndërprerë për shkak të sabotimit të këtij shërbimi 24 orësh nga disa mjekë kardiologë aty. (REL)

## VESELI PËR MEDIAT KROATE

### Serbia duhet ta njohë Kosovën



Veseli ka thënë që Kosova dhe Serbia duhet të nënshkruajnë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme, pasi është një kusht për integrimin evropian të dyja vendeve, që u përcaktua edhe nga Strategjia e Zgjerimit të BE-së

ishite përgjigja diplomatike e Veselit “Realisht me themelimin e kësaj gjykate ne kemi dëshmuar gatishmërinë tonë për të punuar në këtë drejtim”, ka thënë Veseli. Ai është shprehur që Kosova dhe Serbia duhet të nënshkruajnë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme, pasi është një kusht për integrimin evropian të dyja vendeve, që u përcaktua edhe nga Strategjia e Zgjerimit të BE-së. “Nuk është e arsyeshme që politikanët e moderuar në Serbi të mos jenë në gjendje ta njohin realitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Por çfarë duhet të bëjmë, është që të lëvizim larg konflikteve me fqinjët”, ka deklaruar i pari i Kuvendit. Duke folur për dialogun në Bruksel, Veseli është zotuar edhe për formimin e bashkësisë së komunave me shumicë serbe.

“Dhe ne kemi vështirësitë tona por jemi të gatshëm për t’i kapërcyer. E respektojmë Serbinë si shtet sovran, dhe jemi të vendosur që qytetarët tonë të çdo komuniteti të jenë të integruar në çdo kuptim”, thotë tutje kryeparlamentari. Veseli në këtë intervistë për agjencinë e lajmeve në Kroaci “Hina” ka folur edhe për Ushtrinë. Sipas tij formimi i Ushtrisë për një shtet të pavarur është i pashmangshëm.

“Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, dhe transformimi në forcat e armatosura është proces i pashmangshëm”, ka thënë Veseli. Ai pohon se ushtria e Kosovës nuk do të jetë kërcënim për askënd, dhe do të kontribuojë në stabilitetin e gjithë Kosovës, transmeton lajmi.net Veseli thekson se të gjitha veprimet do të merren në koordinim me mbështetjen e Amerikës dhe të NATO-s.

#### VRASJA E IVANOVIQIT

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli thotë që vrasja e politikanit serb, Oliver Ivanoviq ishte “llogari e brendshme serbe”. “Ky ishte një akt kriminal kundër stabilitetit të Kosovës, pavarësisht se kush e ka kryer. Kjo është hera e parë që situata shkakton terror psikologjik të serbëve. Unë nuk paragjykoj se kush është përgjegjës, por kjo nuk është në interes të shqiptarëve dhe serbëve”, shtoi kryetari i PDK-së. Veseli ka premtuar se Kosova do t’i sjellë para drejtësisë kryesit e kësaj vepre.

### Vrasja e Ivanoviqit, arrestohen dy policë serbë

Dy pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të nacionalitetit serb, u është caktuar paraburgimi, lidhur me hetimet për vrasjen e politikanit serb të Kosovës, Oliver Ivanoviq, në pjesën veriore të Mitrovicës. Prokurori në pjesën veriore të Mitrovicës, Shyqri Sylja, ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se ata janë paraburgosur të dyshuar se kanë kryer vepër penale “të manipulimit me prova në rastin Oliver Ivanoviq”. Këta policë, që janë paraburgosur dje, janë të punësuar në stacionin policor të pjesës veriore të Mitrovicës. Sipas fjalëve të prokurorit Sylja, është kryer edhe bastisja e shtëpive të tyre dhe te njëri është gjetur revolva e tipit TT me dy karikatorë me nga 9 plumba, të cilën e ka mbajtur pa leje. Kjo revolva është konfiskuar nga ana e policisë. Lideri politik serb nga pjesa veriore e Kosovës, Oliver Ivanoviq, është vrarë më 16 janar të këtij viti para selisë së Iniciativës qytetare, Liria, Demokracia dhe Drejtësia, kryetar i së cilës ishte.



## A duhet ndryshuar ora? Nismë në PE për ta rishikuar

Parlamenti Evropian mbështet idenë e rishikimit të ndërrimit të orës, me qëllimin të kursehet koha ditore, një masë kjo që mund të ndalojë kalimin e akrepave një orë pas apo para në pranverë e në vjeshtë. Ligjvënësit i kërkuar Komisionit Evropian të nisë një "vlerësim të plotë" të sistemit aktual dhe të dalë me plane të reja, nëse është e nevojshme. Mbështetësit këmbëngulin se ai kursen energji dhe redukton aksidentet e trafikut. Kritikët argumentojnë se mund të shkaktojë probleme afatgjata shëndetësore. Ligjet aktuale të bllokut përcaktojnë një datë në pranverë dhe një në vjeshtë, sipas të cilave në të 28-a vendet anëtare, ashtu si në plot shtete të tjera, akrepat duhet të lëvizin me një orë. Ideja është të sigurohen orë shtesë drite për mbrëmjen në verë dhe më shumë dritë për mëngjesin në dimër. Në të gjithë botën, megjithatë, ndasitë për sa u takon përfitimeve të këtij sistemi janë të mëdha. Muajin e kaluar, Finlanda kërkoj hapur që prej lëvizjes të hiqet dorë në mbarë BE-në, pas një peticioni ku u mblodhën më shumë se 70 mijë firma nga qytetarët që i kërkojnë shtetit të tyre rrëzimin e kësaj praktike. Ndërsa gjatë një debati në Strasburg, europarlamentarja franceze Karima Delli argumentoi se lëvizja e akrepave përpara në verë i bën njerëzit më të lodhur dhe shton rrezikun e aksidenteve. "Studimet që tregojnë se një rritje e aksidenteve rrugore, ose probleme gjumi gjatë ndryshimit të kohës, duhet të merren seriozisht. Kursimet e parashikuara të energjisë nuk janë bindëse", tha Karima Delli, europarlamentare franceze. Në vitin 2014, Rusia kaloi përfundimisht në orën e dimrit pas një eksperimenti të dështuar që i kishte lënë sahatet në orën e verës gjatë të gjithë vitit. Deputetët rusë thanë se koha e përhershme e verës kishte shkaktuar stres dhe probleme shëndetësore, sidomos në veriun e vendit, ku mëngjeset janë të errëta për një periudhë më të zgjatur gjatë muajve të ashpër të dimrit.

# POLONIA E VETME NË SHTËPI

Pas nënshkrimit të ligjit të Holokaustit nga presidenti Duda në Poloni, ka pasur reagime të ashpra nga bota e jashtme. A e ka nënvleftësuar Varshava efektin e këtij ligji?

Stella Testa i mbijetoi Holokaustit dhe sot jeton në Jerusalem. Kujtimet e Luftës së Dytë Botërore janë sot omniprezente për 90 vjeçaren. Ajo e ka ndjekur me vëmendje debatin për ligjin e ri të diskutueshëm: "Unë nuk besoj se Polonia do përpiqet t'i shpëtojë përgjegjësisë", thotë Testa duke treguar mirëkuptim për pozicionin që mban Polonia. Por nga ana tjetër: "Nuk ka kërkund që të mos ketë faj, të gjithë kanë faj. A nuk ka pasur edhe Roosevelti faj? Pse nuk e bombarduan ata Aushvicin?" Testa, e cila ka lindur në Maqedoni, ka qenë e re kur i duhej të fshihej nga nazistët duke shkuar vitet e para me disa partizanë në Evropën Lindore. Edhe në Poloni kishin frikë, kujton ajo: "Kur pyeteshin prej gjermanëve, njerëzit i tregonin bashkëqytetarët. Kur erdhën gjermanët, fqinjët donin madje të më vrisnin". Por nuk duhen bërë përgjithësime, "faji është individual".

### GRINDJE POLAKO-IZRAELITE

Kryeministrat e Polonisë dhe Izraelit, Netanjahu dhe Morawiecki, kanë rënë dakord për krijimin e një grupi bilateral pune për rishikimin e historisë. Por Polonia nuk donte të priste. Presidenti Andrzej Duda, nënshkroi ligjin e diskutueshëm të Holokaustit. Ligji parashikon dënime që shkojnë nga gjopa deri në tre vjet burgim për dikë që mes të tjerash quan fajtor ose bashkëfajtor dikë "në publik dhe në kundërshtim me faktet" e popullit ose shtetit polak, për krimet naziste të kryera nga "Rajhu i tretë". Duda ia prezantoi këtë ligj Gjykatës Kushtetuese polake. Ajo duhet të shohë nëse ligji ve në rrezik shprehjen e mendimit të lirë në publik në Poloni. Ndërkohë konflikti polako-izraelit është shtruar të paktën në nivel qe-

veritar. Ministri i Jashtëm izraelit shpreson që të dy palët të bien dakord për ndryshimin e ligjit. "Izraeli dhe Polonia kanë një përgjegjësi të përbashkët, që është të studiojnë dhe të ruajnë historinë e Holokaustit" – thotë deklarata zyrtare. Në parlament, Knesset, është duke u përgatitur një reagim për ligjin polak. Pavarësisht nga partia, të gjithë duan të arrijnë përmirësimin e dy ligjeve të veta: Bëhet fjalë për dënimin e mohimit të bashkëpunimit me krimin nazist dhe ndihmën juridike për punonjësit e vendeve përkujtimore. 80 nga 120 deputetët e parlamentit duan të përkrahin projektligjin.

Edhe studiuesit izraelitë kanë thënë fjalën e tyre: Megjithëse Arti dhe Shkenca është e përjashtuar nga ligji i diskutueshëm në Poloni. Por: "Ai duhet të prezantojë rolin e Polonisë në Holokaust si një të vetëm të vërtetë. Kjo është shumë problematike", ankohet David Silberklang, historian në Institutin Ndërkombëtar për studimin e Holokaustit në Jerusalem. Pjesa më e madhe e institucioneve dhe studiuesve përkrahin idenë që të mos përdoret shprehja "kampe polake përqendrimi", por në këtë mënyrë ligji pengon debatit publik. "Natyrisht që populli polak nuk ka marrë pjesë masive në Holokaust, megjithatë ka pasur njerëz që kanë bërë gjëra të tmerrshme - dhe për këtë duhet folur", thotë historiani.

### ZHËNJIMET NË SHBA

Reagime të ashpra që erdhën nga SHBA krijuan shqetësime në Poloni. Pas nënshkrimit të ligjit për Holokaustin ministri amerikan i Ja-

shtëm, Rex Tillerson, tha se Shtetet e Bashkuara janë të "zhgënjyera". Tillerson kritikoi ligjin se ka "efekt negativ mbi shprehjen e mendimit të lirë dhe studimeve akademike". Kritikë kaq e qartë e shprehur nga partneri më i rëndësishëm i Polonisë nuk ishte dëgjuar në Varshavë kurrë, as në reformimin e diskutueshëm të Kushtetutës. Edhe deputetët e Kongresit të të dy partive e kritikuan ashpër Poloninë. Orrin Hatch, senatori më i vjetër i republikanëve dhe anëtar i "Këshillit përkujtimor amerikan të Holokaustit" theksoi se "ligji është shumë i dëmshëm për të gjithë ata që duan të mësojnë nga leksionet e errëta të së kaluarës dhe të punojnë për një të ardhme më të mirë". Debbie Wasserman-Schulz, kongresiste nga Florida dhe kryetare e Partisë Demokratike kritikoi vendimin e presidentit polak Duda dhe u tregua "thelësisht e zhgënjyer dhe e prekur".

### KRITIKË NGA BASHKIMI EVROPIAN

Po Brukseli? Presidenti polak i Këshillit të BE, Donald Tusk e vlerëson vendimin e Varshavës si kontraproduktiv. Tusk akuzon qeverinë polake se ka arritur me ligjin të kundërtën e asaj që donte të arrinte: "Autorët e ligjit e shpërndanë në gjithë botën emërtimin e gabuar "kamp polak i vdekjes" me efektivitet aq të lartë sa kurrë më parë", transmetoi Tusk me twitter. Zëvendës-presidenti i Komisionit të BE-së, Frans Timmermans i bëri thirrje të gjitha shteteve të pushtuara dikur nga nazistët që të prezantojnë fakte historike: "Ka pasur shumë he-



**Presidenti Andrzej Duda, nënshkroi ligjin e diskutueshëm të Holokaustit. Ligji parashikon dënime që shkojnë nga gjopa deri në tre vjet burgim për dikë që mes të tjerash quan fajtor ose bashkëfajtor dikë "në publik dhe në kundërshtim me faktet" e popullit ose shtetit polak, për krimet naziste të kryera nga "Rajhu i tretë"**

ronj që kanë bërë rezistencë dhe kanë luftuar kundër pushtuesit. Por për fat të keq në të gjitha vendet ka pasur edhe njerëz që kanë bashkëpunuar me pushtuesit nazist për të zbatuar planet e tyre të tmerrshme".

### GJERMANIA NËNVIZON FAJIN E SAJ HISTORIK

Një rol të rëndësishëm në debatin e nxehtë merr Gjermania. Që para nënshkrimit të ligjit të diskutueshëm ministri i Jashtëm gjerman Sigmar Gabriel, nënvizon fajin historik gjerman: "Nuk ekziston as më i vogli dyshim kush është përgjegjës për kampet e zhdukjes, kush i vuri në përdorim dhe kush vrau atje miliona hebrenj evropianë: pikërisht Gjermania". Gjenerali i organizuar ka filluar nga Gjermania dhe prej asnjë vendi tjetër, "bashkëpunëtorë të veçuar nuk kanë sjellë ndonjë ndryshim shumë të madh".

Kampet e përqendrimit nuk janë ngritur rastësisht në Poloni, shtoi Gabriel: "Sepse kultura polake duhej zhdukur po ashtu si çdo gjë hebreje. Tre nga gjashtë milionë hebrenjtë e vrarë vinin nga Polonia". Ndërgjegjja e këtij faji historik është titulli i identitetit të sotëm gjerman dhe "konsensusi qendror i të gjitha forcave demokratike në Gjermani". (DW)





# GJERMANI, TANI MUND TË PUNOHET 28 ORË NË JAVË PËR DY VJET

Marrëveshja ndërmjet sindikatave dhe kompanive në rajonin e Baden-Wuerttemberg: rritja e listës së pagave prej 4.3% dhe e drejta për të shkurtuar javën e punës për një periudhë maksimale prej dy vjetësh



Një javë prej 28 orësh pune për ata që duhet të ndihmojnë të afërmit dhe fëmijët dhe një rritje në listën e pagave prej 4.3%. Sindikata e metalurgjisë gjermane Ig Metall arrin një fitore të bukur që përfundoi në Shtutgard. Akronimi, i cili grumbullon punëtorë në sektorët metalurgjik dhe elektrikë - 3.9 milionë në nivel federal - është kjo marrëveshja e fundit për Tokën e Baden-Wuerttemberg, duke sjellë në shtëpi jo vetëm një rritje të pagës prej 4.3% nga prilli, por edhe e drejta për të shkurtuar javën e punës për një periudhë maksimale prej dy vjetësh. Rregullat e reja do të zbatohen për 900 mijë punonjës në këtë sektor. Të gjithë

ata që kanë nevojë për të ndihmuar të afërmit ose fëmijët e moshuar ose të sëmurë do të kenë të drejtën të kërkojnë javën e 28 orëve, për një periudhë që varion nga një minimum prej 6 muaj deri në një maksimum prej 24. Pas kësaj, punonjësi automatikisht do të kthehet në 35 orë nga kontrata origjinale. Sindikata nuk ka arritur të marrë miratimin e një rregullimi të rrogës, që thuhet në shkallën e parë: kushdo që zgjedh këtë opsion do të shohë një prerje proporcionale në pagë. Por kjo mund të kompensohet me 8 ditë pushim pune. Nga ana tjetër, ekziston mundësia që kompanitë të rrisin kontratat 40-orëshe të dakorduara deri më tani

me punonjësit e tyre. Kush do të bashkohet? Marrëveshja erdhi direkt pas mobilizimit të javëve të fundit, të cilat e kishin çuar sindikatën drejt këtyre 24 orëve abstenim nga puna. Homologu i punëdhënësit kishte frikë se kjo gjë do të përfundonte me fund të hidhur dhe do të jepnin rrugë. Suddeutsche Zeitung, gazeta e qendrës së majtë, flet për një "bast". "Pjesa më e fortë e marrëveshjes është ajo që lidhet me rritjen e pagave, - lexojmë, - pasiguria përfaqësohet nga koncesioni në afatin kohor. Sa punëtorë do të përfitojnë pyetet shtypi - të cilët me të vërtetë do ta kërkojnë atë në ditën e shkurtimit të pagës?"

## Fjalim tetë orësh i senatores Pelosi!

Politikania amerikane, Nancy Pelosi, mendohet të ketë shënuar rekord me fjalimin më të gjatë të bërë në Dhomën e Përfaqësuesve të SHBA-së. Pelosi, udhëheqëse e pakicës demokrate, ka treguar histori të imigrantëve për tetë orë. Ajo ka bërë fushatë në mbështetje të imigrantëve pa dokumente, që kanë hyrë në SHBA si fëmijë. Administrata e presidentit Donald Trump planifikon të shfuqizojë të ashtuquajturën skemë

Daca, e cila daton nga koha e ish-presidentit Barack Obama dhe mbron nga dëbimi imigrantët e rinj pa dokumente. Me shfuqizimin e Daca-s, mbi 800.000 veta do të përballëshin me dëbim. Republikanët dhe demokratët pritet të diskutojnë këtë javë për fatin e tyre, në kuadër të marrëveshjes për buxhet. Në mediat sociale, shumë përdorues kanë vënë në dukje se Pelosi, jo vetëm që ka folur për tetë orë, porse, gjatë kësaj



kohe, ajo ka konsumuar vetëm ujë dhe ka pasur veshur këpucë me taka ta larta.



## Rusia kundërshton armëpushimin njëmuor në Siri

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka kundërshtuar kërkesën e disa ndihmës-zyrtarëve të OKB-së për një armëpushim humanitar njëmuor në Siri. Më 8 shkurt, Rusia ka kundërshtuar thirrjen për armëpushim të kërkuar nga Kuvajti dhe Suedia dhe të mbështetur nga SHBA-ja dhe Franca, duke e cilësuar joreale. "Ne do të dëshironim të shihnim armëpushim, përfundimin e luftës, mirëpo nuk jam i sigurt nëse terroristët janë pjesë e marrëveshjes", ka thënë para gazetarëve, i dërguari rus në OKB, Vassily Nebeniza. Rusia së bashku me Iranin kanë ofruar mbështetje ushtarake dhe diplomatike për presidentin sirian, Bashar al-Assad në luftën civile afro shtatë-vjeçare dhe ka kundërshtuar çdo hap që potencialisht mund të dobësojë pozicionin e tij. Shtetet e Bashkuara dhe Turqia përkrahin grupe të ndryshme rebele që luftojnë qeverinë e Assadit. Kjo qeveri u referohet rebelëve të mbështetur nga SHBA-ja si "terroristë" ashtu sikur ekstremistët e grupit militant, Shtetit Islamik (IS). Të gjitha grupet janë duke luftuar kundër ekstremistëve të IS-it, të cilët janë duke tentuar të mbajnë në kontroll enklavat e mbetura, pasi kanë humbur shumicën e territorit të pushtuar më 2014. Në një takim me dyer të mbyllura, shefi i ndihmës në OKB, Mark Loëcock ka kërkuar armëpushim në mënyrë që të arrihet tek civilët që janë të rrethuar. Mirëpo diplomatët kanë thënë se kjo kërkesë është refuzuar. Një marrëveshje e tillë kërkon miratimin e 15 anëtarëve dhe nuk duhet të përdoret vetoja nga asnjë anëtar i përhershëm siç janë, SHBA, Rusia, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Kina.

## NDRYSHIMET NË ARABINË SAUDITE

### "Gratë s'kanë pse mbulohen"

Gratë saudite nuk kanë pse të veshin abajën, një veshje e gjatë dhe e lirshme, e ngjashme me një pelerinë, që përdoret për të mbuluar trupat e tyre në publik. Mbretëria islamike është përfshirë nga një erë ndryshimi. Komentet e fundit mjaft domethënëse vijnë nga një prej imamëve më të rëndësishëm në vend, pikërisht Sheikh Abdullah al-Mutlaq. Abaja është e detyrueshme me ligj në Arabinë Saudite dhe fakti që një prej zërave më të

rëndësishme në çështjet fetare thotë se s'është më e nevojshme, paralajmëron ndryshime të reja në bazën ligjore. Sipas imamt al-Mutlaq, i cili është pjesë e Këshillit të fuqishëm të Studiuësve të Lartë, 90 për qind e femrave të devotshme myslimane në botë nuk mbajnë abaja, prandaj Arabia Saudite nuk duhet të detyrojë askënd që ta përdorë këtë veshje. Komentet e tij shkaktuan mjaft reagime online, me njerëz që u shprehën pro dhe kundër idesë së

re. Ndërhyrja e sheikut pason disa lëvizje për të modernizuar shoqërinë saudite të nxitur nga princi i kurorës Mohammed bin Salman. Një nga qëllimet kryesore të reformës është garantimi i më shumë lirie për femrat, të cilat në Arabinë Saudite përballen me rregulla të rrepta të izolimit gjinor. Një prej ndryshimeve historike ishte ai i shtatorit 2017, kur autoritetet lejuan femrat që të marrin patentën dhe të ngasin makinat.





## Del në ankand një "Mona Liza" e Afrikës

Një "Mona Liza afrikane" ikona e vërtetë kombëtare në Nigeri, e konsideruar si e zhdukur, do të shitet në ankand pasi u rigjet në një apartament në Londër. Ky portret i princeshës Ife Adetutu Ademiluyi, ashtuquajtur "Tutu", pikturuar në vitin 1974 nga artisti nigerian, Ben Enwonwu do të shitet në ankand më 28 shkurt nga shtëpia e ankandëve "Bonhams", një shitje që do të transmetohet drejtpërdrejt në Lagos për t'u mundësuar blerësve potencialë të interesohen. "E konsideroj si Mona Lizan afrikane", theksoi romancierin nigerian, Ben Okri, laureat i Booker Prize për këtë portret që nuk ishte parë më që prej ekspozimit për herë të fundit në vitin 1975. "Që prej 40 vitesh, kjo është një pikturë legjendare, të gjithë flasin për të, pyesin ku është Tutu?", theksoi shkrimtari. "Artisti nuk ka shfaqur thjesht vajzën e re, ai ka shfaqur të gjithë traditën. Kjo është një simbol i shpresës dhe rigjenerimit në Nigeri, simboli i Feniksit të rilindur nga hiri", shtoi Ben Okri, i cili theksoi se kishte kaluar disa orë duke e parë atë dhe duke kompensuar kohën e humbur. Ben Enwonwu ka pikturuar tre versione të Tutusë, por tre tablo ishin zhdukur deri sa një prej tyre ishte rigjetur nga Giles Peppiatt, drejtor i artit modern afrikan tek "Bonhams".

## Arrin në finale si Miss, pastaj tregon se është mashkull!





Në fund, ajo vajza e bukur, pretendentja kryesore për të marrë titullin Miss virtual Kazakistan i ka habitur të gjithë: "Në të vërtetë unë jam një mashkull". Siç transmeton Shqip, 22-vjeçari kazak Ilay Dyagilev u prezantua si femër nën identitetin e rremë, Arina Alieva dhe përfundoi duke qenë një nga më të votuarat mes 4000 kandidaturave femra në konkurs, duke u renditur në finale. Por kur pa që po shkonte tepër larg, Ilay vendosi të zbulonte vërtetën, se në fakt ai ishte një mashkull, i trukuar falë ndihmës së një mikeje dhe se ishte bërë pjesë e konkursit për të treguar se vajzat e ndjekin aq shumë modën sa përfundojnë duke qenë kopje të njëra-tjetrës, sa është shumë e thjeshtë të përshtatesh me standardin e njëjtë të bukurisë femërore. "Mungon origjinaliteti dhe natyralja", ka rrëfyer djali, që u skualifikua menjëherë nga konkursi femëror i bukurisë.

# KLIMT, PIKTORI QË PËRDORI TË DASHURAT SI MODELE

Kanë qenë për kohën imazhe shumë kontroversiale, por kishin një joshje dhe një sensibilitet të ri dhe të ndryshëm nga pikturat e mëparshme dhe ishin një celebrim i seksualitetit, i atij sensualiteti që sapo kishte nisur që të shfaqej në atë periudhë në Austri. Dhe ishte pikërisht kjo përshfaqje sensualiteti që u shndërrua edhe në "fushëbetjën" e një tjetër njeriu të famshëm austriak, Sigmund Freud


Shumë femra ia trazuan jetën Gustav Klimt, por vetëm njëra prej tyre arriti ta robëronte. Ajo ishte Emilie Floege. Pasioni për të bukurën do ta kthente miqësinë mes tyre në një dashuri nga e cila artistit i dukej sikur nuk do të shpëtonte kurrë. Emilie Floege ishte e përfshirë në lëvizje në rolin e stilistes dhe më pas u bë një nga stilistet dhe rrobaqepëset më të mëdha dhe më të famshme të Vjenës së asaj periudhe. Puna e saj thuhet se ka ndikuar edhe në tekstilet me të cilat janë krijuar shumë punë të Klimt, ndër të cilat edhe e famshmja e tij, "The Kiss". Kjo grua ishte vetëm një nga të dashurat më jetëgjata të artistit. Edhe pse ai njihej si një njeri me reputacion prej të ndrojturi, ai dashuroi shumë gra në jetën e tij dhe pas vitit 1990 i përdorte në mënyrë të vazhdueshme si modele të tija. Dhe bëhet fjalë për piktura kryesisht nudo dhe erotike në të cilat ai nënvizonte me të madhe sensualitetin e tyre dhe seksin.

Dhe ndërkohë, karakteristikë e përbashkët është se ato e shihnin "publikun" me një vështrim shumë provokues. Kanë qenë për kohën imazhe shumë kontroversiale, por kishin një joshje dhe një sensibilitet të ri dhe të ndryshëm nga pikturat e mëparshme dhe ishin një celebrim i seksualitetit, i atij sensualiteti që sapo kishte nisur që të shfaqej në atë periudhë në Austri. Dhe ishte pikërisht kjo përshfaqje sensualiteti që u shndërrua edhe në "fushëbetjën" e një tjetër njeriu të famshëm austriak, Sigmund Freud. Në vitin 1905 ai publikoi tre ese në lidhje me teorinë e seksualitetit, një libër që përbënte një sfidë të madhe dhe të thellë në këtë fushë. Sikurse edhe Freud, edhe Klimt donte që të vendoste seksualitetin në sferën publike. Por në vitin 1903 ai u detyrua që të hiqte një nga pikturat e tij "Shpresa" nga retrospektiva e lëvizjes "Cecision" ishte një pikturë në qendër të



së cilës ishte një grua e zhveshur shatzënë, e cila kishte një vështrim gati të paturpshëm dhe që në fakt përbënte diçka shumë më përtej zakonit të vendit. Gjithsesi, askush si Klimt nuk arriti që të depërtonte dhe të shfaqte ndjenja, dëshira, dëshpërime e epshe në veprat e tij. Pikturat e Klimt janë ndër më të shtrenjtat në botë. Nëpër ankande, vlera e tyre shkon me miliona. E ndërkohë, shpesh në qendër të tyre janë objekte krejtësisht të thjeshta duke filluar që nga vazo, mbajtëset e pecetave apo gjëra të tjera të tilla. Një nga punët e tij "Portreti i Adele Bloch-Bauer" ka në qendër të saj një grua shumë të bukur e sjellë në tela jo përmes stilit tipik të Klimt. Dhe ky është një stil i pangatërrueshëm, unik, që çuditërisht ka fituar një popullaritet të gjerë aq sa për të qenë "trendy" në çdo kohë dhe në çdo vend.


Sipas disa specialistëve të artit, popullariteti i tij është falë të qenët një



piktur shumë pararojë, një piktur që guxoi në një epokë shumë konservatore të eksperimentonte me ngjyrat dhe me format dhe nga ana tjetër përmes kësaj mjeshtërie eksperimentale të vendoste në qendër të veprave të tij subjekte që janë shumë të zakonshme, të jetës së përditshme, po të dhëna në një formë të re dhe të pranueshme nga syri dhe ndjesia artistike e njeriut. "Klimt ka një joshje të jashtëzakonshme dhe njerëzit reagojnë ndaj saj në mënyrë instiktive dhe menjëherë. Ai e çon pikturën e tij në prag të abstragimit, por e bën këtë duke ruajtur edhe balancat mes reales dhe joreales. Mes abstraktes që ka në mendje dhe konkretes që ka ai dhe të gjithë të tjerët para syve në jetën e përditshme".

Por në punët e tij ka edhe një ndjesi lirie, pakufijshmërie që karakterizon çdo krijim. Klimt ishte anëtar i lëvizjes që quhej "Gesamtkunstwerk", një grup artistësh vjenezë që kërkonte që të sfidonte rixhiditetin e pikturave austriake në përgjithësi, në atë kohë. Qëllimi i tyre kryesor ishte që të bënin bashkë shumë lloje të ndryshme, zhanre të ndryshme arti në një lëvizje të madhe të përbashkët atë që u quajt "Gesamtkunstwerk". Ishte një lëvizje që më pas pati një ndikim jo të vogël edhe në artin e Britanisë së Madhe të asaj periudhe me veprat karakteristike të Charles Rennie Macintosh, stili dekorativ i të cilit arriti që të kishte një audiencë maksimale.

# MIKROBËT E GJUHËS SHQYPE



Nga Gjerj FISHTA

Asht lypë forca e konservatorizmi i një kombi shqypar, për me e rrujtë gjuhën e vet të gjallë e të kerthneztë ndermjet zhumhurit të gjuhëve të slavëve, të grekëve e nen imperjalizem të kulturës latine, pse dihet që ka kombe n'Europë, të cillat sod nuk flasin ma gjuhen origjinale të veten, por gjuhë të hueja. Por tue vu në oroe korespondencën e perditshme, që na vjen prej Shqypniet, shkrimet që çohen me u botue në shtypshkrojtë tonë, mundena me thanë, se çka nuk m'rijtjen me ba në gjuhë shqype grekët, romakët, gotët, slavët etj. janë tue e ba sod shqyparët vetë: janë tue e hupë gjuhën shqype!

Nen shkak që gjuha shqype s'ka literaturë të veten, kanë nisë të shkruajnë shqyp secilli mbas atij qirificit të mendes së vet, pa e vù në oroe aspak a natyrën e gjuhës, a shijen estetike e arsyetimin e ligjeratës njerëzore. Kanë këndue ndonji fletore të hershme, ase, neper të, edhe ndonji liber shqyp, botue prej ndoj geget a tosket si neper kllapë a me pasë kenë tue qitë laknuer me nëne e qe se ato 10-15 kokrra fjalë ekzotike, që u kanë mbetë nder trù të shtypuna a librat shqyp, kanë per t'u mundue me e folë, kanë per t'i mbjellë aty-ktu neper shkime të veta si me lëshue guraleca në brùm të bukës kallamoqe, në short me të thye dhambët e tmallët e shëndosha.

Tjerët kahë nuk i ka lanë shpija mbrendë, kanë kerkue dhenë si parja e kuqe, e kur kanë shtegtue neper Shqypnë, të ngushtuem me u marrë vesht a gega me toskë, a toska me gegë, kanë shkue tue shartue njanin djalekt me tjetrin, pa kurrfarë mjeshtrijet porsì me shartue shegat me fiq e të kanë perba një gjuhë krejt në vedi, që s'di a

Pernjimend se asht një punë per t'u çuditë, që një grusht njerëz në gji t'Europës, që jemi na shqyparët, tue kenë ndoshta kombi ma i vjetri i të gjithë Europës e rrethue per gjith anesh prej kombeve të tjera ka mujtë me rrujtë deri sod gjuhën e vet m'vedi e krejt të dame prej gjuhëve tjera europjane. E pra, kush nuk u pershkuve neper ne! Mjaft me thanë romakët e turqit, dy pushtete të perfrigueshme: e me gjith kta, shqypja gjallë se gjallë, e, shka asht ma teper, perditë tue u zhdrivillue ma fort

asht kàl, a mushk, a gomar e që ma fort se gjuhë shqype, kishte me u dashë me e quejtë sallahane.

E, ka asish masandej, e janë sidomos do nëpunësa në Shqypnë e nuanësat tonë jashta Shqypniet, të cillët, ma fort se me studue natyrën e gjuhës a librat shqyp kanë per t'u mundue me folë e me e shkruve shqypen mbas mëndyrës që ta flasë drejtori i zyres, per në kjoftë nëpunës e, per në kjoftë nuanës ka per t'i marrë të gjitha veset e shqypimit e gabimet gramatikore të atij që ta ketë porosinë me e marrë në shkollë perjashta: e atëherë na mblon aj breshen fjalësh shumë të bukura e që me shmangien e formave dialektare, per me trajtue kështu gjuhën letrare shqype, si bje fjala njikto rreshta që po i nxjerrim prej një lajmit botue tash së vonit:

Gjithë pjestarvet i ngufoi zemra në gëzim tue ndigjue kto fjalë me randësi tue u qeshun fëtyra, u shperndanë kadalë. Të gjithë dija e gjuhës shqype ka mbetë, per në kjoftë gegë shkruesi me shkruve shumë ë nder fjalë, e per në kjoftë toskë, tue vu sheje

hundakësh, punë e pa punë; e kështu, vjen e bahet letra me pikla, e thue se ke shprazë në të një kubure kaçalluke mbushë me shasme.

E, shka të bindë e të neveritë ma fort asht kta që të gjithë po duen me u mbajtë filologë. Hin e fol me ta, paj, qe besa e besës, ta bajnë kryet per voe kahë vehen kinse me të spjegue, se kjo fjalë vjen prej sanskritishtes, se kjo tjetra asht indo-gjermane, se ajo e treta rrjedh drejtpdrejt prej persishtes: se Majeri i ka thanë kështu, se Pedersen i ka shkruve ashtu e kështu Jockel e kështu Jagić e kështu etj., etj. të tana fjalë si me u pasë ra Injyra e me kenë tue folë këllapë. Per ta të gjithë literatrya s'asht tjetër veçse një etimologji fjalësh e kurrqja ma teper.

Kahë pritojnë me u vu e me zanë më libra shqyp, kta s'e zanë se ka shkruve kush shqyp kurr, e pse gja të veten s'kanë të shkrueme, kështu gjithmonë kanë per të mbajtë per fjalë të shkrimtarëve të huej, si mbahet kungulli haes per gardh. E kështu, kahë rrijnë kta garguj tue britë permbi filologji e literatrye, gjuha shqype ka ardhë e asht perzie si flokët e harapit sa me mbërrijtë njeriu me i thanë vedit, jarebi, a di unë shqip, apo jo? Per në ngjatët puna kso doret, s'ka me shkue shum e na kemi me kenë të ngushtuem me folë e me shkruve në gjuhë të huejen, pse gjuha shqype ka me dekë, pa dyshim, mbassi i kanë h'i sod mikrobët që janë shkrimtarët e padije e të pa zeje.

Thonë se gjuha shqype s'ka literatrye e gjuhë letrare të veten. Asht rrenë! Gjuha shqype ka literatrye, veçse s'ka lertrarë, sa kishite me u dashtë. Padija në literatrye e një shumicës së madhe të shqyparëve të sodshëm, ka ba që perparimi i literatryes së gjuhës shqype sod ka kthye, pak me thanë, 50 vjet mbrapa. Prej zekthit të marrë që me u dukë letrarë pa kenë, sod asht pshtjellue gjuha shqype në mënyrë që mos me mujtë me këndue dy rreshta shqyp, perpa t'u çue vneri. Urojmë që shqyparët e meçëm e sidomos Komisioni Letrar kanë me u mundue me i shtypë me shkrime të veta kta mikrobë parazita të gjuhës shqype.



## Një shqiptare në korin e të rinjve në Brooklyn

Ajo ka një zë të mrekullueshëm. Është Sisil (Sicile) Naddeo-Gjergji 13 vjeçarja shqiptare e cila ka spikatur me angazhimin e saj në korin e mirënjohur amerikan të të rinjve "Brooklyn Youth Chorus" në SHBA. Ky kor ka në përbërjen e tij rreth 600 të rinj nga 7 deri në 18 vjeç dhe rreth 30 deri në 60 më të suksesshmit prej tyre shpesh performojnë në skenat më profesionale të Nju Jorkut, Amerikës e ndërkombëtare. Brooklyn Youth Chorus ka qënë fitues i Grammy Award në 2005, dhe ndër të tjera ka performuar me Orkestrat Filarmonike të Nju Jorkut, Los Anxhelës, si dhe Orkestrën Sinfonike të Londrës. Po ashtu ka bashkëpunuar me dirigjente ndërkombëtare si Lorin Maazel, Alan Gilbert, James Levine e këngëtare si Barbra Streisand e Elton John. Disa nga skenat më të rëndësishme ku kori ka debutuar janë Carnegie Hall, David Geffen Hall, Jazz at Lincoln Center në Nju York, Barbican Theatre në Londër, etj. Më 3 shkurt Sisil këndoi bashkë me korin e shoqëruar nga Orkestra Filarmonike e Nju Jorkut "New York Philharmonic" nën dirigjimin e Joshua Gersen, ndërsa drejtoreshë Artistike ishte Dianne Berkun Menaker, me skenar e regji të Noah Himmelstein nën prezantimin e Terrance McKnight. Vetëm pak kohë më parë ajo interpretoi në "David Geffen Hall" në Lincoln Center në shfaqjen Koncertet e të Rinjve të Filarmonisë së Nju Jorkut "Frymëzime e Tribute", "Një Prejardhje Afro Amerikane"...

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr 167/2015, 27/2016) dhe nenit 5, 7, 8 dhe 9 të Marrëveshjes kolektive të SHA Elektranat e Maqedonisë, në pronësi të shtetit Shkup, ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën për lidhje të marrëdhënies së punës nr. 04-790/1 të datës 09.02.2018

### SHA ELEKTRANAT E MAQEDONISË – SHKUP

publikon  
SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës në Filialin HEC Drni i Zi – Strugë, SHA ELEM – Shkup, për realizimin e punëve për kohë të pacaktuar, për vendet e punës në vijim:

- 1 (një) realizues në vendin e punës "Përgjegjës për depo", në Departamentin për punë komerciale, në Shërbimin për punë financiare dhe komerciale.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, Arsimit mesëm; Shuma në të holla e pagesës bazë është 26.981 denarë.

- 1 (një) realizues në vendin e punës "Punëtor i përgjithshëm", në HE Shpilje – Dibër, në Shërbimin për prodhim të energjisë elektrike.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla I, Arsimit fillor. Shuma në të holla e pagesës bazë është 16.988 denarë.

Java e punës është 5 (pesë) ditë pune, nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditëve të punës do të zgjasë 8 orë në ditë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

Shpallja zgjatë pesë ditë pune nga dita e shpalljes.

Së bashku me fletëparaqitjen (të shkruar me dorë) në të cilën theksohet se për cilin vend pune konkurrohet, kandidatët duhet të parashtrijnë:

- Dëshmi për arsimin e mbaruar (original ose kopje të vërtetuara në noter);
- Certifikatë të shtetësisë (kopje);
- Biografi të shkurtë në gjuhën maqedonase;
- Kontakt telefon

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme, nga të cilat shihet se kandidati i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, të dorëzohen në adresën:

SHA Elektranat e Maqedonisë - Shkup, Drejtoria  
rr. 11 Oktomvri nr. 9, Shkup, (me shenjë "për shpallje publike").

SHAELEM – SHKUP

Në bazë të nenit 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënësit e shkollave të mesme, në pajtim me Programin vjetor për punë të shkollës, Komisioni për realizimin e procedurës për ekskursion përfundimtar për vitin shkollor 2017/2018 pranë SHMK Gjinnazi "Goce Dellçev" Kumanovë, publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

Për grumbullim të ofertave për organizim të ekskursionit përfundimtar për vitin shkollor 2017/2018

#### 1. Organi kontraktues

Emri: Shkolla e mesme komunale Gjinnazi "Goce Dellçev" Kumanovë

Adresa: rr. "Pero Çiço" nr. 31a, 1300 Kumanovë

Kontakt tel. 031 421-079, e-mail [gdku10@yahoo.com](mailto:gdku10@yahoo.com)

Informacione shtesë dhe marrje të Dokumentacionit tenderues me Programin mund të merren në adresën e lartpërmendur

#### 2. Ofertues: Secili subjekt juridik i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën e shpalljes

3. **Lënda:** Organizim i ekskursionit përfundimtar dhe aktiviteteve tjera të lira në pajtim me programin vjetor të shkollës dhe në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregullore për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

4. **Përshkrimi i shërbimit:** Organizim dhe realizim i ekskursionit përfundimtar me nxënësit e vitit të III në vitin shkollor 2017/2018 prej më 26.05.2018 deri më 31.05.2018 në relacionin Kumanovë – Budapest – Pragë – Bratislavë – Vjenë – Veronë – Lido di Jesolo – Venedik – Kumanovë, në periudhë prej gjashtë ditë.

#### 5. Kushtet minimale: Ofertuesit duhet të përmbushin kriteret minimale në vijim:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive të Republikës së Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë turistike;

- k të realizuara në mënyrë të suksesshme së paku tri ekskursione për nxënësit në tri vitet e fundit;

- përmbushë kushtet për transport të grupeve të nxënësve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Oferta e ofertuesit që nuk përmbushë kushtet minimale do të refuzohet nga Komisioni si e papranueshme. Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

Kriteri për ndarje të marrëveshjes për realizim të ekskursionit është çmimi më i ulët.

Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofertuesi më i volitshëm parashtron garanci bankare për realizim të kualitative të marrëveshjes në shumë prej 15% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Dokumentet e nevojshme janë pjesë e dokumentacionit tenderues.

#### 6. Vendi i marrjes së dokumentacionit tenderues dhe parashtrimi të ofertave

Dokumentacioni i tërësishtëm mund të merret në arkivin e SHMK Gjinnazi "Goce Dellçev" Kumanovë, çdo ditë pune prej ora 08 deri në ora 14.00.

Parashtrimi i ofertave mund të bëhet në arkivin në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës nga dita e publikimit të shpalljes prej ora 08 deri në ora 14.00 ose përmes postës në adresën: SHMK Gjinnazi "Goce Dellçev" Kumanovë, rr. "Pero Çiço" nr. 31 A, 1300 Kumanovë, në zarf të mbyllur me shenjë "Komisioni për realizim të procedurës për ekskursion shkollor".

Hapja e ofertave do të realizohet nga ana e Komisionit për realizim të procedurës për ekskursione shkollore pas afatit përfundimtar për praninë të ofertave.

Komisionit për realizim të procedurës  
për ekskursione shkollore pranë  
SHMK Gjinnazi "Goce Dellçev" Kumanovë



# FSHATRAT "ISLAM" PA ASNJË MUSLIMAN

Islam Latinski (Islam Latin) dhe Islam Grčki (Islam Grek) janë dy fshatra të lidhura me qytetin e Zadarit, popullsia e të cilëve përbëhet plotësisht nga të krishterë katolikë dhe ortodoksë

Në Kroaci gjenden dy fshatra fqinjë të cilët me popullsinë plotësisht të krishtere dhe me emrat me fjalën "Islam" janë të vetmet vendbanime të këtij lloji në Evropë. Islam Latinski (Islam Latin) dhe Islam Grčki (Islam Grek) janë dy fshatra të lidhura me qytetin e Zadarit, popullsia e të cilëve përbëhet plotësisht nga të krishterë katolikë dhe ortodoksë. Emri "Islam", i cili është ruajtur nga fshatrat për katër shekuj, është trashëgimi e periudhës osmane, ndërsa vazhdon të ruhet në mes të Evropës edhe sot. Mendohet se fshatrat, distanca mes të cilëve është vetëm tri kilometra, janë të vetmet vendbanime në Evropë që janë të emërtuar me shprehjen "Islam".

Në Islam Latinski, ku gjendet një faltore e vjetër e rrethuar islame dhe në rrugët e të cilit mbizotëron heshtja, jetojnë 280 të krishterë, shumica e të cilëve janë katolikë, ndërsa në Islam Grčki jetojnë 200 persona, shumica e të cilëve janë ortodoksë. Fati i këtij rajoni, i cili gjendet 20 kilometra larg Zadarit, qytet në bregdetin e Detit Adriatik, ndryshoi në vitin 1547 kur hyri nën administrimin osman. Ky vend, i cili u shndërrua në rajon kufitar në përfundim të shtetit osman, u emërtua "Saddislam" (Muri Islam). Rajoni, popullsia e të cilit në atë periudhë ishte me shumicë muslimane, u krishterizua me rimarrjen e rajonit nga Venediku në vitin 1647. Si pasojë e mosmarrëveshjeve të shekullit të 18-të mes katolikëve dhe ortodoksëve, ky rajon ndahet në dy pjesë, "Islam Latinski" dhe "Islam Grčki". Duke ruajtur emrin "Islam" edhe përkundër faktit se në atë rajon nuk ngelën muslimanë, katolikët fshatit të tyre i shtojnë fjalën "Latin", kurse ortodoksët fjalën "Grek".

Konflikti mes katolikëve dhe ortodoksëve paraqitet si arsyeja

**60-vjeçari Marko Vanjak, i cili jeton në fshatin Islam Grčki, duke bërë të ditur se të moshuarit kanë rrëfyer se shtëpitë e fshatit janë "shtëpi turke" dhe se këtu kanë jetuar edhe turq, thotë se në fshat ka ende shtëpi dhe varreza të turqve, të ngelura që nga periudha osmane. Vanjak poashtu tregoi dhe se një shtëpi e braktisur në fshat, dikur është përdorur si faltore islame**



kryesore për ruajtjen e emrit "Islam" të fshatrave, të cilat pas periudhës osmane kanë qenë të administruara nga shtete të ndryshme, ndërkohë që së fundi ishin të



përfshira dhe në luftërat me baza fetare në vitet e 90-ta.

#### NJERËZIT NUK PRANUAN NDËRRIMIN E EMRAVE

Historiani Damir Magas, i cili e informoi gazetarin e Anadolu Agency (AA) rreth të kaluarës së fshatrave, bëri të ditur se me ardhjen e osmanëve, rajoni është shndërruar në një vend më të fuqishëm dhe më të madh, duke shtuar se pak kilometra pas kufirit të Saddislamit, niste kufiri i Venedikut. Magas më tej theksoi se në atë periudhë shumica e popullsisë përbëhej nga muslimanët, por se kishte dhe pak ortodoksë dhe katolikë. Megjithatë, meqë ishte rajon kufitar, popullsia ishte në numër të vogël.

Ai gjithashtu pohoi se pas përfundimit të periudhës osmane në rajon, muslimanët kanë emigruar nga rajoni dhe se këtu janë vendosur katolikë dhe ortodoksë të sjellë nga rajonet e brendshme të vendit. "Dëshën të vendosin ndonjë emër para kohës së osmanëve, megjithatë njerëzit nuk e pranuan këtë. Njerëzit nuk duan të ndryshojnë diçka që është qindrvjeçare", u shpreh Magas, duke vënë në dukje se në të kaluarën, disa persona kanë kërkuar që të ndërrohen emrat e fshatrave Islam Latinski dhe Islam Grčki. Magas gjithashtu theksoi se prezenca e emrit "Islam" në emrat e fshatrave, është dhe një tregues i tolerancës në vend.

**KA SHTËPI TURKE DHE FALTORE**  
60-vjeçari Marko Vanjak, i cili jeton në fshatin Islam Grčki, duke




Islam Grčki  
Islam Latinski

Në fshatin "Islam Grčki" më parë kanë jetuar 1500 persona, kurse gjatë ndarjes së Jugosllavisë dhe luftimeve mes kroatëve dhe serbëve, në fshat kanë ngelur vetëm 200 persona të cilët në përgjithësi janë të moshuar

bërë të ditur se të moshuarit kanë rrëfyer se shtëpitë e fshatit janë "shtëpi turke" dhe se këtu kanë jetuar edhe turq, thotë se në fshat ka ende shtëpi dhe varreza të turqve, të ngelura që nga periudha osmane. Vanjak poashtu tregoi dhe se një shtëpi e braktisur në fshat, dikur është përdorur si faltore islame. "Kjo shtëpi që shihni dhe shtëpia ku kam lindur unë janë afro 500-vjeçare. Dikur kjo është përdorur edhe si faltore. Pranë faltores ka pasur edhe dhomë për mysafirë", tha ai.

#### POPULLI KA EMIGRUAR GJATË LUFTËS SERBO-KROATE

Vanjak e cilësoi si jo të duhur faktin që disa prej personave të cilët nuk e pranojnë mirë faktin se në emrin e fshatrave përdoret fjala "Islam" janë përpjekur të ndryshojnë këto emra. "Unë kam lindur këtu, ky është emri i fshatit tim. Nuk ka asnjë problem që në emrin e fshatit të jetë fjala 'Islam', shtoi Vanjak. Ai gjithashtu theksoi se raportet mes dy fshatrave ndryshojnë varësisht se kush e udhëheq vendin dhe se përgjithësisht raportet janë të mira sado që herë pas here ekzistojnë tensione. Duke pohuar se tani në fshatin e tyre jetojnë edhe ortodoksë, Vanjak shtoi se më parë në fshat kanë jetuar 1500 persona, kurse gjatë ndarjes së Jugosllavisë dhe luftimeve mes kroatëve dhe serbëve, në fshat kanë ngelur vetëm 200 persona të cilët në përgjithësi janë të moshuar. Nga ana tjetër, 68-vjeçari Srecko Salen nga fshati Islam Latinski për AA tha se është lindur e rritur në këtë fshat dhe se familja e tij kanë ardhur këtu nga Dubrovniku pas shkuarjes së osmanëve nga rajoni. Salen theksoi se shumica e njerëzve në fshat janë katolikë dhe shtoi se në luftën e fundit shumë persona kanë shkuar si refugjatë në vende të tjera dhe si pasojë e kthimit të një numri të vogël prej tyre, fshati sot është i heshtur.

# AMIN AL HUSEINI

## Imami i Hitlerit

Myftiu i Jerusalemit, Amin al-Huseini, gjatë Luftës së Dytë Botërore u përpoq t'i shërbente Adolf Hitlerit si urë lidhëse me botën myslimane. Në pranverën e vitit 1943, ai u dërgua në Ballkan për të mobilizuar myslimanët për një aleancë me nazistët. Në Sarajevë Al-Huseini takoi edhe një delegacion imamësh shqiptarë...

Nga Enver ROBELLI

Në vitin 1921 forcat koloniale britanike e emëruan Amin al-Huseinin myftiu të Jerusalemit. Në vitet '20 dhe '30 ai do të bëhej i njohur si nacionalist arab që kërkonte zhdukjen e hebrenjve. Si shumë arabë, edhe Amin al-Huseini ishte i zhgënjyer me britanikët dhe francezët për shkak se fuqitë koloniale i kishin ndarë vendet arabe arbitrarisht, duke ua pamundësuar të bëheshin të pavarura. Pas fillimit të trazirave të dhunshme më 1936, në krye të së cilave ishte vënë, Amin al-Huseini u detyrua të braktiste Palestinën. Qëndroi në Liban dhe në Irak, ku më 1941 një grup oficerësh pronazistë tentuan të bënin një puç. Pastaj po atë vit përmes Italisë u arratis në Gjermani. Mes viteve 1941-1945, në Berlin, Al-Huseini drejtoi "Zyren arabe", një instrument i propagandës naziste për mobilizimin e myslimanëve në anën e Adolf Hitlerit dhe demonizimin e francezëve dhe britanikëve. Në nëntor 1941 Al-Huseini u prit nga Adolf Hitleri në Berchtesgaden, ku diktatori nazist kishte një rezidencë malore.

Në librin e tij "Për profetin dhe Hitlerin. Bota islame dhe Rajhu i Tretë", të botuar së fundi, historiani David Motadel analizon edhe përpjekjen e nazistëve që përmes Al-Huseinit të ndikojnë te myslimanët e Ballkanit për të luftuar përkrah nazistëve. Në një memorandum paria myslimane e Bosnjës i shkroi Hitlerit se myslimanët e Ballkanit janë pjesë integrale e "300 milionë myslimanëve" të mbarë botës dhe se janë të gatshëm të bashkohen në radhët e Forcave të Boshitit, të cilat kishin "filluar luftën kundër judaizmit, masonëve, bolshevizmit, si dhe kundër shfrytëzuesit, anglezit". Mes fundit të mar-



sit dhe fillimit të prillit të vitit 1943, udhëheqja naziste e dërgoi Amin al-Huseinin në një vizitë nëpër viset myslimane të Ballkanit të kontrolluara nga ustashët kroatë. Qëllimi ishte që myftiu t'i jepte legjitimitet fetar aleancës gjermano-islamike, shkruan Motadel. Nazistët e konsideronin Amin al-Huseinin si në lloj pape të myslimanëve dhe shpresonin se fjalët e tij kanë peshë të madhe në mesin e besimtarëve. Propagandisti fetar palestinez thoshte se atij i interesonte shumë gjendja e myslimanëve në Evropën Juglindore. Në vitin 1942 ai ishte takuar në Romë me një delegacion dinjitarësh myslimanë nga Ballkani, të cilëve u printe myftiu i Mostarit, Omer Xhabiq.

Kontaktet e para me myslimanët e Ballkanit Al-Huseini i kishte krijuar më 1931, kur një delegacion i myslimanëve të Mbretërisë së Jugosllavisë mori pjesë në Kongresin Islamik në Jerusalem. Në një intervistë dhënë revistës "Osvit" të Sarajevës, në gusht të vitit 1942, Al-Huseini tha se perandoria britanike do të shkatërrohej dhe islami ishte armik i natyrshëm i ideologjisë komuniste. "Nganjëherë fyreri (Hitleri) më ka konfirmuar se Gjermania me interesin më të madh përcjell luftën e botës islame kundër shtypësve

**Kontaktet e para me myslimanët e Ballkanit Al-Huseini i kishte krijuar më 1931, kur një delegacion i myslimanëve të Mbretërisë së Jugosllavisë mori pjesë në Kongresin Islamik në Jerusalem. Në një intervistë dhënë revistës "Osvit" të Sarajevës, në gusht të vitit 1942, Al-Huseini tha se perandoria britanike do të shkatërrohej dhe islami ishte armik i natyrshëm i ideologjisë komuniste**

dhe se Gjermania nuk synon të skllavërojë apo të shtypë asnjë vend mysliman", deklaroi ai në atë intervistë. Po më 1942 gazeta naziste "Völkischer Beobachter" raportonte se Al-Huseini ua kishte dhuruar myslimanëve të Ballkanit 15 mijë lira. I shoqëruar nga disa oficerë dhe administratorë nazistë myftiu vizitoi Zagrebin, Banjallukën, Sarajevën dhe u kthye sërish në Zagreb. Në Sarajevë Al-Huseini takoi teologë myslimanë nga disa qytete të Bosnjës dhe delegacione nga Sanxhaku dhe Shqipëria. Në xhaminë e Gazi Husrev Begut në Sarajevë imami i Hitlerit mbajti një fjalim emocional mbi vuajtjet e myslimanëve, sa që disa pjesëmarrës shpërthyen në lot, siç shkruan historiani David Motadel. Al-Huseini sulmoi "zjarrvënësit e Moskës", "sunduesit anglezë" dhe "plaçkitësit amerikanë". Qëllimi i tij ishte që t'i bindte dinjitarët myslimanë të Ballkanit që ta shohin veten dhe besimtarët si pjesë të botës së madhe islame. Vizitën e tij e shikuan me mosbesim dhe refuzim sidomos ustashët dhe italianët. Kishte edhe diplomatë në Berlin, të cilët theksonin se fjalimet e myftiut dhe idetë e tij për një botë unike myslimane nuk kishin të bënin aq me realitetin dhe ishin "armiqësore ndaj Evropës".

Leland Harrison, ambasador i SHBA-së në Bernë, shkroi se synimi i gjermanëve në Kroaci ishte të mobilizonte 85 mijë myslimanë të Bosnjës për të përkrahur masat antiboldshevike dhe antihebraike. Vizita e Al-Huseinit kishte veçanërisht këtë qëllim. Sipas ambasadorit amerikan në Zvicër, gjatë vizitës së teologut ekstremist nga Palestina në Ballkan gjermanët premtuan se do të furnizonin Kroacinë me 50 tonelata patate dhe 10 tonelata sheqer. Kroacia e asaj kohe sundonte edhe pjesën më të madhe të myslimanëve të Bosnjës. Udhëtimi i myftiut u parapriu përpjekjeve të gjermanëve për të themeluar divizionet naziste "Hanxhar" (Bosnjë) dhe "Skënderbeu" (në viset shqiptare, sidomos në veri). Me gjithë bashkëpunimin me gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore, Al-Huseini u lirua nga internimi francez dhe më 1945 u kthye në Palestinë. Shefi i mëvonshëm i Organizatës për Çlirim të Palestinës (OPÇ) për një kohë ishte sekretar i tij privat. Amin al-Huseini vdiq në vitin 1974 në Liban. Izraeli nuk e lejoi varrimin e tij në Jerusalem. (koha.net)





## Kështu largohen gurët në veshka

Veshkat janë një nga organet më të rëndësishme në trupin tonë pasi ndihmojnë filtrimin e mbetjeve nga gjaku, për t'i larguar më pas nga trupi përmes procesit të urinimit.

Gjithashtu veshkat janë të përfshira në rregullimin e presionit të gjakut, balancimin e elektrolitve dhe prodhimin e qelizave të kuqe të gjakut në trup. Veshkat absorbojnë kripërat dhe toksinat e me kalimin e kohës shpesh herë krijojnë gurë. Sipas studimeve të fundit, një nga dhjetë persona vuajnë nga gurët në veshka, transmeton Klan Kosova. Kur gurët krijojnë, është e preferueshme që ata të largohen pasi mund të shkaktojnë probleme serioze që edhe mund të sjellë dështimin e veshkave. Por jo vetëm operimi është një opsion. Më poshtë po sjellim një recetë natyrale për largimin e gurëve në veshka.

### PËRBËRËSIT:

**250 gramë mjaltë**

**250 gramë majdanoz**

**0.25 litra vaj ulliri ekstra të virgjër**

**250 gramë limonë me lëvore**

**250 gramë sheqer pluhur**

Si ta përgatisni këtë recetë? Limoni duhet të pastrohet fillimisht. Më pas prijeni në katër copë dhe vendoseni në mikser (blender). Më pas, njëjtë veproni edhe me majdanozin. Përzieni mirë, shtoni sheqerin, mjaltin dhe vajin e ullirit.

Përbërësit duhet të përzihen derisa të krijohet një masë homogjene. Për gurët në veshka ose fshikëz të tëmthit, duhet të konsumohet një lugë gjelle nga kjo përzierje në mëngjes, në stomak të zbrazët dhe një lugë para se të shkoni në gjumë. Në rast të gurëve ose rërës në veshkë dhe kanalet biliare, duhet të konsumohen dy lugë gjelle nga kjo përzierje. Këtë përzierje duhet ta mbani gjithmonë në frigorifer. Gjithashtu, është e rëndësishme që të pini shumë ujë derisa konsumoni këtë përzierje.

# GRIPI MUND TË PËRHAPET EDHE VETËM PËRMES FRYMËMARRJES



Virusi i gripit mund të përhapet më lehtë sesa që mendohej më parë, sipas një studimi të ri të udhëhequr nga universiteti i Marylandit. Njerëzit zakonisht besojnë se mund të preken nga gripi duke u ekspozuar ndaj pikave nga kolli ose teshtitja e personit të infektuar ose duke i prekur sipërfaqet e kontaminuara. Por, informacionet e reja rreth bartjes së gripit tregojnë se mund ta bartim gripin tek të tjerët vetëm duke marrë frymë. Studimi i titulluar "Infectious virus in exhaled breath of symptomatic seasonal influenza cases from a college community," i publikuar në Proceedings of the National Academy of Sciences, ofron prova të reja për rëndësinë e mundshme të transmetimit në ajër për shkak të sasive të mëdha të virusit infektiv të cilin hulumtuesit e gjetën në frymëmarrjen e liruar nga njerëzit që vuajnë nga gripi. "Ne kemi zbuluar se rastet e gripit e kontaminuan ajrin rreth tyre me virusin infektues vetëm duke marrë frymë, pa u kollitur ose teshtitur", shpjegon dr. Milton, profesor i shëndetit mjedisor në Shkollën e Shëndetit Publik të universitetit Maryland dhe hulumtues kryesor i këtij studimi. "Njerëzit me grip prodhojnë aerosole infektive (pika të vogla që qëndrojnë pezull në ajër për një kohë të gjatë), madje edhe kur nuk kolliten dhe sidomos gjatë ditëve të para të sëmundjes. Kështu kur dikush preket nga gripi, ai duhet të shkojë në shtëpi dhe të mos qëndrojë në vendin e punës dhe t'i infekttojë të tjerët".

Hulumtuesit nga universiteti i Maryland, universiteti Shtetëror i San Jose, universiteti Shtetëror i Missouri dhe universiteti i Californisë, Berkeley kontribuan në këtë studim të financuar nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) dhe Institutet Kombëtare të Shëndetit.

Dr. Milton dhe ekipi i tij kërkimor e kapën dhe e karakterizuan virusin e gripit të liruar nga frymëmarrja nga 142 raste të konfirmuara të njerëzve me grip gjatë frymëmarrjes natyrale, e folura, kollitja spontane, dhe teshtitja, dhe e vlerësuan infektivitetin e aerosoleve të gripit të shkakuar në mënyrë natyrale. Pjesëmarrësit i ofruan 218 mostra nazofaringale dhe 218 mostra 30 minutëshe të frymëmarrjes, kollitjeve spontane dhe teshtitjes në ditën e parë, të dytë dhe të tretë pas fillimit të simptomave. Analiza e virusit infektiv e marrë nga këto mostra tregoi se një numër i konsiderueshëm i pacientëve me grip në mënyrë rutine e përhapnin virusin infektiv, dhe jo ARN-në e dallueshme, në grimca aerosoli mjaft të vogla për të paraqitur rrezik për transmetimin në ajër. Çuditërisht, 11

"Rezultatet e studimit sugjerojnë që mbajtja e sipërfaqeve të pastra, duke i larë duart gjatë gjithë kohës dhe duke i shmangur njerëzit që kolliten - nuk siguron mbrojtje të plotë nga infektimi prej gripit", tha Sheryl Ehrman, dekane e Kolegjit Charles W. Davidson

marrja nga 142 raste të konfirmuara të njerëzve me grip gjatë frymëmarrjes natyrale, e folura, kollitja spontane, dhe teshtitja, dhe e vlerësuan infektivitetin e aerosoleve të gripit të shkakuar në mënyrë natyrale. Pjesëmarrësit i ofruan 218 mostra nazofaringale dhe 218 mostra 30 minutëshe të frymëmarrjes, kollitjeve spontane dhe teshtitjes në ditën e parë, të dytë dhe të tretë pas fillimit të simptomave. Analiza e virusit infektiv e marrë nga këto mostra tregoi se një numër i konsiderueshëm i pacientëve me grip në mënyrë rutine e përhapnin virusin infektiv, dhe jo ARN-në e dallueshme, në grimca aerosoli mjaft të vogla për të paraqitur rrezik për transmetimin në ajër. Çuditërisht, 11

## SHBA, GRIPI MË I RËNDË QË PREJ VITIT 2009

Gripi e ka mbërthyer keq Amerikën këtë sezon, duke i shtyrë ekspertët e shëndetësisë që të flasin për një epidemi po aq të rëndë sa ajo e gripit të derrit 9 vjet më parë. Raporti më i fundit qeveritar tregon se 1 në 13 vizita tek mjeku javën e kaluar ishin për temperaturë, kollë e simptoma të tjera të lidhura me gripin, nivel ky i cili nuk ishte parë më që prej vitit 2009. Ai madje kapërcen shifrat e çdo sezoni dimëror gripi që prej vitit 2003, kur administrata amerikane ndryshoi mënyrën e matjes së kësaj sëmundjeje. Sezoni i sivjetshëm nisi shpejt dhe përhap me shpejtësi një lloj aq të keq gripi sa i ka mbushur spitalet me njerëz e ka shënuar më shumë vdekje sesa viruset e tjera gripi të zakonshëm. Ajo që befason në mënyrë të veçantë ekspertët është intensiteti afatgjatë i tij, duke i shtyrë shumë mjekë të mendojnë se ky është sezoni më i ashpër i gripit që është parë prej dekadash të tëra. Një përhapje shqetësuese e tij është shënuar në pothuajse të gjitha shtetet amerikane, me përjashtimin e Hawaii dhe Oregonit, ndërsa numri i shtrimeve në spital vazhdon të rritet.

(48%) nga 23 mostrat e aerosolit të marra në mungesë të kollitjes kishin ARN të dallueshëm viral dhe 8 prej këtyre 11 e përmbanin virusin infektiv, duke sugjeruar që kollitja nuk ishte e nevojshme për gjenerimin e aerosoleve të infektuara në pikat e imëta të aerosolit. Përveç kësaj, disa nga teshtitjet e vëzhguara nuk u shoqëruan me numra më të mëdha të kopjuara virale të ARN-së në aerosole të vrazhda ose të imëta, duke sugjeruar se teshtitja nuk e jep ndonjë kontribut të rëndësishëm në shpërndarjen e virusit të gripit në aerosole.

"Rezultatet e studimit sugjerojnë që mbajtja e sipërfaqeve të pastra, duke i larë duart gjatë gjithë kohës dhe duke i shmangur njerëzit që kolliten - nuk siguron mbrojtje të plotë nga infektimi prej gripit", tha Sheryl Ehrman, dekane e Kolegjit Charles W. Davidson për Inxhinieri në Universitetin Shtetëror të San José. "Qëndrimi në shtëpi dhe hapësira jopublike mund të bëjë ndryshim në përhapjen e virusit të gripit". Sipas autorëve, gjetjet mund të përdoren për t'i përmirësuar modelet matematikore të rrezikut të transmetimit ajror të gripit nga njerëz me sëmundje simptomatike dhe për të zhvilluar ndërhyrje më të efektshme të shëndetit publik dhe për ta kontrolluar dhe zvogëluar ndikimin e epidemive dhe pandemive të gripit. Për shembull, mund të bëhen përmirësime në sistemet e ventilimit për ta zvogëluar rrezikun e transmetimit në zyra, klasa shkollore dhe makina nëntokësore. Ndërkohë, të gjithë mund ta respektojmë këshillën që të qëndrojmë në shtëpi, nëse është e mundur, kur fillojmë të sëmurimi për të parandaluar edhe më shumë raste të gripit. Dhe, të vaksinohemi - nuk është proces i përsosur, por e parandalon një sasi të konsiderueshme të sëmundjeve të rënda.



## Çfarë duhet të hani nëse keni diarre?

Ndoshta keni ngrënë diçka që nuk ju ka bërë mirë ose jeni të stresuar. Cilado që është arsyeja, janë disa ushqime që ndihmojnë kur keni barkqitje ose që ndryshe njihet si diarre

- Bananet. Janë lehtësisht të tretshme dhe janë një zgjedhje e shkëlqyer për shkak se e qetësojnë sistemin e tretjes. Bananet përmbajnë një përqindje të lartë të kaliumit që do të zëvendësojnë elektrolitet që humbasim gjatë diarresë. Ky frut është poashtu një burim i shkëlqyer i pektinës dhe fibrave të tretshme që nxisin thithjen e lëngjeve. Bananet përmbajnë edhe inulin, një lloj tjetër i fibrave të tretshme që shkakton rritjen e baktereve të mira në sistemin e tretjes.

- Orizi i bardhë dhe patatet. Si orizi i bardhë ashtu edhe patatet janë një burim i shkëlqeshëm i niseshtës që tretet lehtësisht. Ju duhet të hani patate dhe oriz pa shtuar erëza ose vaj, pasi kjo mund të iritojë sistemin e tretjes dhe të shkaktojë dhimbje.

- Lëngu i mollës. Mollët janë një burim i shkëlqyer i pektinës por ato përmbajnë edhe një përqindje jashtëzakonisht të lartë të fibrave që mund të shkaktojnë probleme stomaku gjatë kohës që jeni duke vuajtur nga diarreja. Prandaj rekomandohet të konsumoni lëng molla sepse është më lehtë të tretet.

- Jogurti. Gjatë kohës sa keni diarre, rekomandohet që të evitoni qumështin dhe produktet e tij por jogurti është një përjashtim. Zgjedhni jogurtin që përmban probiotikë pasi ato balancojnë nivelin e baktereve të mira në sistemin tuaj të tretjes.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Mundohuni te shmangni me çdo kusht konfliktet ne çift gjate kësaj dite sepse përndryshe mund te arrini edhe deri ne një ndarje. Kokëfortësia do jete pika juaj me e dobët. Beqaret do përfitojnë mjaft nga liria qe kane dhe nuk do e ndiejnë nevojën për te krijuar një lidhje. Ne planin financiar do i zgjidhni te gjitha problemet dhe do jeni me te qete ne këtë fushë.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Duhet t'i kushtoni pak me tepër vëmendje sot atij qe keni ne krah sepse po e late pas dore gjerat mund te marrin tatëpjetën. Shtojni dozat e dialogut dhe tregohuni me te kuptueshëm. Beqaret do kenë një dite te mrekullueshme dhe me emocione te mëdha. Ne planin financiar do keni fat dhe do realizoni te gjitha transakcionet qe kishit menduar prej kohesh.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Ka shume gjasa qe ata qe janë ne një lidhje te normalizojnë gjithçka gjate kësaj dite. Mjaft me duke u takuar fshehurazi apo duke gënjyer te tjerët. Beqaret duhet te reflektojnë me kujdes para se te marrin çfarëdo lloj vendimi. Mos u verboni nga pamja e jashtme e disa personave. Ne planin financiar gjerat do shkojnë mbare. Do arrini t'i shlyeni edhe borxhet e marra.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Ndikimi i yjeve do jete shume negativ sot për jetën sentimentale te çiftëve. Debatet me partnerin do jene te pafundme dhe nuk do arrini dot te zgjidhni asgjë. Qëndroni pak vetëm dhe reflektoni. Beqaret do fillojnë aventura emocionuese, por afatshkurtra. Financat do jene pak me te stabilizuara se disa dite me pare, megjithatë nuk është ende koha për investime te mëdha.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Për shkak te ndikimit te madh te Uranit ne jetën tuaj ne çift, duhet te tregoheni shume te duruar me partnerin dhe te bëni here pas here lëshime ndaj tij. Beqaret do admirohen dhe do joshen nga shume persona, por ata ne te vërtetë do pëlqejnë dike qe nuk përkohësisht nuk ndodhet ne te njëjtin qytet. Financat do jene te mbrojtura dhe aspak problematike.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Pritet qe dita për te dashuruarit te jete me harmonike sot. Do i kushtoni vëmendjen e duhur partnerit dhe do sqaroni me qetësi problemet e vogla qe keni pasur. Beqaret nuk do jene me shume fat kështu qe duhet te presin ende dhe pak për te gjetur personin e duhur. Ne planin financiar duhet te mendoni edhe për te ardhmen jo te shpenzoni sa para te keni.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Ne jetën tuaj ne çift duhet te tregoheni shume te kujdesshëm gjate kësaj dite dhe te mos merrni vendime te nxituara. Mos iu besoni shume as atyre qe do iu thonë disa miq. E njëjta gjë duhet thënë edhe për beqaret. Njihuni mire me personat qe do takoni para se te vendosni te krijuar një lidhje. Ne planin financiar nuk duhet te rrezikoni me shume sesa duhet.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Dita e sotme do jete shume e qete për te dashuruarit. Rutina do mbizotërojë gjate gjithë kohës dhe nuk pritet asnjë gjë e re. beqaret nuk do e dine as vete se çfarë duan dhe për këtë arsye do bëjnë mire te qëndrojnë edhe pak kohe ashtu si janë. Ne planin financiar duhet te bëni çmos qe ta përmirësoni sa me shpejt situatën. Ju mundeni!



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Kjo dite do jete shume e turbullt për ata qe janë ne një lidhje. Nuk do bini shume dakord me atë qe keni ne krah dhe debatet do jene te njëpasnjëshme. Kujdes! Beqaret do jene më me fat ne sektorin e dashurisë. Pa kërkuar shume do iu shfaqet para personi qe kane ëndërruar prej kohesh. Situata financiare do përmirësohet ndjeshëm fale një lotarie qe do fitoni.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Mundohuni te tregoheni sa me realiste ne jetën tuaj ne çift sot dhe mos thurni shume ëndrra. Sa me shume te dilni nga realiteti aq me shume do iu ndërlikohet situata. Beqaret duhet ta kenë veten te lire dhe te dalin sa me shume neper festa. Do keni me tepër mundësi për njohje te reja. Ne planin financiar do i zgjidhni te gjitha problemet qe keni pasur.




**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Nëse nuk doni te keni telashe me partnerin tregohuni sa me te sinqerte gjate kësaj dite. Nëse nuk arrini dot ta qetësoni situatën e krijuar merrni pak distance nga njeri-tjetri dhe reflektoni me kujdes. Beqaret do e gjejnë me ne fund shpirtin e tyre binjak dhe do ndihen te plotësuar. Ne planin financiar duhet te vazhdoni te shpenzoni me maturi qe te shmangni ndonjë rrenim te mundshëm.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Dita e sotme do jete me e mire sesa ju mendonit dhe bashkëpunimi ne çift do shtohet akoma me shume. Do merrni mendimin e njeri-tjetrit për gjithçka dhe nuk do ketë aspak debate. Beqaret nuk do kenë asnjë ndryshim ne jetën sentimentale. Financat nuk do jene ne gjendjen me te mire. Nëse e teproni me shpenzimet do keni probleme goxha te mëdha.



Mensur Mamuti	REGJISORI GREKO-FRËNG NË FOTO	FILM I REGJISORIT NË FOTO	FILM I REGJISORIT NË FOTO I LUTEM DIKUJ	I
FUSTANELLË SKOCEZE				
MONEDHË E VJETER INDIANEARI				
M				
FEMRA E DRERIT, DRENUSHE				
TERAMETRI			DH. ISH PORTIERI SPANJOLL, LUIS	
TITULL KISHTAR				
MËSUES SHPIRTËTOR INDIAN				
KASAFORTA				
VALËT E RADIOS				

KOHA	TË SHTRUARIT ME ÇIMENTO	ORGANIZON (MBLEDHJE)	QYTET NË SHQIPËRI	NIKELI	KËNGËTARI IZRAELIT, BAURON GUERMANIA
FILM I REGJISORIT NË FOTO "QYTETI I ..."					SHKRONJË GREKE NËNA E ISAUT
LUMË NË KOSOVË				ZONJA I MBUSHET MENDJA	ANGSTREMI
MUSLIM AMERICAN SOCIETY				MUHABETI SHKRONJË GREKE	
ISH BEJZBOLLISTI AMERIKAN, DEL ROSARIO					RADIUMI PËRSHËNETJE SPANJOLLE (HOLA) PERËNDIA
AZOTI	KARVAN GYP GJAKU				FILM I REGJISORIT NË FOTO GROPË E VOGËL, E ÇARË
AKTORJA AMERIKANE, LEONI				FUTBOLLISTI SUEDEZ, IRANDUST NDAJ FOLJË SASIE	
INDIUMI			PËRSHËNETJE ISLAME (SH.) KALIUMI		
GJYNAH					EPOPEJA

ZGJIDHJET: I, KILT, MOHUR, SUTA, TM, DH, ABAT, GURU, ARKA, AVTOR, ÇMENDUR, NI, I BRI, DAMA, MAS, BISEDA, ENERIO, RA, N, KONVOJ, Z, TEA, DALEHO, IN, SELAMET, MËKATË, EPI,

**Sudoku**

shumë i lehtë      mesatar

4			7	6				1			6						7	
		6		4		7					4	3	7				1	
		7			3	5				7		5		8				
						4	5			4		7		1			8	
8	7							3	9		8	3					1	6
		5	1								9		3		2			7
			8			9	2					7		1				5
			9			8	6				1		6	9	5			
2			1	3					8	9								6

Shumë i lehtë: 492765381, 536841792, 187293564, 623918457, 874526139, 951374826, 74869213, 319482675, 265137948. Mesatar: 136928547, 859437216, 274156893, 542761389, 783549162, 691382475, 467213958, 318695724, 925874631.

## Gabuan në përkthim, Norvegjia porositi gabimisht 15 mijë vezë



A mund të quhet gabim gjetja e 15 mijë vezëve për të ushqyer atletët e uritit norvegjezë në Olimpiadën Dimërore në Korenë e Jugut. Po mund të quhet, nëse përdorni Google Translate për të

përkthyer kërkesën për vezë në gjuhën koreane dhe ta dërgosh direkt më pas në një supermarket lokal. Ky është gabimi që ka bërë kuzhina për ekipin olimpik të Norvegjisë, duke marrë mbrapa 15

mijë vezë, kur kishte ndërmend të porosishte vetëm 1500. Shefët ia hodhën fajin një gabimi në përkthim. Shefi Stale Johansen i tha gazetës norvegjeze Aftenposten se për fat të mirë ekipi ishte në gjendje të kthente në supermarket sërish 13.500 vezët e mbetur sufiçit. Nuk është e qartë se si ndodhi gabimi, por gazetari korean i BBC, David Cann, thotë se gjuha koreane ka një sistem tjetër të numërimit dhe një fjalë mund të ketë kontribuar te gabimi në fjalë. Ja dhe dallimi midis drejtshkrimit të 1500 dhe 15.000 vezëve në gjuhën koreane: Tore Ovrebo, kreu i ekipit norvegjez, duket se pajtohet. "Ishte një zero shtesë në kërkesë- kështu që nga 1500 u bënë 15.000", tha ai në një konferencë për shtyp nga Pyeongchang të enjten, duke shtuar se nuk ishte ndonjë "çështje e madhe". Norvegjia ka dërguar 109 atletë për të konkurruar në Lojërat Dimërore. Rasti u raportua për herë të parë në vend javën e kaluar, por vetëm tani ka tërhequr vëmendjen ndërkombëtare.

## Holanda "në këmbë" për të shpëtuar lopën Hermien



Dëshira për të jetuar ka fituar mbi gjithçka. Në Holandë janë të gjithë të çmendur për lopën Hermien, e cila pas

largimit pak para Krishtlindjeve nga kamioni që duhet ta dërgonte në thertore, tani do të vijojë një jetë "normale" në një

fermë të veçantë për kafshët e keqtrajtuara falë 50 mijë eurove të mbledhura përmes Internetit nga njerëzit që u prekën nga historia e saj. Historia e lopës 3 vjeç e gjysmë, ka shkaktuar fantazinë e rrjeteve sociale, të cilët kryesisht përmes "Twitter"-it, u pasionuan, duke lançuar hashtag si #GoHermien e #JeSuisHermien. Për të u shqetësua madje edhe një anëtar i familjes mbretërore, bashkëshorti i princshës Margherita, i cili bëri një apel për të ofruar lirinë e kafshës. Hermien, i cila u arratis së bashku me një viç tjetër, arriti t'i shpëtojë ndjekësve të saj për tetë javë, duke u endur nëpër pyje dhe fshatra. Dhe në fund, këmbëngulja e saj u shpërblye. 50 mijë euro janë mbledhur në internet për të garantuar sigurinë e saj dhe tani ajo mund të jetojë në heshtje në një fermë.

## Në Pakistan, askush nuk feston dhe flet për Shën Valentinin

Dita e Shën Valentinit në Pakistan është një tabu. Më 14 shkurt, çdo referencë për ditën e të dashuruarve në radio, televizion, gazeta dhe faqet e internetit është e ndaluar. Në vendin me 96.4% të popullsisë myslimane, tradita vazhdon të festohet nga shumë çifte dhe shoqërohet me oferta speciale në dyqane dhe restorante. Megjithatë, nuk mungojnë ata që e konsiderojnë atë një formë të imperializmit kulturor të Perëndimit, në kundërshtim me shpirtin kombëtar. Ishte autoriteti kombëtar i telekomunikacionit (PEMRA) që nxori një ndalim për median. Vendimi pason një rezolutë të Gjykatës së Lartë në vitin 2017, e cila përveç mbulimit mediatik, ndalonte festimet që lidhen me Shën Valentinin në vende publike. Ishte një qytetar, i quajtur Abdul Waheed, që kërkoi përcaktimin e censurës në ditën e Shën Valentinit, si një rast për përhapjen e "imoralitetit, lakuriqësisë



dhe imoralitetit". Një vit pas kërkesës së Waheed, Gjykata Supreme ende nuk ka nxjerrë një vendim përfundimtar. Vetë presidenti, Mamnoon Hussain, lëshoi një deklaratë të ashpër ndaj ditës së Shën Valentinit në vitin 2016, duke e cilësuar një import kulturor nga Perën-

dimi dhe një rrezik për vlerat e Pakistanit. "Dita e Shën Valentinit nuk ka lidhje me kulturën tonë dhe duhet të shmanget", deklaroi ai në atë kohë. Në të kaluarën, raporton Al Jazeera, autoritetet kishin një qëndrim të ndryshëm, më të butë.

1502 - Myslimanët e Granadës detyrohen të konvertohen në të krishterë.

1502 - Vasco da Gama fillon lundrimin e tij të dytë prej Lisbonë për në Indi.

1771 - Gustav III emërohet Mbreti i Suedisë.

1818 - Kili fiton pavarësinë nga Spanja

1882 - Bashkimi Social Demokrat themelohet në Amsterdam.

1921 - Trupat sovjetike pushtojnë Gjeorgjinë.

1934 - Fillon lufta civile në Austri.

1950 - Albert Einstein paralajmëron për bombën hidrogjenike.

1953 - BRSS ndërpret marrëdhëniet me Izraelin.

1963 - Argjentina kërkon ekstradimin e ish kryetarit Peron.

2002 - Fillon gjykimi i ish Kryetarit të Republikës Federative të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq në Tribunalin e Hagës.

Meka e lashtë ishte një oazë në rrugën e karvanit që lidhte botën e Mesdheut me Arabinë Jugore, Afrikën Lindore dhe Azinë Jugore. Pelegrinazhi në Mekë njihet si 'Haxh'. Haxhi është një nga pesë pikat themelore myslimane që njihen si 'pesë shtyllat e Islamit'. Një ndër ritualet më të njohura në Mekë është 'hedhja me gurë e djallit', ku pelegrinët hedhin gurë në tri shtylla të ndryshme të haxhit që përfaqësojnë djallin. Shpallja e parë e Kuranit ishte vendosur në Mekë. Meka gjithnjë e më shumë është duke u zgjeruar dhe është duke u modernizuar. Në Mekë ndodhet ndërtesa e tretë më e madhe në botë, e njohur si 'Abrah Al Bait'. Më shumë se 15 milionë myslimanë nga e mbarë bota e vizitojnë Mekën gjatë periudhës së Haxhit. Xhamia e Mesxhidit është xhamia më e madhe në botë. Ajo është e vendosur rreth Qabesë.



KALENDARI HISTORIK 12 SHKURT

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS

### MARTESAT E ARDHSHEME

Së shpejti martesat do të duken kështu:

Ofiqari: A pranoni që të ndryshoni statusin tuaj në Facebook nga Single në Married?

Nusja: Po!

Ofiqari: I lus kumbarët të afrohen dhe të klikojnë LIKE!



Nëse miqësia është pika jote e dobët, atëherë je personi më i fortë në botë. (William Shakespeare)